	5.Integrimi i Teknologjisë në Arsimin Muzikor: - Përdorimi i programeve dhe aplikacioneve muzikore për të ndihmuar nxënësit në mësimin e teorisë, kompozimit dhe solfezhit. - Krijimi i mundësive për të realizuar projekte muzikore dixhitale dhe për të përdorur teknologjinë në krijimin e muzikës.		Refuzohet	Shkolla e ka pavarësinë të krijojë mundësi për integrimin e veglave / programeve digjitale në funksion të rritjes së cilësisë së të nxënit dhe të arritjeve të sukseseve.
	6. Përfshirja e Koncerteve dhe Shfaqjeve në Programin Edukativ: - Organizimi i koncerteve të rregullta për nxënësit si pjesë e procesit të vlerësimit dhe promovimit të aftësive të tyre.-Bashkëpunimi me institucione muzikore dhe orkestrat për të krijuar mundësi të performancës dhe bashkëpunimit për nxënësit.		Refuzohet	Në shkollën e muzikës instrument i vlerësimit është edhe përfshirja e nxënësve në organizim dhe performim të ngjarjeve muzikore. Gjithashtu pjesë e punës së shkollës është bashkëpunimi me institucionet tjera të artit/muzikës.

	7.Bashkëpunimi me Institucionet Muzikore dhe Komunitetin- Krijimi i partneriteteve me konservatorët, orkestrat simfonike, ansamblet dhe shkollat e tjera muzikore për të ofruar mundësi shkëmbimi dhe bashkëpunimi.-Përfshirja e komunitetit në aktivitete dhe projekte muzikore që promovojnë kulturën dhe edukimin muzikor.		Refuzohet	Bashkëpunimi dhe partneritetet me institucionet tjera dhe me komunitetin është pjesë integrale e punës së shkollës.
	8.Mbështetje Psikologjike dhe Motivimi për Nxënësit-Ofrimi i programeve mbështetëse për të menaxhuar stresin dhe për të ruajtur motivimin gjatë procesit të mësimit dhe përgatitjes artistike. - Krijimi i mundësive për mentorim dhe këshillim karriere për nxënësit që synojnë të ndjekin studimet muzikore në nivel të lartë. Objektivat Afatmesme dhe Afatgjata:-Rritja e cilësisë së arsimit muzikor dhe përgatitja e nxënësve për karrierë profesionale në muzikë. - Zhvillimi i shkollave të muzikës si qendra të ekselencës në edukimin muzikor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.- Zgjerimi i qasjes së edukimit muzikor përmes integrimit të programeve që përfshijnë komunitetin dhe kulturën lokale. Ky plan është një udhërrëfyes i rëndësishëm për zhvillimin e arsimit muzikor dhe për të siguruar një platformë të fortë për talentet e reja në fushën e muzikës.		Refuzohet	Është detyrë e përditshme e psikologut shkollor që t'i mbështetë nxënësit dhe komunitetin arsimor brenda shkollës për perfomim cilësor, qoftë në adresimin e sfidave sikurse stresi etj, qoftë në motivimin për performancë më të mirë.

Shkurtesat:

F-Femra, M-Meshkuj, T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik, Projekt-Planin Zhvillimor të Arsimit 2025-2027
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Raporti është përgatitur nga :

Haziz Krasniqi



NJOFTIM PUBLIK

Njoftohen të gjithë banorët e Komunës së Prizrenit për organizimin e konsultimit publik për Projekt-Planin Zhvillimor të Arsimit 2025-2027

Data : 16.08.2024

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë) -

Ora : 11:00

Të dashur qytetarë/e,

Komuna e Prizrenit përmes grupit punues për hartimin e Projekt-Planit Zhvillimor të Arsimit 2025-2027, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Prizrenit. Nr. 01/011-5643 dhe Udhëzimet Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, lëshon këtë:

11:05 – 11:55

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-Planin Zhvillimor të Arsimit 2025-2027

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **08.08.2024** deri me datën: **23.08.2024**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **16.08.2024**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë) me fillim në ora **11:00**.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën **23.08.2024** në ora **16:00**, në emailat e zyrtarëve: Idriz.Kryezi@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Për më shumë detaje për planin, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik:
https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/
Platformën për Konsultime Publike:
https://konsultimet.rks-gov.net/
Facebook:
https://www.facebook.com/kkprizren

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 690/24 Dt. 08.08.2024

Ymer Berisha
Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun



JAVNO OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi građani Prizrena za organizovanje javne konsultacije za Razvojni Projekt-Plan Obrazovanja 2025-2027

Dana : 16.08.2024

Mesto: Sala Skupštine opštine (Bela Kuća).

Vreme: 11:00

Poštovani građani,

Opština Prizren preko radne grupe za izradu Razvojnog Projekt-Plana Obrazovanja 2025-2027, oslanjajući se na Zakon Br.03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, Statut opštine Prizren Br. 01/011-5643 i Administrativna Uputstva (MALS) Br.04/2023 za otvorenu Administraciju u opštinama, daje ovo

JAVNO OBAVEŠTENJE

U vezi sa organizovanjem javne konsultacije građanima sa građanima za Razvojni Projekt-Plan Obrazovanja 2025-2027

Ovaj dokument će biti na javnoj konsultaciji od **08.08.2024** do datuma: **23.08.2024**. godine, dok će se javna konsultacija sa građanima održati **16.08.2024**. godine, u sali za sastanke Skupštine opštine (Bela kuća) sa početkom od **11:00** časova.

Komentare i sugestije možete slati do dana **23.08.2024** do **16:00** časova, na email službenika: Idriz.Kryezi@rks-gov.net i Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Za više detalja u vezi pravilnika, možete posetiti sledeće stranice:

Službena ueb stranica u rubrici za javne konsultacije:
https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/

Platforma za Javne konsultacije:
https://konsultimet.rks-gov.net/

Facebook:
https://www.facebook.com/kkprizren

Ymer Berisha
Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURiYETi
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 1/3621 Dt. 08.08.2024



KAMU BİLDİRİSİ

2025-2027 Eğitimin Kalkınması Taslak-Projesi ile ilgili Kamu istişarenin düzenleneceği tüm Prizren Belediyesinin tüm sakinlerine duyurulur.

Tarih: 16.08.2024

Yer: Belediye Meclis toplantı salonunda (Beyaz Ev)

Saat: 11:00

Sevgili vatandaşlar,

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un, 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğün ve 04/2023 sayılı Belediyelerde Açık Yönetim ile ilgili İdari Yönergenin (YYİB) gereğince Prizren Belediyesi, 2025-2027 Eğitimin Kalkınması Taslak-Projesinin hazırlanmasına yönelik çalışma grubu aracılığıyla işbu duyuruyu sunmaktadır:

2025-2027 Eğitimin Kalkınması Taslak-Projesinin hazırlanması ile ilgili vatandaşlarla kamu istişarenin düzenlenmesi için

KAMU BİLDİRİSİ

Söz konusu belge **08.08.2024** tarihinden **23.08.2024** tarihine kadar kamu istişarede olacaktır. Halkla kamu istişare ise **16.08.2024** tarihinde Belediye Meclisin toplantı salonunda (Beyaz Ev) saat **11:00'de** başlamak üzere düzenlenecektir.

Talep, yorum ve önerilerinizi, **23.08.2024** saat 16:00'ya kadar aşağıdaki yetkililerin e-posta adreslerine iletebilirsiniz: Idriz.Kryezi@rks-gov.net ve Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Yönetmelik hakkında daha fazla bilgiye aşağıdaki bağlantılardan bulabilirsiniz:

Resmi internet sayfası kamu tartışma planlamaları:
https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/rregulloret-ne-konsultim-publik/
Kamu tartışma platformu:
https://konsultimet.rks-gov.net/
Facebook:
https://www.facebook.com/kkprizren

Ymer Berisha

Halkla İletişim Birim Yöneticisi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 490124 Dt. 08.08.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Planin Zhvillimor të Arsimit 2025-2027

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së konsultimit: **16.08.2024**.

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia	Emaili	Nr.Tel	Nënshkrimi
1	Arben	Shala	M	[redacted]	[redacted]	
2	Adelina	Begiri - Mimci	F	[redacted]	[redacted]	
3	Nora	Kavaxhiu	F	[redacted]	[redacted]	
4	Behare	Kryeziu	F	[redacted]	[redacted]	
5	VLORAN	[illegible]	M	[redacted]	[redacted]	
6	Shqipdon	Thaçi	M	[redacted]	[redacted]	
7	Nexhat	Maçkuy	M	[redacted]	[redacted]	
8	ISUF	KURTAJ	M	[redacted]	[redacted]	
9	Befim	Ramadani	M	[redacted]	[redacted]	
10	Kaltrina	Skoro - Matezaj	F	[redacted]	[redacted]	
11	Durim	Ramadani	M	[redacted]	[redacted]	
12	Ferdi	Kovaç	M	[redacted]	[redacted]	
13	MIMOZË	DURAJ	F	[redacted]	[redacted]	
14	Bekim	Spahiu	M	[redacted]	[redacted]	
15	Sadije	Jakupi	F	[redacted]	[redacted]	

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Planin Zhvillimor të Arsimit 2025-2027

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së konsultimit: **16.08.2024**. 11:05 - 11:55

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia	Emaili	Nr.Tel	Nënshkrimi
1	Vesel	Krasniqi	M	[redacted]	[redacted]	
2	Soli	Bokmaj	M	[redacted]	[redacted]	
3	Lulzim	Orina	M	[redacted]	[redacted]	
4	Driton	Susuri	M	[redacted]	[redacted]	
5	Gyla	Lugiqi	F	[redacted]	[redacted]	
6	Hilmi	Rexhepi	M	[redacted]	[redacted]	
7	Aliza	Bilibani	M	[redacted]	[redacted]	
8	Ekrem	Bajraktari	M	[redacted]	[redacted]	
9	Adelina	Hoxhaj	F	[redacted]	[redacted]	
10						
11						
12						
13						
14						
15						

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 531/24 Dt. 30.08.2024

Procesverbali i mbajtjes së konsultimit publik me qytetarë për Planin Zhvillimor të Arsimit për Komunën e Prizrenit 2025-2027

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **08.08.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/08/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Planin-Zhvillimor-te-Arsimit-2025-2027-Shq-Bosh-Tur.pdf

Në facebook: https://www.facebook.com/share/p/wTMHnqjbHWoLoWvk/?mibextid=oFDknk

Në platformë: https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42573

Njoftimi si lajm në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-planin-zhvillimor-te-arsimit-2025-2027/

Me 12.08.2024, njoftimi dhe plani (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 26.07.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-konsultim-publik-per-projekt-planin-zhvillimor-te-arsimit-2025-2027/

Në facebook:

https://www.facebook.com/share/p/637A7KQfW7Gh1pVh/?mibextid=oFDknk

Konsultimi ka nisur ne oren: 11:00 në shtëpin e Bardhë, hapjen e dëgjimit e bëri drejtoresha e DKA-së Luljeta Veselaj Gutaj, e cila i përshëndeti të pranishmit, e bëri një përshkrim të përgjithshëm të planiz zhvillimor të arsimit, dhe i inkurajoj të pranishmit të kontribuojnë me ide dhe kërkesa që qojnë në znvillimin e arsimit në Komunë.

Gjithashtu drejtoresha e DKA-së Luljeta Veselaj Gutaj thekësoj se plani i arsimit është produkt i punës së përbashkët të personelit të Drejtorisë Komunale të Arsimit, të drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve, të komunitetit të prindërve dhe të organizatave joqeveritare. Ky plan zhvillimor komunal u hartua përmes një procesi të strukturuar mirë dhe me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes, duke u mbështetur në nevojat reale për zhvillimin e arsimit në Komunën e

Prizrenit, si dhe në Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2022-2026, të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Plani Zhvillimor i Arsimit për Komunën e Prizrenit është përqendruar në shtatë fusha tematike: 1) Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunë; 2) Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore; 3) Përmirësim domethënës i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla; 4) Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimdhënie cilësore; 5) Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla; 6) Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit të hershëm; dhe 7) Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës, si dhe janë mbledhur të dhëna që shërbyen për qëllime të planifikimit. Pesë fushat e para tematike përkojnë me pesë fushat e cilësisë, gjersa dy fushat e fundit janë përzgjedhur nga komuniteti arsimor i Prizrenit si fusha të rëndësisë së veçantë të cilave duhet dhënë prioritet. Në vijim u formuluan vizioni dhe misioni i Planit Zhvillimor të Arsimit për periudhën 2025-2027.

Poashtu edhe për përmbajtjen e planit konsulenti i angazhuar Arben Shala e prezantoi në detaje përmbajtjen e planit i cili bazohen në shtatë objektiva:

Plani Zhvillimor i Arsimit ka shtatë objektiva strategjikë, nga një për secilën fushë me interes:

1. Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunës
2. Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore
3. Përmirësim domethënës i mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla
4. Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimdhënie cilësore
5. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla
6. Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit të hershëm
7. Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës

Për secilin objektiv strategjik janë përcaktuar masat që çojnë në arritjen e tij, gjithsej 34 syresh. Po ashtu është prezantuar një analizë e rrezikut që identifikon masat parandaluese për rreziqet e perceptuara për zbatimin e Planit Strategjik.

Plani i veprimit dhe buxheti janë hartuar për gjithë periudhën e zbatimit të Planit Zhvillimor të Arsimit, duke filluar nga viti 2025 deri në vitin 2027. Vlera e mjeteve të nevojshme për zbatimin e Planit, pa llogaritur shpenzimet operative të zakonshme, kap shumën prej € 5.472.800 Plani është që disa shpenzime për realizimin e Planit Zhvillimor të mbulohen nga burimet vetanake të Komunës, ndërsa disa të tjera nga Buxheti i Kosovës ose donatorët.

Dokumenti përfundon me kornizën për vlerësimin e performancës, e cila përcakton treguesit mbi bazën e të cilëve do të vlerësohet progresi për secilin nga shtatë objektivat e planit zhvillimor dhe

si e tillë përmban caqet që duhet arritur gjatë periudhës së zbatimit të Planit, si dhe gjendjen e tanishme të treguesve.

Vlora Karavidaj – drejtoreshë në shkollën fillore "Lekë Dukagjini", propozoj që të përfshihen programet e mendimit kritik në biblotekat e shkollave, ku thekësoj rekomandimin që të gjitha shkollat të kenë biblotekën e vetë dhe komuna t'i pajisë me libra.

Procesmbajtës:

Idriz Kryeziu





PROJEKT

Plani Rregullues i Hollësishëm

ZONA E VEÇANTË "PARKU I BIZNESIT"

PRIZREN





INSI SH.P.K

2024

PRISHTINË

PËRMBAJTJA

1. HYRJE 7

1.1. Baza ligjore për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm 7

1.2. Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren 8

1.3. Qëllimi i Planit Rregullues të Hollësishëm 11

1.4. Ndërlidhja me Hartën Zonale të Komunës 11

1.4.1. Zonë Industriale - ZI 11

1.4.2. Shfrytëzimi i tokës 12

1.5. Shqyrtimi i përgjithshëm i Planeve Rregulluese paraprake që vlejnë për sipërfaqen që mbulohen me planin aktuale 14

1.6. Ndryshimet dhe plotësimet e mundshme të Hartës Zonale Komunale 14

2. SIPËRFAQJA E PLANIFIKUAR 15

2.1. Kufijtë e sipërfaqes së planifikuar 15

2.2. Parcelat kadastrale brenda sipërfaqes së planifikuar dhe pronësia 16

2.2.1. Zgjerimi i kufijve dhe e parcelat e shtuara 17

2.3. Aprovimi i Kufijve Përfundimtarë 21

2.4. Gjendjen Ekzistuese për zonën e Veçantë "Parku i Biznesit" 25

2.4.1. Zona e Veçantë "Parku i Biznesit " në raport me zonat kontaktuese 25

2.4.2. Zona e Veçantë "Parku i Biznesit" në kontekst të ngushtë hapësinor 25

2.4.3. Inçizimi gjeodezik dhe struktura pejsazhore e lokacionit 26

2.4.4. Infrastruktura Teknike dhe Rrugore 28

2.5. Vlerësimi i gjendjes së sipërfaqes së planifikuar, si 34

Analiza të hollësishme të gjendjes fizike, sociale, ekonomike e mjedisore; 34

2.5.1. Gjendja fizike e zonës 34

2.5.2. Gjendja sociale 34

2.5.3. Gjendja ekonomike 36

2.5.4. Gjendja mjedisore 37

2.6. Studime të tjera mbështetëse të bazuara mbi gjendjen ekzistuese e që janë me rëndësi për fushën tematike; 37

2.6.1. Hulumtimi mbi Identifikimin e ekonomive familjare në komunën e Prizrenit 2021 38

2.6.2. Vlerësimin Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal 2013 - 2025 38

2.6.3. Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Prizrenit 2022-2030 38

2.6.4. Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2014-2023 39

2.7. Identifikimi i problemeve dhe çështjeve që duhen përmirësuar; 39

2.8. Veçoritë tipike natyrore, ekonomike e sociale. 39

3. SKENARËT E ZONËS SË PLANIFIKUAR 40

3.1. Sfidat, Mundësitë dhe Konkluzionet 40

3.1.1. Sfidat: 40
3.1.2. Mundësitë: 40
3.1.3. Konkluzionet:..... 40
3.2. Skenarët e propozuar 41
3.2.1. Skenari i Parë (I) 42
3.2.2. Skenari i Dytë (II) 42
3.2.3. Skenari i Tretë (III) 45
3.3. Korniza zhvillimore..... 47
3.3.1. Qëllimet dhe Objektivat 47
3.3.2. Konceptin e Zhvillimit Hapësinor 48
4. KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS 48
4.1. Kushtet Zhvillimore dhe ndërtimore për Zonat Industriale 49
4.2. Kushtet e përgjithshme të rregullimit, të përcaktuara si rregullore standarde për zhvillim që vlejnë për të gjitha parcelat kadastrale brenda kufirit të sipërfaqes së planifikuar 50
4.2.1. Kërkesat minimale për vendparkingje 50
4.2.2. Sigurimi i ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese..... 50
4.2.3. Qasja adekuate e parcelës kadastrale në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike..... 50
4.2.4. Specifika projektuese për zhvillim të peizazhit, ndriçimit artificial dhe mobilierisë urbane..... 50
4.2.5. Shfrytëzimet e tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore për parcela kadastrale individuale apo të grupuara dhe lokacioneve specifike, siç janë: 50
4.3. Kushtet Zhvillimore dhe ndërtimore për zonat e banimit individual 52
4.3.1. Shfrytëzimet e tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore për parcela kadastrale individuale apo të grupuara dhe lokacioneve specifike, siç janë: 52
4.4. Kushtet e përgjithshme të rregullimit, të përcaktuara si rregullore standarde për zhvillim që vlejnë për të gjitha parcelat kadastrale brenda kufirit të sipërfaqes së planifikuar për banim..... 52
4.4.1. Kërkesat minimale për vendparkingje 52
4.4.2. Sigurimi i ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese..... 52
4.4.3. Qasja adekuate e parcelës kadastrale në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike..... 52
4.4.4. Specifika projektuese për zhvillim të peizazhit, ndriçimit artificial dhe mobilierisë urbane..... 52
4.5. Kushtet Zhvillimore dhe ndërtimore për zonat komerciale 53
4.5.1. Shfrytëzimet e tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore për parcela kadastrale individuale apo të grupuara dhe lokacioneve specifike, siç janë: 53
4.6. Kushtet e përgjithshme të rregullimit, të përcaktuara si rregullore standarde për zhvillim që vlejnë për të gjitha parcelat kadastrale brenda kufirit të sipërfaqes së planifikuar zona komerciale..... 54
4.6.1. Kërkesat minimale për vendparkingje 54
4.6.2. Sigurimi i ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese..... 54
4.6.3. Qasja adekuate e parcelës kadastrale në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike..... 54
4.6.4. Specifika projektuese për zhvillim të peizazhit, ndriçimit artificial dhe mobilierisë urbane..... 54
4.7. Kushtet Zhvillimore dhe ndërtimore për zonat rekreative-turistike..... 55

4.7.1. Shfrytëzimet e tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore për parcela kadastrale individuale apo të grupuara dhe lokacioneve specifike, siç janë: 55
4.8. Kushtet Ndërtimore: 55
4.8.1. Rregullat e rregullimit të tokës, duke përfshirë parcelimin dhe ri parcelimin e parcelave kadastrale; 55
4.8.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës përmbajnë masa mbrojtëse për sipërfaqen e planifikuar, siç janë: 56
5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT 58
5.1. Kategorizimi i rrugëve sipas nivelit të shërbimit dhe kufizimit të shpejtësisë: 58
5.1.1. Materialet e konstruksionit të poshtëm dhe të epërm të rrugës 59
5.1.2. Profilet e rrugëve 59
5.1.3. Trotuaret, shiritat për këmbësor dhe për biçikleta 59
5.1.4. Objektet për largimin e ujit nga rruga; 60
5.1.5. Brezat rrugor nga të dy anët e rrugës; 60
5.1.6. Sinjalizimi vertikal, horizontal, si dhe semaforët; 60
5.1.7. Pajisjet e rrugëve (pajisjet mbrojtëse mjedisore dhe të zhurmës, ndriçimi publik, etj.). 60
5.2. Detajet e komunikacionit, siç janë: 60
5.2.1. Qarkullimi i trafikut; 60
6. INFRASTRUKTURA TEKNIKE 61
6.1. Ujësjellës 61
6.1.1. Koncepti i furnizimit me ujë dhe sasitë e nevojshme 61
6.1.2. Rrjeti i furnizimit me ujë të pijes 61
6.1.3. Rrjeti i furnizimit me ujë teknologjik 61
6.2. Kanalizim 62
6.2.1. Sistemi i kanalizimit fekal 62
6.3. Sistemet e drenazhimit të ujërave atmosferik 62
6.3.1. Analiza e ujërave atmosferike 62
6.4. Energji elektrike 63
6.4.1. Nevojat për ndërtimin e kapaciteteve energjetike 63
6.4.2. Kushtet teknike për shtrirjen e rrjetit elektrik 64
6.4.3. Kanalizimi Kabllovik 65
6.4.4. Puseta Kabllovike 66
6.5. Telekomunikacioni përfshirë lidhjet e internetit 66
6.5.1. Kushtet tekniko-urbanistike 67
6.6. Mbrojtje nga zjarri 68
7. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE 68
7.1. Parqet publike dhe hapësirat e hapura publike 68
8. PLANI I ZBATIMI 69

8.1. Plani investiv 69
8.1.1. Mënyrat e financimit 69
8.1.2. Plani financiar i projektit 69
8.1.3. Arsyeshmëria ekonomike 70
8.1.4. Supozimet për modelin financiar 70
9. ADMINISTRIMI, ZBATIMI DHE MONITORIMI I ZBATIMIT 70
10. NDRYSHIM PLOTËSIMET DHE PËRJASHTIMET 72
11. VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR 72
12. PËRKUFIZIMET 72
13. PJESA HARTOGRAFIKE 76
14. PROCESET PËR NDRYSHIME PLOTËSIME, PËRJASHTIME, JO-KONFORMITETE DHE BONUSE ZOONIMI 76
14.1. Ndryshim Plotësimet 76
14.2. Përjashtimet 77
14.2.1. Përjashtimet për nevojat e personave me aftësi të kufizuara 77
14.3. Jokonformitetet 78
14.4. Zbatimi i bonuseve të zonimit 78
14.5. Interpretimi dhe ankesat 80
14.5.1. Interpretimi 80
14.5.2. Ankesat 80
14.6. Zbatimi dhe monitorimi 80
14.6.1. Zbatimi 80
14.6.2. Monitorimi 80
14.7. Dispozitat kalimtare 81

Lista e Tabelave

Tabela 1 Parcelat inicuese në zonën e veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren 16
Tabela 2 Pronësia e parcelave të shtuara 20
Tabela 3 Pronësia e parcelave sipas të dhënave kadastrale 24
Tabela 4 Veçoritë hapësinore të blloqeve 44
Tabela 5 Veçoritë hapësinore të blloqeve 46
Tabela 6 Kushtet e përgjithshme 49
Tabela 7 Kushtet e përgjithshme 49
Tabela 8 Shfrytëzimet e lejuara brenda zonës së veçant “Parku i Biznesit”- Prizren 51
Tabela 9 Kushtet e përgjithshme 52
Tabela 10 Kushtet e përgjithshme 53
Tabela 11 Kushtet e përgjithshme 55
Tabela 12 Veçoritë hapësinore të gjelbërimit 68
Tabela 13 Veçoritë hapësinore të gjelbërimit, sportit, rekreacionit dhe argëtimit 68

Lista e Hartave

Harta 1 Shfrytëzimi Aktual i Tokës 14
Harta 2 Parcelat Kadastrale 17
Harta 3 Pronësia e parcelat kadastrale të përfshira në zonën e veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren 21
Harta 4 Pozita gjeografike e Parkut të Biznesit 25
Harta 5 Parku i Biznesit në Kuptimin në kuptimin e ngushtë hapësinor 26
Harta 6 Prerjet karakteristike të terrenit 27
Harta 7 Shtrirja e rrugëve ekzistuese 33

Lista e Figurave

Figura 1 Parcelat Inicuese 15
Figura 2 Parcelat e shtuara 18
Figura 3 Inçizimet Gjeodezike te lokacionit ekzistues 27
Figura 4 Peizazhi ortogonal i zonës 35
Figura 5 Skenari i parë (I) nga Plani Ekzistues – PRrH zona e veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren 42
Figura 6 Skenari i dytë (II) nga Harta Zonale Komunale – PRrH zona e Veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren 44
Figura 7 Skenari i tretë (III) – PRrH zona e Veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren 46
Figura 8 Profilet e rrugëve– PRrH zona e Veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren 59

1. HYRJE

1.1. Baza ligjore për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm

Me nxjerrjen e ligjit për planifikimin hapësinor Nr. 04/l-174, janë përcaktuar parimet bazë të planifikimit hapësinor, kushtet dhe mënyrën e zhvillimit dhe rregullimit hapësinor, llojet, ecuritë dhe përmbajtjen e planeve, përgjegjësitë e subjekteve administrative të nivelit qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, mbikëqyrjen administrative për zbatimin e këtij ligji, si dhe aktivitetet të cilat ndërmerren në planifikim hapësinor dhe rregullim territorial në Republikën e Kosovës.

Ligji i ri i planifikimit por edhe ndërrimi i disa ligjeve tjera të sistemit të planifikimit hapësinor, ndryshuan bazën ligjore, me këtë rast edhe përgjegjësitë dhe kërkesat në kuvendin dhe autoritetin përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor në nivel qendror dhe lokal. Duhet theksuar se baza ligjore është kompletuar edhe me nxjerrjen e akteve nënligjore si: Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 mbi Elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut, e sidomos Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Në këtë vazhdimësi, kemi edhe shumë akte tjera nënligjore që janë miratuar dhe janë të rëndësishme në sistemin e planifikimit hapësinor.

Plani rregullues i hollësishëm gjithashtu bazohet në Planin Zhvillimor Komunal të miratuar me datën 17.09.2013 si dhe Hartën Zonale Komunale të miratuar me datën 04.04.2022.Duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e nivelit komunal, me datën 07.12.2022 Komuna e Prizrenit mori vendimin për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren. (Kopja e vendimit është bashkangjitur në Shtojcën 1 të këtij dokumenti). Pas marrjes së vendimit për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren, Komuna ka shpallur konkurs projektimi për hartim të dokumentit përmes përkrahjes profesionale në procesin e hartimit të këtij dokumenti dhe ka përzgjedhur kompaninë "INSI" Prishtinë.

Pas çdo faze të përgatitjes së këtij dokumenti, Komuna ka organizuar diskutime publike.

Gjatë kësaj periudhe një mujore të Shyqrtimit Publik nga data 03.06.2024 deri më 12.07.2024 janë pranuar gjithsej: 9 komente.

Sipas afateve ligjore Komuna u është përgjigjur vërejtjeve, sugjerimeve, komenteve, peticioneve të pranuara gjatë shqyrtimit publik dhe ka hartuar raportin e shqyrtimit publik për Projekt Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren.

Propozimi për Planin Rregullues të Hollësishëm Zona e veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren u është dorëzuar anëtarëve të asamblesë Komunale për trajtim me datën 01.11.2024.

Plani Rregullues i Hollësishëm – Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren, plotëson dhe zbaton qëllimet dhe objektivat e Planit Zhvillimor Komunal 2013- 2025 dhe Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit 2022-2030.

Asambleja komunale ka aprovuar Planin Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren me datën xx.yy.zzzz.

1.2. Proceset dhe ekipet e përfshira në hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren

Autoriteti komunal, përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor në Prizren, gjatë hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren është kujdesur që të sigurojë pjesëmarrjen publike, të ketë një proces transparent dhe pa diskriminim, të ofrojë qasje publike në të gjitha të dhënat, të ndërmarrë fushatë informimi për informimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes publike gjatë hartimit të këtij dokumenti, të organizojë diskutime publike dhe forma tjera të pjesëmarrjes publike.

Procesi ka qenë i konceptuar dhe i organizuar në atë formë që iu ka përshtatur punës së komunës dhe mund të konsiderohet racional dhe i qëndrueshëm. Është formuar ekipi komunal i planifikimit në cilësinë e bartësit kryesor në procesin e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren. Roli i kompanisë profesionale në proces ishte hartimi i projektit në përputhje me rregullat dhe dispozitat ligjore në fuqi, dhënia e udhëzimeve për rrjedhën e këtij procesi dhe mënyrën e implementimit të tij, hapat që duhet të zhvillohen gjatë hartimit dhe pas aprovimit të tij, pjesëmarrjen e të gjithë akterëve, transparenca, si dhe për ngritjen e kapaciteteve të komunës.

Në fillim të procesit jemi dakorduar që të sigurohet të paktën një diskutim publik në secilën fazë të procesit, të sigurohet diskutime publike që sjellin së bashku të gjitha palët e interesuara dhe relevante (qytetarët, bizneset, sektori publik dhe privat, OJQ-të, ekspertët etj., të bëhet njoftimi publik për diskutimet publike së paku 8 ditë para mbajtjes së diskutimit publik (përmes ftesave, letrave njoftuese publike, mediave qendrore apo lokale, të shqyrtohen të gjitha propozimet dhe vërejtjet e dhëna gjate diskutimeve publike nga autoriteti i planifikimit hapësinor për përfshirjen e mundshme të tyre në projekt dokumentin e planifikimit hapësinor.

Bazuar në përgjegjësitë e autoritetit të planifikimit hapësinor si dhe procedurat për pjesëmarrje dhe përfshirje të spektrit të gjerë të publikut, që nga fillimi dhe përgjatë të gjitha fazave të procesit të planifikimit është bërë njoftim paraprak i palëve të interesuara dhe publikut, për kohën, vendin dhe qëllimin e mbajtjes se diskutimeve publike, është siguruar pjesëmarrja e personave fizikë dhe juridikë, pjesëmarrje e shoqatave apo organizatave në hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren, për të cilat janë përgatitur fotografi, procesverbale dhe lista nga takimet e zhvilluar.

Në këtë formë ka pasur disa diskutime, konsultime, debat të lirë dhe të hapur me publikun dhe hisedarët tjerë, të organizuar nga komuna bazuar në parimet e qeverisjes së mirë. Procesi ka qenë cilësor që nga fillimi i këtij procesi.

Në fazën e fundit të procesit, komuna ka marrë vendim për organizimin e shqyrtimit publik duke përcaktuar me hollësisht format e pjesëmarrjes publike gjatë fazës së shqyrtimit publik, duke e konsideruar shqyrtimin publik si një ngjarje të hapur për pjesëmarrje publike, e zhvilluar në vendin e përshtatshme (sallën e Kuvendit komunal) nga autoriteti i planifikimit hapësinor, i cili përmes njoftimit publik i ka ftuar qytetarët, ekspertët dhe palët e interesuara për të parashtruar kundër Prizrenit, komentet apo sugjerimet, para finalizimit të Planit Rregullues të Hollësishëm.

Vendimet sipas Udhëzimit Administrativ për organizimin e shqyrtimit publik të Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren i ka nxjerrë Kuvendi Komunal.

Njoftimi publik është bërë tetë (8) ditë para hapjes së shqyrtimit publik dhe është përcaktua kohëzgjatja e shqyrtimit publik prej tridhjetë (30) ditësh. Njoftimi për organizimin e shqyrtimit publik është publikuar në tri gazeta të përditshme, në faqen e internetit të komunës dhe në mediat televizive qendrore dhe lokale.

Te gjitha propozimet dhe vërejtjet që janë paraqitur nga publiku brenda afatit kohor të përcaktuar janë përfshirë në Raportin mbi shqyrtimin publik. Raporti ka përfshirë edhe regjistrin e pjesëmarrësve që kanë dhënë propozime dhe vërejtje me shkrim në projekt dokumentin e Planit Rregullues të Hollësishëm brenda afatit dhe mënyrës së përcaktuar në udhëzimin administrativ. Raporti gjithashtu përmban arsyetimin për miratimin apo refuzimin e propozimeve dhe vërejtjeve duke mos përfshire propozimet dhe vërejtjet pas afatit të dhënë. Raportit i janë bashkëngjitur edhe procesverbalet nga prezantimet dhe diskutimet gjatë shqyrtimit publik, pesë (5) ditë pas përfundimit të Raportit mbi shqyrtimin publik. Raporti i përfunduar është publikuar në faqen zyrtare të internetit të

komunës. Raporti është përgatitur nga Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor, drejtoria e për Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkërendim me drejtoritë tjera komunale bazuar në Raportin e shqyrtimit publik, propozimin e Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren është shqyrtuar dhe plotësuar përfundimisht nga operatori ekonomik i kontraktuar për hartimin e projektit në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës komunal.

Projekt dokumentit të plotësuar të planifikimit hapësinor, i është bashkëngjitur edhe Raporti i shqyrtimit publik, Pëlqimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe është proceduar për pëlqim dhe për aprovim në subjektet përgjegjëse të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

LISTA E KONTRIBUESVE

Udhëheqësit e projektit

Emri e mbiemri	Pozita
Shaqir Totaj	Kryetar i Komunës
Shpresa Osmanollaj	Menaxhere e Projektit

Drejtorët kontribuues sektorial të planifikimit

Emri e mbiemri	Drejtoria
Edin Shehu	Drejtoria e Administratës
Sulltan Badalli	Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave
Çelë Lamaj	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Pranverim Berisha	Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
Islam Ukaj	Drejtoria e Inspektorateve
Sencar Karamuço	Drejtoria e Kadastrës dhe Gjeodezisë
Luljeta Veselaj - Gutaj	Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës
Lirija Bytyqi	Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik
Ramize Shala	Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë
Bexhat Bytyqi	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Adem Morina	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Burbuqe Berisha	Drejtoria e Shëndetësisë

Lista e kontribuuesve nga INSI

Emri e mbiemri	Sektori
Ismajl Baftijari	MSc. i Ndërtimtarisë / Planer Urban
Flamur Kuçi	Dr.sc. Planifikim Urban
Valon Gërmizaj	MSc. i Arkitekturës
Armend Sokoli	MSc. Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor
Rrustem Baftijari	BSc. i Arkitekturës
Sylejman Berisha	Dr.sc. i Shkencave Mjedisore
Alban Frrokaj	MSc. i Shkencave Bujqësore
Venera Goxha	Dr.sc. i Menaxhimit të Planifikimit Urban
Fidan Kuraja	MSc. i Bankave dhe Financave/ Ekonomist
Mevlan Bixhaku	Dr.Sc. i Fushës së Trafikut dhe Transportit
Arben Hajrizi	MSc. i Ndërtimtarisë, Drejtimi Hidroteknik
Astrite Neziri	MSc. e Elektroteknikës
Merita Pelaj	MSc. e Ekonomisë
Jetmire Gallopeni	MSc. i Sociologjisë
Flaka Deda	MSc. Menaxhim Mjedisor Urban

1.3. Qëllimi i Planit Rregullues të Hollësishëm

Qëllimi është përgatitja e Planit Rregullues për vendosje të kushteve për rregullimin e hapësirës së Zonës Ekonomike. Sipas UA, një PRrH bënë:

- Krijimin e kushteve për rregullimin e hapësirës në pjesë të veçanta të zonave apo zonave të planifikuara, duke përfshirë kushtet e ndërtimit. Kushtet për rregullimin e hapësirës janë më të detajuara se kushtet e përcaktuara në Hartën Zonale Komunale dhe dokumentet tjera të planifikimit hapësinor të nivelit më të lartë.
- Krijimi i një kuadri për investime kapitale dhe projekte komplekse, duke përfshirë integrimin e zhvillimit me infrastrukturën teknike, rrugore, publike dhe sociale.
- Krijimi i specifikave me qëllim të orientimit të investimeve publike e private si: zhvillimi me orientim kah transiti, ri-zhvillimi, ruajtja e trashëgimisë kulturore e historike, zhvillim ekonomik, çështjet mjedisore, zhvillimi në sektorë, bonuset e dendësisë dhe zhvillimet e njësive të planifikuara, etj.
- Përmirësimi i shërbimeve publike përmes investimeve kapitale dhe projekteve komplekse
- Parcelimi dhe riparcelimi

1.4. Ndërlidhja me Hartën Zonale të Komunës

Komuna e Prizrenit e ka të miratuar Hartën Zonale Komunale në vitin 2022, që mbulon gjithë territorin e komunës me kushte zhvillimore dhe ndërtimore. Bazuar në Hartën Zonale Komunale, plani merr për bazë të gjitha kushtet zhvillimore dhe ndërtimore të parapara për hapësirën që trajton Plani Rregullues i Hollësishëm-Zona e Veçantë "Parku i Biznesit" – Prizren.

Duke ju referuar Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit 2022-2030, kryesisht hartës së shfrytëzimit të tokës për zonën industriale (ZI), në bazë të simbologjisë së përdorur në hartë vërejmë shfrytëzime si:

- Shfrytëzim industrial (HILUCS 2.3-2.3.5);

Në vazhdim paraqiten të gjitha kushtet zhvillimore dhe ndërtimore zonën e planifikuar industriale sipas Hartës Zonale Komunale të Prizrenit 2022 – 2030, kushte këto që do të na shërbejnë gjatë hartimit të pjesës së planifikuar të Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë "Parku i Biznesit" – Prizren.

1.4.1. Zonë Industriale - ZI

Kjo zonë është menduar për të akomoduar shfrytëzimet industriale (me depo përcjellëse dhe transport). Kjo zonë përfshinë zhvillimet që mund të paraqesin rreziqe për shëndetin dhe sigurinë, ose që mund të jenë shqetësuese për pronat tjera përreth. Është e vendosur në aso mënyre që industritë të mund të veprojnë ose të zgjerohen në mënyrë të sigurtë, pa ndikuar negativisht në zhvillimet tjera.

Sipërfaqet e zonuara si Zonë Industriale jashtë zonës urbane të komunës, kryesisht përgjatë rrugëve rajonale si dhe ajo në zonën Boka në fshatin Korishë, kanë të drejtë të zhvillojnë edhe veprimtari të industrisë së lëndës së parë (beton, çimento, gëlqere, suva, qelq, tullë, etj), duke respektuar të gjitha masat mbrojtëse të përcaktuara me kushte të përgjithshme dhe ato zhvillimore dhe ndërtimore, për të mos ndikuar negativisht në zonat tjera natyrore dhe të ndërtuara përreth.

Asnjë përdorim i ri banimor nuk mund të krijohet në zonë, për të promovuar një bazë të qëndrueshme punësimi për qytetin. Të gjitha përdorimet e kryera në këtë zonë duhet të jenë të mbyllura brenda një strukture, përveç nëse lejohet specifikisht të veprojë jashtë dyerve.

1.4.2. Shfrytëzimi i tokës

Shfrytëzimet e lejuara

Industria e produkteve të lehta

- Ndërmarrje për prodhim industrial të cilat nuk shkaktojnë erëra, zhurmë apo ndotje të ajrit dhe të cilat nuk paraqesin rrezik nga eksplodimi apo rrezatimi në rrethinë;
- Ndërmarrje për deponim dhe distribuim të cilat nuk shkaktojnë dëme të tepërta për rrethinën dhe ambientin dhe për ndërmarrje të cilat nuk paraqesin rrezik nga eksplodimi apo rrezatimi në rrethinë.

Shfrytëzimet dytësore

- Shërbimet logjistike: Kaldaja, depo dhe trafo të rrymës

Shfrytëzimet e veçanta


- **Industri e lëndës së parë:** Prodhimi i produkteve jo metalike minerale, tekstil, prodhime druri, letër, metale, gomë, plastikë;
- **Shërbime tregtare:** Zyre administrative, shërbime hotelierike, salla për ekspozim, hapësira për inkubator, qendra për konferencë, shitje të karburantit;
- **Shërbime argëtuese dhe infrastrukturë sportive.**

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për Zonat Industriale (ZI)

KUSHTET ZHVILLIMORE& NDËRTIMORE	**ZONA**		**Simboli**
	ZONË INDUSTRIALE E LEHTË		**ZI**
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (Min.)		**1500 m2**
	Sipërfaqja e parcelës (Maks.)		/
	Gjerësia e parcelës (Min.)		**40 m**
Vijat	Vija rregulluese		**Përcaktohet me vendosjen e profilit të rrugës**
	Vija ndërtimore e përparme	VN	**Min. 10m pavarësisht nga profili i**
	Vija ndërtimore anësore-djathtas/ majtas	VN	**Min. 1H** ***H paraqet lartësinë e objektitmë të lartë fqinj**
	Vija ndërtimore e pasme	VN	**Min. 1H** ***H paraqet lartësinë e objektitmë të lartë fqinj**
Lartësia	Etazhiteti		**2**
	Lartësia e objektit (maks.)		**15 m**
	Lartësia e strukturës dytësore (maks.)		**5 m**
	Raporti (përgjatë rrugës publike)		**1,5 L / 1 GJ**
	Raporti (anash)		**0.5 L / 1 GJ**
	Raporti (prapa)		**0.5 L / 1 GJ**
Intensiteti	ISHPKZh		**Maks. 50 %** **Për Parkun Industrial Maks. 70%**
	ISN		**Maks. 1.0** **Për Parkun Industrial Maks. 1.2**
	SGJAP		**30-50 %**
	SGJP		**15-30%**
	SAP		**15-20%**

Vend parkime	**Kërkesat minimale për vend parkime në përputhje me NTPH. Industria dhezanatet:** **Ndërtesat e industrive 1 VP/ 100 m²** **Ndërtesat e zanateve 2 VP/ 100 m²** **Ndërtesat e industrive 1 VP/ 100 m²** **Për shfrytëzime tjera, të sigurohen vende parkimi sipas kërkesave të NTPH. Vendparkimet mund të vendosen në tamponin gjelbërues të përparmë.**
Formësimi arkitektonik dhe estetik	**Arkitektura e këtyre objekteve që përfshihen në këto zona të lartpërmendura duhet të jetë arkitekturë bashkëkohore. Me qëllim të sigurojnë kushte sa më të mira për këto zona, duke krijuar/ruajtur një identitet dhe karakter te veçantë dhe origjinal urban dhe arkitektonik, duhet të hartohen zgjidhje urbane dhe arkitektonike në kuadër të blloqeve të ndërtimit edhe në këto zona.** **Në mënyrë që të pengohet ndotja potenciale e mjedisit përreth zonës industriale, duhet të formohet një bufer zonë e gjelbër me gjerësi 10 metra nga vija rregulluese.**
Përjashtime	**Për parcelat më të vogla se 1000 m2, lejohet ndërtimi i objekteve me shfrytëzim tregtar/prodhues. Për ndërtimin e objekteve me shfrytëzim deponim/distribuim, parcela duhet të jetë min. 2000 m2. Nuk lejohen ndryshimi i sipërfaqes totale të parcelave kadastrale nëpërmjet kërkesave për ndarje fizike të reja (pas miratimit të HZKP) të parcelave kadastrale zhvillimore më të vogla se 1000 m2.** **Për parcelat të cilat para implementimit të riparcelizimit kanë përmbushur kushtet (parcela minimale) për zhvillim të industrisë së lehtë, ky lloj zhvillimi iu lejohet edhe në sipërfaqet e ndarjeve të reja të parcelave, duke i respektuar distancat dhe të gjitha parametrat e tjera konform NTPH. Këto përjashtime zbatohen vetëm atëherë kur përmbushen kriteret e përcaktuara me nenin 37 të UA nr.24/2015.**

***Duhet të theksohet se pas hartimit të Hartës së Riparcelimit Gjerësia e parcelës (Min.) duhet të bazohet / merret nga pjesën hartografike ashtu siç është paraparë me riparcelim.*



Harta 1 Shfrytëzimi Aktual i Tokës

1.5. Shqyrtimi i përgjithshëm i Planeve Rregulluese paraprake që vlejnë për sipërfaqen që mbulohen me planin aktuale

Para hartimit të planit aktual rregullues për zonën e Parkut të Biznesit, nuk ka pasur një plan rregullues gjithëpërfshirës për këtë zonë specifike. Mungesa e nismave paraprake të planifikimit rregullator për këtë fushë ka bërë të nevojshme zhvillimin e një kuadri rregullator të detajuar për të udhëhequr në mënyrë efektive zhvillimin urban dhe infrastrukturën e ardhshme në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ. Ky plan rregullues përpiqet të adresojë nevojën ekzistuese për një qasje të strukturuar dhe të qëndrueshme ndaj zhvillimit dhe menaxhimit të zonës së Parkut të Biznesit.

1.6. Ndryshimet dhe plotësimet e mundshme të Hartës Zonale Komunale

Komuna e Prizrenit ka të aprovuar Hartën Zonale të Komunës, andaj destinimi, shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore dhe ndërtimore janë adekuate me të cilat mund të planifikojmë Planin Rregullues të Hollësishëm të Zonës së veçantë “Parku i Biznesit” në Prizren.

2. SIPËRFAQJA E PLANIFIKUAR

2.1. Kufijtë e sipërfaqes së planifikuar

Lokacioni i Parkut të Biznesit ndodhet në pjesën verilindore të qytetit të Prizrenit në lokacionin e ish-poligonit të shenjëtarisë që shtrihet në boshtin rrugor Lubizhdë – Korishë ne largësi 5 km prej qytetit. Parcelat e dedikuara për Parkun e Biznesit sipas vendimit me numër 01/011-4267 të datës 17 Korrik 2008 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit janë ngastrat me numra: 248/1, 248/2, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 260', 261, 262, 263, 264, 266, 267, 268, 269, 407 (1407), 418 (1418), dhe 451 (1451).

Sipërfaqja totale e parcelave sipas çertifikatave të pronësisë del të jetë përafërsisht rreth 43ha.




Figura 1 Parcelat Inicuese

Siç shihet nga vizatimi parcelat e parapara nuk janë të lidhura në mes vete dhe si të tilla nuk ka qenë e mundur të përdoren si sipërfaqe për zhvillimin e Parkut të Biznesit.


Për këtë arsye si dhe për arsye të funksionalizimit dhe formësimit sa më të mirë të Parkut të Biznesit nga Komuna (Departamenti i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor) është kërkuar që të bëhet lidhja fizike e këtyre parcelave përmes inkorporimit të parcelave fqinje në Parkun e Biznesit.

2.2. Parcelat kadastrale brenda sipërfaqes së planifikuar dhe pronësia

Sipërfaqja e planifikuar e Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren shtrihet brenda zonës kadastrale Prizren dhe përbëhet prej një numër 22 të parcelave inicuese prej nga shihet se të gjitha janë pronë e Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore, në përjashtim të parcelës me nr.253 e cila është e paidentifikuar.

PARCELAT INICUESE			
Nr.	**Numri i Parcelës**	**Pronari**	**Sipërfaqja sipas Certifikatës së Pronësisë m^2**
1	P-71813046-00248-1	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	227.00
2	P-71813046-00248-2	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	273.00
3	P-71813046-00249-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	5,800.00
4	P-71813046-00250-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	2,625.00
5	P-71813046-00251-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	4,693.20
6	P-71813046-00252-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	10,280.00
7	P-71813046-00253-0	Pronar Republika e Kosoves - shfrytezues Komuna e Prizrenit	2,011.90
8	P-71813046-00254-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	4,210.00
9	P-71813046-00255-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	16,000.00
10	P-71813046-00256-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	18,210.00
12	P-71813046-00261-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	5,276.00
13	P-71813046-00262-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	4,520.00
14	P-71813046-00263-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	3,027.00
15	P-71813046-00264-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	3,942.00
16	P-71813046-00266-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	7,234.00
17	P-71813046-00267-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	9,935.00
18	P-71813046-00268-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	10,513.00
19	P-71813046-00269-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	9,406.00
20	P-71813046-01407-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	6,834.00
21	P-71813046-01418-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	63,685.00
22	P-71813046-01451-1	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	219,044.00
		Totali	**407,746.10**

Tabela 1 Parcelat inicuese në zonën e veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren



Harta 2 Parcelat Kadastrale

2.2.1. Zgjerimi i kufijve dhe e parcelat e shtuara

Nevoja e lidhjes së parcelave të dhëna me kontratë, me qëllim të arritjes së një zgjidhjeje më funksionale urbanistike çon deri te shtimi i paevitueshëm i parcelave te reja.

Në Figurën e mëposhtme shihen parcelat e shtuara me numër të ngastrave:




Figura 2 Parcelat e shtuara

253, 257, 259, 265, 1393, 1404, 1405, 1406, 1409, 1411, 1412, 1413, 1414, 1426, 1431, 1435, 1436, 1437, 1438, 1440, 1441, 1442, 1443, 1444, 1445, 1446, 1447, 1448, 1449, 1450, 1452, 1454, 1455, 1456, 456, 1461, 1462, 1463, 1464, 1466, 2185, 1408/1, 1408/2, 1429/1, 1439/1, 1451/3, 1451/4, 1451/5, 258/1, 258/2, 3339/1, dhe 3339/2.

Arsye tjetër e cila detyron zgjerimin e kufinjëve te Parkut të Biznesit rrjedh edhe nga topografia e lokacionit, ku rreth 60% e parcelave kanë pjerrtësi rreth 26.8 % çka pamundëson shtrirjen dhe përmbushjen e kërkesave sipas detyrës projektuese.

Kjo dhe nevoja e lidhjes së parcelave inicuese ka si rezultat shtimin e parcelave fqinje të cilat shihen në figurën e mësipërme si dhe të detajuara janë dhënë edhe në tabelën e mëposhtme.


PARCELAT E SHTUARA			
PRONAT E KOMUNES			
Nr.	**Nr. parcelës**	**Pronari**	**Sipërfaqja sipas Certifikatës së Pronësisë m²**
1	P-71813046-00260-0	S F. Për Mbrojtje Popullore	20,159.00
	P-71813046-01416-0	Sipas certifikatës së pronësisë del se të gjitha këto parcela i takojnë parcelës me nr. 1418	
	P-71813046-01417-0		
	P-71813046-01419-0		

	P-71813046-01420-0		
	P-71813046-01421-0		
	P-71813046-01422-0		
	P-71813046-01423-0		
	P-71813046-01424-0		
	P-71813046-01425-0		
	258-1	Pronar Republika e Kosoves - shfrytezues Komuna e Prizrenit	
	258-2		
	259-0		
2	P-71813037-03340-0	Pasuria Shoqërore K.K.Prizren	
			PRONAT PRIVATE
3	P-71813046-00265-0	Antiq Marko (Krste)	7,348.00
		ONI. UD. PPK. PROGRES	
4	P-71813046-01393-0	Mojsiq Stana (UD. Xhorxha)	3,984.00
		Mojsiq Dobrivoje (Xhorxha)	
		Mojsiq Bozhidar (Xhorxha)	
5	P-71813046-01405-0	Mojsiq Stana (UD. Xhorxha)	3,403.00
		Mojsiq Dobrivoje (Xhorxha)	
		Mojsiq Bozhidar (Xhorxha)	
6	P-71813046-01426-0	Mishkoviq Stanko (Stojana)	3,115.00
7	P-71813046-01429-1	Tarbanqe Asan (Vejap)	15,936.00
8	P-71813046-01435-0	Ademi Kasëm (Dila)	847.00
9	P-71813046-01436-0	Ademi Ajvaz (Ramo)	1,645.00
		Ademi Ramiz (Ramo)	
10	P-71813046-01437-0	Ademi Rexhep (Bajram)	2,019.00
11	P-71813046-01439-1	Ramadani Jusuf (Latif)	7,686.00
		Ramadani Amit (Latif)	
		Ramadani Farush (Latif)	
		Ramadani Rexhep (Latif)	
12	P-71813046-01440-0	Todosiq Dima (Bogdana)	3,041.00
13	P-71813046-01441-0	Todosiq Stevanka (Vasila)	3,464.00
		Todosiq Susa (UD. Vasila)	
14	P-71813046-01451-5	Mojsiq Stana (UD. Xhorxha)	3,181.00
		Mojsiq Dobrivoje (Xhorxha)	
		Mojsiq Bozhidar (Xhorxha)	
15	P-71813046-01462-0	Jusufi Vajdin (Sejbit)	1,991.00
		Jusufi Zeqir (Sejbit)	
16	P-71813046-01463-0	Zdravkoviq Çedomir (Filip)	1,892.00
		Zdravkoviq Mladen (Dragutin)	
Ndër masat e propozuara të VSM-së për trajtimin e ndikimeve negative që vlerësohet se ka plani i HZK-së përfshijnë inspektimet e rregullta komunale, rritja e inspektimeve mjedisore, përdorimi i energjisë alternative në vend të nxemjes se thëngjill, trajtim parandalues me vendosje të përshtatshme të rrjeteve dhe të infrastrukturave teknike dhe mjedisore, etj.

Plani i HZK-së ka marrë parasysh kriteret e zhvillimit të qëndrueshëm, duke integruar në kohë dimensionin mjedisor dhe parametrin e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit natyror, kulturor dhe njerëzor në çdo objektiv strategjik dhe

në çdo Prioritet. Kështu, që nga fillimi plani i HZK-së vlerësohet se ka orientim miqësor me mjedisin, dhe për këtë arsye, në vlerësimin e ndikimeve mjedisore, shumë ndikime janë pozitive dhe sa prej tyre janë negative, shpesh varet nga mënyra e zbatimit të Planit.

2.6.4. Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2014-2023

Komuna e Prizrenit ka bërë planin e parë 5-vjeçar për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta sipas ligjit të mbeturinave bazuar në draftin e parë të planit master të MMN. Plani i parë 5-vjeçar i MMN përfshin krijimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave, futjen e taksës së mbeturinave, kontraktimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, dhe krijimin e një komisioni këshillues për të mbikëqyrur kontraktorët.

Komuna e Prizrenit ka filluar me sistemin e ri të Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta (taksa për mbeturina, kontraktimi i shërbimit të grumbullimit dhe mbikëqyrja nga komisioni këshillues) që nga janari 2015 bazuar në planin e parë 5 vjeçar të MMN.

Master Plani për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta (MPMMN/MMN) i Komunës së Prizrenit është bërë duke rishikuar draft planin e parë të MMN, bazuar në rezultatet e pilot projekteve dhe përvojën e fituar nëpërmjet zbatimit të Projektit. Ky master plan është bërë si një plan afatgjatë për menaxhimin e mbeturinave duke marrë në konsideratë planin e dytë 5 vjeçar për MMN (2019-2023).

Synimi i këtij Plani është që Komuna të krijojë sistemin e MMN duke prezantuar sistemin e taksës për mbeturina dhe kontraktimin e shërbimit të grumbullimit e që ka filluar së aplikuari në Kosovë për herë të parë prej vitit 2015, si një sistem i qëndrueshëm i cili do të ishte në zhvillim deri në fund të 2018, dhe me këtë të përmbushë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave ku secili qytetar gëzon të drejtën e barabartë.

Përmes këtij plani parashihej promovimi i 3R (reduce, reuse, recycle) për të minimizuar mbeturinat në një qytet model të avancuar në Kosovë, ku qytetarët, bizneset dhe qeverisja lokale punojnë së bashku. Taksa për mbeturina e cila mblidhet nga qytetarët investohet në menaxhim të mbeturinave pa humbur para dhe duke i siguruar një mjedis të përshtatshëm shoqërisë. Komuna parashihej të sigurojë transparencë duke i publikuar çdo vit të dhënat e menaxhimit të mbeturinave.

Periudha e planit master për MMN është dhjetë vjeçar duke filluar nga janari 2014 deri në dhjetor 2023. Kjo periudhë, sipas planit, ndahet në dy mandate dhe ofrohet edhe objektiva e afërt, respektivisht:

- 2014 – 2018- Krijimi i sistemit të shëndoshë të Menaxhimit të Mbeturinave.
- 2018 – 2023- Studimi i krijimit të një shoqërie të ciklit material duke promovuar 3R

Komuna e Prizrenit tashmë kishte miratuar planin e parë 5 vjeçar për gjysmën e parë për periudhën prej 2014 deri 2018.

2.7. Identifikimi i problemeve dhe çështjeve që duhen përmirësuar;

Gjatë analizave të ndryshme për Zonën e veçantë “Parku i Biznesit” janë identifikuar probleme të natyrave të ndryshme, të mëdha dhe të vogla të cilat do të i listojmë në vijim sipas rëndësisë, siç janë:

- Mungesa e shërbimeve komunale;
- Rrjeti i energjisë elektrike i pa përfunduar;
- Përmirësimi i sistemit të kanalizimit dhe largimit e trajtimit të ujërave të zeza;
- Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit;
- Infrastruktura rrugore e pa përfunduar;
- Shërbime jo të mira në menaxhim të mbeturinave.

2.8. Veçoritë tipike natyrore, ekonomike e sociale.

Lokacioni i Parkut i Biznesit ndodhet në pjesën verilindore të qytetit të Prizrenit në lokacionin e ish-poligonit të shenjëtarisë që shtrihet në boshtin rrugor Lubizhdë – Korishë ne largësi 5 km prej qytetit.

Lokacioni i përzgjedhur ofron kushte të mira për transport, si të atij publik ashtu edhe të atij privat, këmbësorëve dhe atij çiklistik. Si arterie kryesore është magjistralja Prishtinë – Prizren si dhe mundësia e lidhjes së ardhshme në autostradën Merdarë – Morinë – Durrës, e me këtë edhe mundësia e lidhjes me portin e Durrësit dhe të atij të Shëngjinit.

Sipërfaqja në të cilën do të hartohet Palni rregullues Parku i Biznesit tani përfshin sip 80.33 ha. Parcela kufizohet ne pjesën veriperëndimore me magjistralen Prizren–Therandë , në pjesën jug-perëndimore me fshatin Lubizhdë , në pjesën verilindore me fshatin Korishë.

3. SKENARËT E ZONËS SË PLANIFIKUAR

3.1. Sfidat, Mundësitë dhe Konkluzionet

3.1.1. Sfidat:

- Pjerrtësia e terrenit për planifikim e rrugëve sipas standardeve;
- Ofrimi i mundësive për ndërtim në terren me pjerrtësi të lartë;
- Forma dhe madhësia e papërshatshme e ngastrave;
- Ofrimi i shërbimeve komunale në zonë, duke përfshirë rregullimin e infrastrukturës rrugore dhe kanalizimin e ujërave të zeza;
- Mospërcaktimi i investitorëve nga ana e komunës;
- Mosdefinimi i kapaciteteve investive;
- Implementimi i zgjidhjeve nga ky plan.

3.1.2. Mundësitë:

- Mungesa e ndërtimeve në zonë;
- Afërsia me qytetin;
- Rruga transite dhe Magjistralja M2 e tangjenton lokacionin;
- Investimi nga ndërmarrjet ndërkombëtare dhe lokale;
- Format e ndryshme të partneritetit publiko—privat (EU—Autoriteti qendror—Autoriteti lokal—Bizneset—pronarët);
- Mundësitë e investimeve nga investirorë të jashtëm;
- Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese të ujërave per nevoja vetjak;
- Afërsia e korridorit të autoudhës së re Merdarë – Morinë.

3.1.3. Konkluzionet:

Siç u pa nga informatat e lartë shënuara 74.70% nga prona në zonën për të cilën përgatitet Plani Rregullues është pronë publike dhe gjatë trajtimit të mëtejmë kjo mundëson një planifikim të mirëfilltë të zonës, duke lejuar ekipin të plotësoj kushtet dhe standardet e planifikimit për zona ekonomike. Gjithashtu kjo i jep mundësi edhe komunës që ti filloj më shpejtë punimet sipas planit dhe ka kosto më të vogël të realizimit.

Forma e parcelave në përgjithësi përkon me kufirin e zonës, dhe pothuajse komplet zona është e lirë nga ndërtimet. Kjo e bënë më të lehtë krijimin e blloqeve përbrenda zonës si dhe planifikimin e ri parcelimit. Gjithashtu kjo ndikon edhe në planifikim më të lehtë të rrugëve. Në këtë aspekt, problem të vetëm shkakton pjerrtësia e terrenit, që në disa raste arrin të jete edhe mbi 28%. Kjo forcon që gjatë planifikimit të rrugëve të përcjellim vijat e izohipsave sa të jetë e mundur, për të mos krijuar pjerrtësi të mëdha që do te pengonin qarkullimin e mjeteve të transportit.

Pjerrtësia ndikon gjithashtu edhe në ndarje të parcelave, prandaj gjatë planifikimit duhet të bëhet ndarje që do tu mundësonte qasje në parcelë mjeteve por edhe të jepet mundësi për ndërtim të mjaftueshëm dhe të barabartë.

Gjatë destinimit të parcelave, duhet pasur kujdes dhe që në afërsi të shtëpive të banimit rreth zonës të vendosen industri të lehta apo shërbime që nuk do të kishin ndikim negativ në banim. Gjithashtu duhet të mendohen ndotje të mundshme të mjedisit dhe të planifikohen masa mbrojtëse, çoftë breza të gjelbër apo edhe të tjera, përkatësisht prej llojit të ndotjes.

3.2. Skenarët e propozuar

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm zona e veçantë – "Parku i Biznesit" - Prizren, kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social, infrastrukturor dhe mjedisor konceptin e zhvillimit Hapësinor përmes disa skenarëve të mundshëm të zhvillimit hapësinorë të komunës.

Skenarët janë trajtuar duke u bazuar në analizat sipas fushave tematike të vizionit, qëllimeve, objektivave dhe përmbajtjeve të tjera të lartpërmendura, dhe është tentuar të trajtohen me bazën sa ma reale të mundshme. Mundësitë reale, kërkesat dhe vlerësimet me shtrirje dhe dimension të propozuar hapësinor, për të tre skenarët e trajtuar, paraqiten me përshkrim të përmbledhur tekstual dhe harta kryesisht konceptuale, të cilët i kanë analizuar dhe i përmbajnë komponentët e kërkuara me udhëzim administrativ për përmbajtjet kryesore të skenarit.

Skenarët paraqesin drejtimet e dëshiruara të zhvillimit, duke definuar shkallën maksimale të mundësive të zhvillimit. Skenarët në vazhdim janë zhvilluara duke u bazuar në analizat e gjendjes ekzistuese, mundësive zhvillimore dhe pretendimeve të dëshiruara të cilat mund të materializohen në realitetin lokal dhe të paraqesin mundësi reale për zhvillim.

Çdo skenarë është përshkruar në mënyrë kualitative dhe kuantitative. Përshkrimi kuantitativ ofron një sërë informatash për rreth funksioneve të ndryshme si infrastruktura teknike, rrugët dhe kategorizimi I tyre, parcelimi dhe destinimi I parcelave. Përcaktimi dhe definimi i nevojave për çdo skenarë është bërë në bashkëpunim me kontributin e ekspertëve, palëve me interes të veçantë si dhe komunës.

Në kuadër të përshkrimit kualitativ ofrohet një vizion i ardhshëm, përkatësisht një hartë, çoftë edhe skematike që prezanton secilin funksion. Për këtë, faktorë të rëndësishëm janë shtrirja apo pozicioni gjeografik, rrjetet ekzistues të infrastrukturës teknike dhe natyrore dhe sipërfaqet e shfrytëzimit të tokës. Skenarët e zhvilluara, të prezantuara në vazhdimësi mundësojnë krijimin e opinionit dhe idesë së drejtimit të zhvillimit në të ardhmen, duke krahasuar opsionet e ndryshme të zhvilluara sipas aspekteve të ndryshme, siç janë:

- Realizueshmëria financiare;
- Disponueshmëria e kapaciteteve lokale për administrim dhe zbatim;
- Shkalla e mbështetjes publike dhe
- Shkalla e kualitetit të mjedisit.

Për zonën e veçantë "Parku i Biznesit" – janë zhvilluar tre skenarë të ndryshëm që paraqesin këto zhvillime.

3.2.1. Skenari i Parë (I)

Ky skenar rrjedh nga plani rregullues I hollësishëm I kaluar I cili parasheh përmirësim të infrastrukturës ekzistuese të rrjetit rrugor për Zonën e Parkut të Biznesit, duke shfrytëzuar maksimalisht rrugët dhe korridoret ekzistuese (Sigurimi i transport publik, ecjes dhe çiklizmit); zhvillim të infrastrukturës ekzistuese sociale dhe publike, duke specifikuar hollësisht llojin, kapacitetin, sipërfaqen, vendndodhjen dhe kushtet për rregullimin e hapësirës. Parashihet gjithashtu edhe zhvillimi dhe përmirsimi i infrastruktrës ekzistuese të kanaizimit, ujitjes dhe ujësjellsit. Gjithashtu, janë të definuara shumë qartë strukturat hapësinore për indistri të lehtë, afarizëm, servise, hotelieri, hapësira shfrytëzuese, të rekreimit, hapsirat e gjelbërta si edhe të funksioneve të përziera, të cilat rrjedhin nga plani Paraprak I Hollësishëm për Parkun e Biznesit në Prizren.

Ky skenar promovon qasje të integruar në mes të sektorëve të zhvillimit, infrastrukturë funksionale si dhe mjedis të qëndrueshëm dhe ndërlidhet ngushtë me deklaratën e Vizionit si dhe Objektivat e Qëllimet e Planit Rregullues të Hollësishëm zona e veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren .



Figura 5 Skenari i parë (I) nga Plani Ekzistues – PRrH zona e veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren

3.2.2. Skenari i Dytë (II)

Ky skenar është i projektuar duke u bazuar në kushtet e paraqitura me Hartën Zonale Komunale.

Ky skenar kryesisht bazohet në vendosjen të rrugëve dhe ndarje të parcelave duke përcjellë terrenin, pra në vijë të njëjtë me izohipse.

Në dimensionin kualitativ, ky skenar ndanë Zonën Ekonomike në disa blloqe, me madhësi të ndryshme, duke i dhënë një kahe të dëshirueshme zhvillimit të gjithë zonës.

Përmes këtij skenari arrihet që të gjitha parcelat të kenë një qasje sa më të lehtë, por edhe të mos behët zhvendosje e madhe e dheut, dhe ndryshim i madh i terrenit.

Gjatë planifikimit të rrugëve janë marrë për bazë rrugët ekzistuese dhe janë inkorporuar në skenar ku ka qenë e mundur. Kjo është bërë që të ulet kostoja e projektit, por edhe njëkohësisht të ruhen vijat tanimë të njohura për banorë për rreth zonës.

Sipas Skenarit 2, planifikohet që të zhvillohen zonat vijuese me gjithsejtë:

- 16,553.79 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim komercial;
- 190,354.08 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim industrial;
- 50,592.53 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim servisimi, shërbime dhe prodhime zejtare;
- 38,186.80 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim servisimi, shërbime, prodhime zejtare dhe inkubatorë;
- 28,771.24 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim servisim, shërbime dhe deponim;
- 16,493.43 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim banim individual dhe prodhime zejtare;
- 10,382.83 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim gjelbërim;
- 15,483.81 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim hotelieri.

Shfrytëzimi	Blloku	ISN	Etazhiteti	Sipërfaqja e tokës (m^2)	Bruto sipërfaqja e planifikuar për ndërtim (m^2)
Nënzonë Komerciale	D1	ISN=1.0	P+2 + NK	16,553.79	16,553.79
Nënzonë Industriale	A1	ISN=1.2	P+2 + NK	16,873.90	20,248.68
Nënzonë Industriale	A8	ISN=1.2	P+2 + NK	13,417.45	16,100.94
Nënzonë Industriale	A2	ISN=1.2	P+2 + NK	17,059.73	20,471.68
Nënzonë Industriale	A7	ISN=1.2	P+2 + NK	17,044.48	20,453.37
Nënzonë Industriale	A9	ISN=1.2	P+2 + NK	12,528.73	15,034.48
Nënzonë Industriale	A10	ISN=1.2	P+2 + NK	16,894.28	20,273.14
Nënzonë Industriale	A6	ISN=1.2	P+2 + NK	17,823.19	21,387.83
Nënzonë Industriale	A3	ISN=1.2	P+2 + NK	16,756.29	20,107.54
Nënzonë Industriale	A11	ISN=1.2	P+2 + NK	17,590.24	21,108.28
Nënzonë Industriale	A5	ISN=1.2	P+2 + NK	15,038.92	18,046.71
Nënzonë Industriale	A4	ISN=1.2	P+2 + NK	15,900.71	19,080.85
Nënzonë Industriale	A12	ISN=1.2	P+2 + NK	13,426.15	16,111.38
Servisim, Shërbime, Prodhim Zejtarë	A14	ISN=1.2	P+2 + NK	19,020.77	22,824.92
Servisim, Shërbime, Prodhim Zejtarë	A15	ISN=1.2	P+2 + NK	31,571.76	37,886.11
Servisim, Shërbime, Prodhim Zejtarë, Inkubatorë	A16	ISN=1.2	P+2 + NK	31,822.34	38,186.80
Banim Individual dhe Prodhime Zejtare	B1	ISN=0.8	P+2 + NK	9,481.15	7,584.92
Banim Individual dhe Prodhime Zejtare	B2	ISN=0.8	P+2 + NK	3,429.88	2,743.90
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	N/A	N/A	359,999.42	N/A
Gjelbërim	D2	N/A	N/A	8,616.72	N/A
Gjelbërim	D3	N/A	N/A	1,766.11	N/A
Servisim, Shërbime dhe Deponim	A13	ISN=1.2	P+2 + NK	23,976.03	28,771.24

Banim Individual dhe Prodhime Zejtare	B3	ISN=0.8	P+2 + NK	3,582.41	2,865.93
Hoteleri	C2	ISN=1.0	P+2 + NK	7,560.05	7,560.05
Hoteleri	C1	ISN=1.0	P+2 + NK	7,923.76	7,923.76

Tabela 4 Veçoritë hapësinore të blloqeve




Figura 6 Skenari i dytë (II) nga Harta Zonale Komunale – PRrH zona e Veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren

3.2.3. Skenari i Tretë (III)

Ky skenar është i projektuar duke u bazuar në kushtet e paraqitura me Hartën Zonale Komunale dhe janë dhënë zgjidhje për pronat private duke i ndërruar pozicionet brenda zonës, si dhe duke i dhënë funksion rrugëve dhe pronave private.

Gjithashtu bazohet edhe në vendosjen të rrugëve dhe ndarje të parcelave duke përcjellë terrenin, pra në vijë të njëjtë me izohipse.

Në dimensionin kualitativ, ky skenar ndanë Zonën Ekonomike në disa blloqe, me madhësi të ndryshme, duke i dhënë një kahe të dëshirueshme zhvillimit të gjithë zonës.

Përmes këtij skenari arrihet që të gjitha parcelat të kenë një qasje sa më të lehtë, por edhe të mos behët zhvendosje e madhe e dheut, dhe ndryshim i madh i terrenit.

Gjatë planifikimit të rrugëve janë marrë për bazë rrugët ekzistuese dhe janë inkorporuar në skenar ku ka qenë e mundur. Kjo është bërë që të ulet kostoja e projektit, por edhe njëkohësisht të ruhen vijat tanimë të njohura për banorë për rreth zonës.

Sipas Skenarit 3, planifikohet që të zhvillohen zonat vijuese me gjithsejtë:

- 16,553.79 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim komercial;
- 190,354.08 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim industrial;
- 51,098.45 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim servisimi, shërbime dhe prodhime zejtare;
- 38,186.80 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim servisimi, shërbime, prodhime zejtare dhe inkubatorë;
- 28,771.24 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim servisim, shërbime dhe deponim;
- 16,493.43 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim banim individual dhe prodhime zejtare;
- 10,382.83 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim gjelbërim;
- 359,999.41 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim gjelbërim, sport, rekreacion dhe argëtim;
- 15,483.81 m2 sipërfaqe të tokës për shfrytëzim hotelieri.

Shfrytëzimi	Blloku	ISN	Etazhiteti	Sipërfaqja e tokës (m^2)	Bruto sipërfaqja e planifikuar për ndërtim (m^2)
Nënzonë Komerciale	D1	ISN=1.0	P+2 + NK	16,553.79	16,553.79
Nënzonë Industriale	A1	ISN=1.2	P+2 + NK	16,873.90	20,248.68
Nënzonë Industriale	A8	ISN=1.2	P+2 + NK	13,417.45	16,100.94
Nënzonë Industriale	A2	ISN=1.2	P+2 + NK	17,059.73	20,471.68
Nënzonë Industriale	A7	ISN=1.2	P+2 + NK	17,044.48	20,453.37
Nënzonë Industriale	A9	ISN=1.2	P+2 + NK	12,528.73	15,034.48
Nënzonë Industriale	A10	ISN=1.2	P+2 + NK	16,894.28	20,273.14
Nënzonë Industriale	A6	ISN=1.2	P+2 + NK	17,823.19	21,387.83
Nënzonë Industriale	A3	ISN=1.2	P+2 + NK	16,756.29	20,107.54
Nënzonë Industriale	A11	ISN=1.2	P+2 + NK	17,590.24	21,108.28
Nënzonë Industriale	A5	ISN=1.2	P+2 + NK	15,038.92	18,046.71
Nënzonë Industriale	A4	ISN=1.2	P+2 + NK	15,900.71	19,080.85
Nënzonë Industriale	A12	ISN=1.2	P+2 + NK	13,426.15	16,111.38
Servisim, Shërbime, Prodhim Zejtarë	A14	ISN=1.2	P+2 + NK	19,020.77	22,824.92
Servisim, Shërbime, Prodhim Zejtarë	A15	ISN=1.2	P+2 + NK	31,571.76	37,886.11

Servisim, Shërbime, Prodhim Zejtarë, Inkubatorë	A16	ISN=1.2	P+2 + NK	31,822.34	38,186.80
Banim Individual dhe Prodhime Zejtare	B1	ISN=0.8	P+2 + NK	9,481.15	7,584.92
Banim Individual dhe Prodhime Zejtare	B2	ISN=0.8	P+2 + NK	3,429.88	2,743.90
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	N/A	N/A	237,609.52	N/A
Gjelbërim	D2	N/A	N/A	8,616.72	N/A
Gjelbërim	D3	N/A	N/A	1,766.11	N/A
Servisim, Shërbime, Deponim, Prodhim	A13	ISN=1.2	P+2 + NK	23,976.03	28,771.24
Banim Individual dhe Prodhime Zejtare	B3	ISN=0.8	P+2 + NK	3,582.41	2,865.93
Hoteleri	C2	ISN=1.0	P+2 + NK	7,560.05	7,560.05
Hoteleri	C1	ISN=1.0	P+2 + NK	7,923.76	7,923.76
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	N/A	N/A	29,780.13	N/A
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	N/A	N/A	171.86	N/A
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	N/A	N/A	13,149.92	N/A
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	N/A	N/A	71,441.83	N/A
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	N/A	N/A	3,394.82	N/A
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	N/A	N/A	4,451.33	N/A

Tabela 5 Veçoritë hapësinore të blloqeve




Figura 7 Skenari i tretë (III) – PRrH zona e Veçantë "Parku i Biznesit" – Prizren

Skenari 3 është Skenari i përzgjedhur për planifikim të detajuar.

3.3. Korniza zhvillimore

Parku i Biznesit përmban një grup të objekteve industriale/komerciale, të grumbulluara në një zonë të përbashkët e cila u ofron kushtet kryesore për zhvillim të mirëfilltë të biznesit. Kjo përfshin qasje në rrymë, ujë, kanalizim, banka, postë, ndihmë të shpejtë, restorante dhe objekte të tjera të përbashkëta.

3.3.1. Qëllimet dhe Objektivat

Zhvillimi i Parkut të Biznesit asiston në kushte të favorshme dhe infrastrukturë moderne me qëllim që të promovoj zhvillimin e qëndrueshëm dhe kompetitiv të industrive lokale e rajonale. Një zonë industriale krijon kushte të përshtatshme që çdo biznes të ketë lehtësime duke i ofruar infrastrukturë teknike, në mënyrë që fokusimi të jetë në ngritje të produktivitetit.

Zhvillimi i infrastrukturës teknike duhet të bazohet në trajtimin e qëndrueshëm të infrastrukturës rrugore, energjisë elektrike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, telekomunikacionit, dhe infrastrukturës për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave në zonë. Projektet e infrastrukturës duhet të realizohen në dinamikën që do të kontribuojë në përshpejtimin e procesit të rigjenerimit ekonomik. Përgjegjës për organizimin publik dhe zhvillimin e infrastrukturës publike brenda zonës janë komuna a Prizrenit. Pra, kjo thekson interesin dhe përgjegjësinë e komunës për ofrimin e shërbimeve sa më kualitative për komunitetin që do të vendoset në zonë dhe duhet t'i kontribuojë zhvillimit të qëndrueshëm të Zonës, duke mundësuar urbanizimin e saj. Qëllimi dhe objektivat kryesore dhe afatgjate të zhvillimit të zonës synojnë arritjen e një zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës teknike, në kohë, hapësirë dhe kosto sa më të favorshme.

Një menaxhim efikas i zonës rritë zhvillimin e balancuar të bizneseve, duke i inkurajuar ato në rritje të prodhimtarisë. Kjo do të krijoj vende të reja të punës, dhe do të zvogëloj numrin e të papunësuarve si atyre lokal ashtu edhe nga rrethina. Një zhvillim efektiv i administratës mund edhe të bëj promovimin e eksportimit të mallrave, duke ndikuar kështu në rritje ekonomike të vendit.

Zhvillimi i industrisë dhe ngritja ekonomike e qytetit është njëri prej synimeve më të rëndësishëm për komunën e Prizrenit. Me Hartimi dhe aprovimi i PZHK-së dhe HZK-së komuna e Prizrenit si dhe strategjitë tjera me karakter të zhvillimit lokal mundësojnë shpërfaqjen e potencialeve të plota ekonomike të zonës dhe adresimin e tyre strategjik. Për të arritur efikasitet të plotë të këtij qëllimi nevojitet që gjatë planifikimit zona të tilla të analizohen me kujdes, dhe këto të pozicionohen sipas standardeve të duhura. Me krijim të zonave të posaçme të destinuara për industri, gjatë planifikimit mënjanohet problemi i grupimit të industrive në brendi të qendrës së qytetit. Kjo ulë ndikimet negative në mjedis dhe mirëqenie të banorëve.

3.3.1.1. Zhvillimi ekonomik

1. Sigurimi i hapësirave të përshtatshme për zhvillim të kategorisë së lëndës së parë, prodhimtari e rëndë, prodhimtari e lehtë, përpunim/paketim/ deponim, shërbime tregtare.
2. Lehtësimi i procesit të sigurimit të hapësirës për përpunim të lëndës së parë, prodhimtari e rëndë, prodhimtari e lehtë, përpunim/paketim/deponim, shërbime tregtare.

3.3.1.2. Infrastruktura rrugore

1. Sigurimi i infrastrukturës rrugore adekuate për zhvillim të kategorisë së lëndës së parë, prodhimtari e rëndë, prodhimtari e lehtë, përpunim/paketim/ deponim, shërbime tregtare:
    a. Rrugëve industriale që lidhin parkun me zonën përreth;
    b. Rrugëve servisore që sigurojnë qasje në rrugë për parcelat industriale.

3.3.1.3. Infrastruktura teknike

1. Sigurimi i infrastrukturës teknike- ujësjellës adekuate për zhvillim të kategorisë së lëndës së parë, prodhimtari e rëndë, prodhimtari e lehtë, përpunim/paketim/ deponim, shërbime tregtare.
2. Sigurimi i infrastrukturës teknike- grumbullim, menaxhim dhe trajtim të ujërave të ndotura adekuate për ujëra të ndotura industriale.
3. Sigurimi i infrastrukturës teknike- grumbullim dhe trajtim të ujërave atmosferike adekuate për hapësirën- parku industrial.

4. Sigurimi i infrastrukturës teknike- rryme elektrike dhe termike adekuate për zhvillim të kategorisë së lëndës së parë, prodhimtari e rëndë, prodhimtari e lehtë, përpunim/paketim/ deponim, shërbime tregtare.
5. Sigurimi i infrastrukturës teknike- grumbullim/ menaxhim dhe trajtim të mbeturinave industriale adekuate për zhvillim të kategorisë së lëndës së parë, prodhimtari e rëndë, prodhimtari e lehtë, përpunim/paketim/ deponim, shërbime tregtare.
6. Sigurimi i infrastrukturës teknike- telekomunikim adekuate për hapësirën- parku industrial.

3.3.1.4. Infrastruktura sociale

1. Sigurimi i sipërfaqes gjelbëruese në kuadër të parkut industrial të mjaftueshme për zhvillim industrial.
2. Sigurimi i shiritave mbrojtës të gjelbër përreth rrugëve në parkun industrial.

3.3.1.5. Rregullimi i Hapësirës

1. Parcelimi i hapësirës industriale, në formë, madhësi, dhe numër që i përshtatet veprimtarisë së zhvillimit ekonomik industrial të lëndës së parë, prodhimtari e rëndë, prodhimtari e lehtë, përpunim/paketim/ deponim, shërbime tregtare.
2. Rregullimi i hapësirës duke marr parasysh hapësirën përreth zonës së veçantë “Parku i Biznesit”, kufirin e saj dhe përshtatjen e rregullimit sipas gjendjes aktuale të terrenit.

3.3.2. Konceptin e Zhvillimit Hapësinor

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për zonën e veçantë “Parku I Biznesit” - Prizren ka marr parasysh dhe ka reflektuar gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara. Në ketë drejtim janë trajtuar informata dhe zhvillime të rëndësishme për Zonën nga profili dhe analiza e gjendjes në Zonë, si dhe janë trajtuar dokumente dhe strategji planifikimi të nivelit komunal dhe qendror.

Ky Koncept i Zhvillimit Hapësinor është provuar të jetë i strukturuar mirë dhe të përmbajë të dhëna të mjaftueshme që të mund të kuptohet si i vetëm. Në ketë drejtim, Ekipi i angazhuar nga Komuna e Prizrenit dhe kompania “INSI” kanë punuar bazuar në kërkesat e parapara me ligj dhe udhëzime administrative, ku edhe është plotësisht e bazuar struktura e këtij koncepti.

Ky Koncept i Zhvillimit Hapësinor pa dyshim që ka krijuar bazën e zhvillimit dhe të shfrytëzimit të tokës gjatë procesit të vendim marrjes dhe do të mundë të shfrytëzohet gjatë hartimit të kushteve ndërtimore, por edhe për kushte zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës përkatëse. Koncepti i zhvillimit hapësinor të zonës është trajtuar përmes tre skenarëve të zhvillimit siç janë skenari I, II dhe III. Gjatë analizimit dhe diskutimit me akterët relevant, skenari i tretë ka arritë të siguroj përkrahjen maksimale, dhe kësisoj është marr vendim i përgjithshëm që ky skenar të përpunohet dhe detajohet për fazat në vazhdim.

4. KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS

Kushtet për rregullimin e hapësirës përfshijnë shfrytëzimet e tokës, kushtet zhvillimore, kushtet ndërtimore, dhe masat mbrojtëse të përcaktuara për secilën parcelë kadastrale. Këto janë kushte dhe masa shtesë që nuk janë të specifikuara tashmë me ndonjë dokument të planifikimit hapësinor të nivelit më të lartë.

Definimi i zonave është zhvilluar në kuadër të një procesi i cili ka qenë transparent dhe gjithëpërfshirës. Zonat dhe kushtet janë vijimësinë e zhvillimit të skenarëve dhe në veçanti skenarit përfundimtar, i cili në vazhdimësi të procesit është përzgjedhur nga Komuna si skenar i duhur. Përveç tjerash, gjatë definimit të zonave dhe kushteve janë bërë edhe analiza legale, sociale, ekonomike, mjedisore dhe financiare, gjithnjë duke u mbështetur në parimet e planifikimit hapësinorë, UA për PRrH dhe vet ligjit për Planifikim Hapësinorë nr. 04/L-174 dhe ligjeve të tjera ndërlidhëse.

Nr.	Nënzonat	Shfrytëzimi / Destinimi	ISHPKZH	ISN	Etazhiteti
1	NZ=B1	Banim i ulët	40%	0.80	P+2+NK
2	NZ=B2	Banim i ulët	40%	0.80	P+2+NK
3	NZ=B3	Banim i ulët	40%	0.80	P+2+NK
4	NZ=D1	Zonë Komerciale	60%	1.00	P+2+NK
5	NZ=A13	Shërbim deponim dhe servise	70%	1.20	P+2+NK
6	NZ=A14	Shërbim, Prodhim Zejtar dhe servise	70%	1.20	P+2+NK
7	NZ=A15	Shërbim, Prodhim Zejtar dhe servise	70%	1.20	P+2+NK
8	NZ=A16	Shërbim, Prodhim Zejtar dhe inkubator	70%	1.20	P+2+NK
9	NZ=A1	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
10	NZ=A2	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
11	NZ=A3	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
12	NZ=A4	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
13	NZ=A5	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
14	NZ=A6	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
15	NZ=A7	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
16	NZ=A8	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
17	NZ=A9	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
18	NZ=A10	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
19	NZ=A11	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
20	NZ=A12	Zonë Industriale	70%	1.20	P+2+NK
21	NZ=C1	Hoteleri	60%	1.00	P+2+NK
22	NZ=C2	Hoteleri	60%	1.00	P+2+NK
24	NZ-E2	Sallë për Konferenca	50%	1.00	P+2

Tabela 6 Kushtet e përgjithshme

4.1. Kushtet Zhvillimore dhe ndërtimore për Zonat Industriale

Gjatë procesit të planifikimit janë shfrytëzimet në kuadër të zonës së veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren. Të cilat janë në harmoni me Hartën Zonale Komunale te Komunës së Prizrenit, shfrytëzimet janë si në vazhdim:

	Shfrytëzimi / Destinimi	ISHPKZH	ISN	Etazhiteti
1	Industri e lëndës së parë	70%	1.2	P+2+Nk
2	Industri e prodhimeve të lehta	70%	1.2	P+2+Nk
3	Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	70%	1.2	P+2+Nk
4	Shërbim tregtar	70%	1.2	P+2+Nk
5	Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	70%	1.2	P+2+Nk

Tabela 7 Kushtet e përgjithshme

4.2. Kushtet e përgjithshme të rregullimit, të përcaktuara si rregullore standarde për zhvillim që vlejnë për të gjitha parcelat kadastrale brenda kufirit të sipërfaqes së planifikuar

4.2.1. Kërkesat minimale për vendparkingje

Bazuar në kushtet nga Harta Zonale Komunale Prizren në UA për Norma Teknike të Planifikimit kërkesat minimale për vendparkingje është dy vendparkingje për çdo 100m^2 ose 2VP/ 100m².

4.2.2. Sigurimi i ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese

Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave te propozuara dhe ekzistuese. Ky kusht ndërtimor është i paraqitur në mënyrë figurative në figurën në vijim:

Shfrytëzimet janë të definuara edhe në Pjesën hartografike.

4.2.3. Qasja adekuate e parcelës kadastrale në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike

Secila ndërtesë duhet të gëzojë qasje në infrastrukture teknike dhe atë publike, duke mos penguar fqinjët, apo infrastrukturën teknike ekzistuese.

Si pjesë e dokumentacionit për aplikim për Kushte dhe Leje ndërtimore duhet të sillet situacioni që përmbanë infrastrukturën teknike ekzistuese.

4.2.4. Specifika projektuese për zhvillim të peizazhit, ndriçimit artificial dhe mobilierisë urbane

Zhvillimi i peizazhit është i ndërlidhur ngushtë me fushat e tjera të cilat me zhvillimin e tyre ndikojnë direkt në peizazh.

Fushat kryesore për zhvillim të peizazhit janë infrastruktura rrugore, menaxhimi dhe ruajtja e gjelbërimit të mjaftueshëm brenda zonës sipas kushteve të dhëna dhe sipërfaqes së dedikuar për gjelbërim ISHPKZH, pjesë kjo shumë e rëndësishme për hapësirat të cilat do të ndërtohen.

Andaj vlen të theksohet që Infrastruktura rrugore duhet të përmbajë breza të gjelbër të cilët ndikojnë edhe si tampon zona mbrojtëse por edhe në pastrimin e ajrit.

Specifikat e rrugëve:

Rrugët Industriale / Shpërndarëse apo furnizuese kryesore të cilat kanë rëndësi të veçantë në zonë shkaku që këto rrugë duhet të përballojnë intensitetin më të lartë të lëvizjeve brenda zonës, duhet të jenë të ndërtuara sipas standardeve ndërtimore për këto rrugë.

Rrugët servisore:

Gjithashtu edhe këto rrugë kanë rëndësinë e vet brenda zonës të cilat duhet të ndërtohen sipas standardeve dhe dimensioneve në profilet e rrugëve, rrugë këto me rëndësi të veçantë.

Ndriçimi artificial: tek të gjitha rrugët të cilat u përmenden më lartë duhet të ndërtohet ndriçimi artificial përmes ndriçuesve elektrik rrugorë sipas specifikave të detajuara tek infrastruktura elektroteknike.

4.2.5. Shfrytëzimet e tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore për parcela kadastrale individuale apo të grupuara dhe lokacioneve specifike, siç janë:

INDUSTRI E LËNDËS SË	**Prodhim i produkteve të Tekstilit**	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e fibrave tekstile, qepjeve, endje e tekstilit, rrezitje dhe veshjeve prej lëkure jo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e fibrave, tekstile, qepjeve, endje e tekstilit, rrezitje dhe veshjeve prej lëkure.
	Prodhim i drurit dhe produkteve me bazë të	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për sharrimin dhe përpunimin e drurit, prodhimin rimeso, kompensate, fibre, zdrukthëtari dhe mobilieri, tape, kashte dhe

	drurit	produktet që përdoren për thurje
	Prodhim i produkteve të Letrës	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e letrës, kartonit, mallrave sanitare me bazë letre
	Prodhim i produkteve jo metalike minerale	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e qelqit, tullës, qeramikës, betonit, çimentos, gëlqeres, suvasë, prerjes dhe formësimit të gurit dhe produkteve të tjera jo- metalike minerale
	Prodhim i produkteve prej gomës dhe plastikës	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e gomave, tubave, mallrave plastike dhe gome për paketim dhe produkte të tjera plastike
	Prodhim i lëndëve tjera të para	Kjo klasë përfshinë prodhimin e produkteve të lëndës së parë që nuk janë përfshirë në kategori të tjera me sipër
INDUSTRI E PRODHIMEVE TË LEHTA	**Prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit**	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e mishit, peshkut, frutave dhe perimeve, vajrave dhe yndyrave apo produkteve që rrjedhin prej tyre, produktet e qumështit, bluarje e grurit dhe produktet koll, parapërgatitje e ushqimeve për bagëti, produkte të tjera ushqimore, pijeve dhe produkteve të duhanit
	Prodhim i rrobave dhe Lëkurës	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e veshjeve, rrobave të lëkurës, aksesorëve, ngjyrosje e leshit dhe manifakturë e produkteve të leshta, valixhe, çanta dhe këpucë
	Botim dhe shtyp	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për botimin dhe shtypjen e librave, gazetave, revistave dhe botimin dhe riprodhimi i regjistrimeve zanore
	Prodhim i pajisjeve elektrike dhe optike	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e pajisjes për zyra, kompjuterë, motorë, gjeneratorë, aparate për shpërndarjen dhe kontrollin e energjisë elektrike, tela dhe kabllo, akumulatorë, bateri e llamba, radio, TV, telefona, valvule elektronike dhe tuba, instrumente mjekësore optike dhe të precizonit, ora dhe pajisje të tjera elektrike dhe optike
	Prodhim i produkteve tjera të lehta	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për prodhimin e mobileve, stolive te çmuara, instrumenteve muzikore, mallrave sportive, lojërave, lodrave dhe produkte tjera te llojllojshme
SHËRBIM TREGTAR	**Shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake**	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve, karburantit, lëndëve të para bujqësore, kafshëve të gjalla, mineraleve, metaleve, kimike, lëndë drusore, pajisjeve për, anije, mobile, mallrat shtëpiake, tekstile, ushqim, pije, produktet e duhanit, produktet farmaceutike, mallrave të dorës së dytë, produkte të tjera, mbetjet dhe skrapet. Kjo klasë përfshin edhe riparimin e automjeteve, personal dhe mallrave shtëpiake
	Shërbim i Patundshmërisë	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e pasurive të patundshme dhe shërbimeve me qira
	Shërbim i akomodimit dhe ushqimit	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e akomodimit ne hotel, fshat turistik, vend kampingu, restorant, bar dhe sallë mbledhjeje
	Shërbim tjera tregtar	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për shërbime tjera komerciale që nuk janë përfshirë në kategoritë tjera të mësipërme
SHËRBIM PROFESSIONAL FINANCIAR DHE I INFORMACIONIT	**Shërbim financiar dhe i Sigurimit**	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve bankare, kreditore, siguruese, dhe shërbime të tjera financiare
	Shërbim teknik profesional dhe shkencor	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve, si konsulentë IT-je, përpunim i të dhënave, kërkim dhe zhvillim, asistencë ligjore, kontabiliteti, menaxhim biznesi, arkitektonike, inxhinierie, reklama, testimi, hetimi, dhe shërbime të tjera profesionale
	Shërbime të informimit dhe komunikime	Kjo klasë përfshin hapësirat e përdorura për ofrimin e botimimeve, regjistrimin e zërit, programe TV, film, radio transmetimet, postën dhe telekomunikacionin, kompjuteret dhe shërbimet e përpunimit të të dhënave
	Shërbim administrativ dhe mbështetës	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve, si agjenci udhëtimi, shërbime mbështetëse administrative dhe qiraje, pastrimi, sigurimi dhe të tjera
	Shërbim tjetër profesional financiar dhe i informacionit	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve të tjera financiare, profesionale dhe informacionit që nuk janë përfshirë në ndonjë tjetër kategori nga vlerat e përshkruara më sipër

Tabela 8 Shfrytëzimet e lejuara brenda zonës së veçant "Parku i Biznesit"- Prizren

4.3. Kushtet Zhvillimore dhe ndërtimore për zonat e banimit individual

Gjatë procesit të planifikimit janë shfrytëzimet në kuadër të zonës së banimit. Të cilat janë në harmoni me Hartën Zonale Komunale te Komunës së Prizrenit, shfrytëzimet janë si në vazhdim:

	Shfrytëzimi / Destinimi	ISHPKZH	ISN	Etazhiteti
1	Banim i përhershëm	40%	0.80	P+2+NK
2	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri	40%	0.80	P+2+NK
3	Shfrytëzim i përzier	40%	0.80	P+2+NK

Tabela 9 Kushtet e përgjithshme

4.3.1. Shfrytëzimet e tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore për parcela kadastrale individuale apo të grupuara dhe lokacioneve specifike, siç janë:

Banim individual	**Banim i përhershëm**	Kjo klasë përfshinë hapësira banimi të dominuara nga shtëpitë e veçanta të rrethuara me kopshte dhe/ose oborre, apo në kombinim të shtëpive të veçanta, shtëpive dyshe, shtëpive në varg, ndërtesave terracore dhe ndërtesat e banimit me shumë njësi si vendbanim i përhershëm.
	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri	Kjo klasë përfshinë hapësira të caktuara për banim të kombinuar me funksione të tjera në pajtueshmëri (p.sh. shërbime të ndryshme, industri të lehta etj.).
	Shfrytëzim i përzier	Kjo klasë përfshinë hapësira të caktuara për banim të përkohshëm sh. kampe për migrantë, kampingje për pushim - rekreacion, etj.

4.4. Kushtet e përgjithshme të rregullimit, të përcaktuara si rregullore standarde për zhvillim që vlejnë për të gjitha parcelat kadastrale brenda kufirit të sipërfaqes së planifikuar për banim

4.4.1. Kërkesat minimale për vendparkingje

Bazuar në kushtet nga Harta Zonale Komunale Prizren në UA për Norma Teknike të Planifikimit kërkesat minimale për vendparkingje ku është dy vendparkingje për çdo 100 ^{m2} (2VP/100 m²),

4.4.2. Sigurimi i ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese

Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave te propozuara dhe ekzistuese. Ky kusht ndërtimor është i paraqitur në mënyrë figurative në figurën në vijim:

Shfrytëzimet janë të definuara edhe në Pjesën hartografike.

4.4.3. Qasja adekuate e parcelës kadastrale në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike

Secila ndërtesë duhet të gëzojë qasje në infrastrukture teknike dhe atë publike, duke mos penguar fqinjët, apo infrastrukturën teknike ekzistuese.

Si pjesë e dokumentacionit për aplikim për Kushte dhe Leje ndërtimore duhet të sillet situacioni që përmbanë infrastrukturën teknike ekzistuese.

4.4.4. Specifika projektuese për zhvillim të peizazhit, ndriçimit artificial dhe mobilierisë urbane

Zhvillimi i peizazhit është i ndërlidhur ngushtë me fushat e tjera të cilat me zhvillimin e tyre ndikojnë direkt në peizazh.

Fushat kryesore për zhvillim të peizazhit janë infrastruktura rrugore, menaxhimi dhe ruajtja e gjelbërimit të mjaftueshëm brenda zonës sipas kushteve të dhëna dhe sipërfaqes së dedikuar për gjelbërim ISHPKZH, pjesë kjo shumë e rëndësishme për hapësirat të cilat do të ndërtohen.

Andaj vlen të theksohet që Infrastruktura rrugore duhet të përmbajë breza të gjelbër të cilët ndikojnë edhe si tampon zona mbrojtëse por edhe në pastrimin e ajrit.

Specifikat e rrugëve:

Rrugët Industriale / Shpërndarëse apo furnizuese kryesore të cilat kanë rëndësi të veçantë në zonë shkaku që këto rrugë duhet të përballojnë intensitetin më të lartë të lëvizjeve brenda zonës, duhet të jenë të ndërtuara sipas standardeve ndërtimore për këto rrugë.

Rrugët servisore:

Gjithashtu edhe këto rrugë kanë rëndësinë e vet brenda zonës të cilat duhet të ndërtohen sipas standardeve dhe dimensioneve në profilet e rrugëve, rrugë këto me rëndësi të veçantë.

Ndriçimi artificial: tek të gjitha rrugët të cilat u përmenden më lartë duhet të ndërtohet ndriçimi artificial përmes ndriçuesve elektrik rrugorë sipas specifikave të detajuara tek infrastruktura elektroteknike.

4.5. Kushtet Zhvillimore dhe ndërtimore për zonat komerciale

Gjatë procesit të planifikimit janë shfrytëzimet në kuadër të zonës komerciale. Të cilat janë në harmoni me Hartën Zonale Komunale te Komunës së Prizrenit, shfrytëzimet janë si në vazhdim:

	Shfrytëzimi / Destinimi	ISHPKZH	ISN	Etazhiteti
1	Shërbim tregtar	60%	1.00	P+2+NK
2	Industri e prodhimeve të lehta	60%	1.00	P+2+NK
3	Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	60%	1.00	P+2+NK
4	Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	60%	1.00	P+2+NK

Tabela 10 Kushtet e përgjithshme

4.5.1. Shfrytëzimet e tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore për parcela kadastrale individuale apo të grupuara dhe lokacioneve specifike, siç janë:

Zonë Komerciale	**Shërbim tregtar**	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve, karburantit, lëndëve të para bujqësore, kafshëve të gjalla, mineraleve, metaleve, kimike, lëndë drusore, pajisjeve për mobile, mallrat shtëpiake, tekstile, ushqim, pije, produktet e duhanit, produktet farmaceutike, mallrave të dorës së dytë, produkte të tjera, mbetjet dhe skrapet. Kjo klasë përfshin edhe riparimin e automjeteve, personal dhe mallrave shtëpiake.
	Industri e prodhimeve të lehta	Kjo klasë përfshinë hapësira të caktuara për banim të kombinuar me funksione të tjera në pajtueshmëri (p.sh. shërbime të ndryshme, industri të lehta etj.).
	Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve të tjera financiare, profesionale dhe informacionit që nuk janë përfshirë në ndonjë tjetër kategori nga vlerat e përshkruara më sipër
	Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për shërbime komerciale që kanë të bëjne me qendra logjistike dhe depo për magazinim.

4.6. Kushtet e përgjithshme të rregullimit, të përcaktuara si rregullore standarde për zhvillim që vlejnë për të gjitha parcelat kadastrale brenda kufirit të sipërfaqes së planifikuar zona komerciale

4.6.1. Kërkesat minimale për vendparkingje

Bazuar në kushtet nga Harta Zonale Komunale Prizren në UA për Norma Teknike të Planifikimit kërkesat minimale për vendparkingje ku është dy vendparkingje për çdo 100 m² (Ndërtesa tregtare 4 VP/ 100 m² të hapësirës shitëse, Ndërtesa hapësirat e tregjeve 3 VP/ 100 m² të hapësirës shitëse, Depo magazina 1 VP/ 100 m²),

4.6.2. Sigurimi i ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese

Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave te propozuara dhe ekzistuese. Ky kusht ndërtimor është i paraqitur në mënyrë figurative në figurën në vijim:

Shfrytëzimet janë të definuara edhe në Pjesën hartografike.

4.6.3. Qasja adekuate e parcelës kadastrale në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike

Secila ndërtesë duhet të gëzojë qasje në infrastrukture teknike dhe atë publike, duke mos penguar fqinjët, apo infrastrukturën teknike ekzistuese.

Si pjesë e dokumentacionit për aplikim për Kushte dhe Leje ndërtimore duhet të sillet situacioni që përmbanë infrastrukturën teknike ekzistuese.

4.6.4. Specifika projektuese për zhvillim të peizazhit, ndriçimit artificial dhe mobilierisë urbane

Zhvillimi i peizazhit është i ndërlidhur ngushtë me fushat e tjera të cilat me zhvillimin e tyre ndikojnë direkt në peizazh.

Fushat kryesore për zhvillim të peizazhit janë infrastruktura rrugore, menaxhimi dhe ruajtja e gjelbërimit të mjaftueshëm brenda zonës sipas kushteve të dhëna dhe sipërfaqes së dedikuar për gjelbërim ISHPKZH, pjesë kjo shumë e rëndësishme për hapësirat të cilat do të ndërtohen.

Andaj vlen të theksohet që Infrastruktura rrugore duhet të përmbajë breza të gjelbër të cilët ndikojnë edhe si tampon zona mbrojtëse por edhe në pastrimin e ajrit.

Specifikat e rrugëve:

Rrugët Industriale / Shpërndarëse apo furnizuese kryesore të cilat kanë rëndësi të veçantë në zonë shkaku që këto rrugë duhet të përballojnë intensitetin më të lartë të lëvizjeve brenda zonës, duhet të jenë të ndërtuara sipas standardeve ndërtimore për këto rrugë.

Rrugët servisore:

Gjithashtu edhe këto rrugë kanë rëndësinë e vet brenda zonës të cilat duhet të ndërtohen sipas standardeve dhe dimensioneve në profilet e rrugëve, rrugë këto me rëndësi të veçantë.

Ndriçimi artificial: tek të gjitha rrugët të cilat u përmenden më lartë duhet të ndërtohet ndriçimi artificial përmes ndriçuesve elektrik rrugorë sipas specifikave të detajuara tek infrastruktura elektroteknike.

4.7. Kushtet Zhvillimore dhe ndërtimore për zonat rekreative-turistike

Gjatë procesit të planifikimit janë shfrytëzimet në kuadër të zonës rekreative-turistike. Të cilat janë në harmoni me Hartën Zonale Komunale te Komunës së Prizrenit, shfrytëzimet janë si në vazhdim:

	Shfrytëzimi / Destinimi
1	Shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreative
2	Hapësira dhe palestra sportive
3	Shërbim i akomodimit dhe ushqimit
4	Shërbim tjetër

Tabela 11 Kushtet e përgjithshme

4.7.1. Shfrytëzimet e tokës dhe kushtet rregulluese hapësinore për parcela kadastrale individuale apo të grupuara dhe lokacioneve specifike, siç janë:

Zonë Rekreative-turistike	Shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreative	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve, si parqet e dëfrimit, parqet tematike, pikat e basteve dhe bixhozit, aktivitete dhe shërbime të tjera argëtuese.
	Infrastrukturë sportive	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e shërbimeve, si infrastrukturën sportive, si stadiume, salla sportive, pishina, palestra, impiante të skive, fusha golfi dhe infrastruktura të tjera sportive.
	Shërbim i akomodimit dhe ushqimit	Kjo klasë përfshinë hapësira të shfrytëzuara për ofrimin e akomodimit ne hotel, fshat turistik, vend kampingu, restorant, bar dhe sallë mbledhjeje.
	Shërbim tjetër rekreative	Kjo klasë përfshinë hapësira tjera për rekreacion që nuk janë përfshirë në kategoritë tjera të mësipërme

4.8. Kushtet Ndërtimore:

4.8.1. Rregullat e rregullimit të tokës, duke përfshirë parcelimin dhe ri parcelimin e parcelave kadastrale;

Plani Rregullues i Hollësishëm i Zonës së veçantë "Parku i Biznesit" në përmbajtjen e tij e ka planin e parcelimit, ku parcelat janë të ndara sipas llojit të shfrytëzimeve të parapara, të cilat janë të bazuara në UA për Norma Teknike të Planifikimit.

Rregullimi i tokës bëhet i domosdoshëm me qëllim grupimit të parcelave për shfrytëzim më racional dhe ekonomik, krijimit të parcelave me formë të rregullt gjeometrike, përmirësimin e infrastrukturës duke përfshirë qasjen në infrastrukturën publike, zgjerimin e rrugëve, krijimin e hapësirave të parkimit dhe përmbajtjeve tjera.

Në zbatimin e këtij plani të parcelimit lejohet rregullimi i dy apo më shumë parcelave me karakter të njëjtë destinimi, në raste kur kemi kërkesa për hapësirë më të madhe të ndonjë zhvillimi brenda zonës.

Plani i riparcelimit mund të jetë subjekt i ndryshimit nga ai që është paraparë në pjesën grafike të Planit Rregullues të Hollësishëm, por duke mos e cenuar kushtet tjera zhvillmore brenda blloqeve siç janë: vija rregulluese, vija ndërtimore, etazhiteti, lartësia maksimale e kateve, Lartësia ose gjerësia nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike, Distanca minimale anësore nga parcela – me hapje primare, Distanca minimale anësore nga parcela – me hapje sekondare, ISHPKZh, % e gjelbërimit, SNP, ISN, Madhësia minimale e parcelës kadastrale, hapja e rrugëve të reja nëpër blloqe sipas kategorive të ndryshme dhe kushte tjera.

4.8.2. Kushtet për rregullimin e hapësirës përmbajnë masa mbrojtëse për sipërfaqen e planifikuar, siç janë:

4.8.2.1. Standardet e projektimit apo standardet teknike

Hollësitë e fazave të zhvillimit të planifikuar

- Plani Rregullues i Hollësishëm i zonës së veçantë "Parku i Biznesit" si dokument planifikimi është zhvilluar hollësisht sipas fazave të parapara në udhëzim administrativ për Planin Rregullues të Hollësishëm, duke filluar nga Profili i cili është digjital dhe një Gjeodatabazë në Arc GIS e krijuar nga burimet e ndryshme institucionale dhe incizimet në teren.

Analiza e gjendjes prapë është bërë bazuar në konceptet e krijuara, projektit ndërkombëtarë dhe punës së disa akterëve, përzgjedhja e Skenarit nga tre skenarë, dhe ky skenarë është detajuar në të gjitha përmbajtjet.

- Bazuar në këto që u tha më lartë janë propozuar edhe kushtet ndërtimore për të gjitha shfrytëzimet duke u përpjekur për të ruajtur konceptin e Zonës Ekonomike.
- Si hollësitë tjera të fazave të zhvillimit të planifikuar është edhe zhvillimi i planit të zbatimit, si dhe tregueseve për monitorim të zbatimit
- Si hollësi të zhvillimeve të planifikuara sipas fazave te infrastruktura rrugore në Zonën e veçantë "Parku i Biznesit", brenda fazës së parë është identifikimi, konsultimi dhe aprovimi i profilit dhe traseve, kushteve dhe masave, më pastaj në fazat tjera të zhvillimit të planifikuar shikohet, si me trotuar dhe shirita për parkim, bëhen punë tereni si incizime etj, hartohet projekti ideor, kryesor hapen procedura të prokurimit, zgjidhet operatori dhe fillon realizimi i zhvillimeve të planifikuara .

4.8.2.2. Mbrojtja e vlerave natyrore, historike dhe kulturore

Sfiduese në Zonën e veçantë "Parku i Biznesit" është se si duhet të mbrohet parku nga degradimet antropogjenë dhe natyrore, ndotja e ekosistemeve, me fjalë të tjera mundësia e shfrytëzimit të pasurive të parkut për zhvillimin e sotëm, duke mbajtur përgjegjësi për ardhmërinë e parkut edhe për gjeneratat e ardhshme.
Ligji për Planifikim Hapësinor përmban parimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe tani është koha që të gjitha parimet që përmban ky ligj, pastaj standardet, konventat dhe agjendat e ndryshme të përkthehen në veprime konkrete dhe të reflektohen në menaxhim.
Zbatimi i ligjeve në fuqi dhe i konventave ndërkombëtare do të kontribuojë në zvogëlimin e problemeve mjedisore në këtë Zonë. Ligjet relevante me sfidën në fjalë e të cilat duhet të zbatohen janë:

- Ligji për mbrojtjen e mjedisit;
- Ligji për mbrojtjen e natyrës;
- Ligji për pyje;
- Ligji për mbrojtjen e tokave bujqësore:
- Ligji për mbrojtjen e ujërave;
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Ligji për mbeturina;
- Ligji për kimikate;
- Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes;
- Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor;
- Ligji për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare;
- Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësive tjera;
- Ligji për mbrojtje nga zjarri;
- Ligji për trashëgiminë kulturore;

4.8.2.3. Mbrojtja nga ndotja e mjedisit

Çështja e mjedisit është një ndër çështjet kryesore për shoqërinë tonë. Është shumë i rëndësishëm angazhimi në zbulimin e mistereve të jetës, tokës, ujit dhe ajrit që na rrethon. Po ashtu duhet të bëhen gjithnjë e më të qarta pasojat e ndikimit të njerëzimit në mjedis, kur dihet se shumë aktivitete individuale apo kolektive që po ndodhin në hapësirën tonë jetësore, janë të pakontrolluara dhe nuk janë në harmoni me normat dhe standardet evropiane të mjedisit. Kjo dukuri, përveç tjerash, në vendin tonë paraqitet edhe si pasojë e mungesës së planeve hapësinore dhe të menaxhimit për zonat e caktuara, të nivelit qendror dhe të atij lokal.

Zona e veçantë "Parku i Biznesit" ka një pozitë të përshtatshme gjeografike me potenciale për zhvillimin e veprimtarive të caktuara për këtë zonë ekonomike.

Sfidë e jona është se si mund ta shfrytëzojmë këtë pozitë dhe potencial natyror e kulturor në favor të bashkëpunimit dhe zhvillimit duke mos ndotur ambientin që na rrethon.

4.8.2.4. Mbrojtja nga zhurma dhe Masat mbrojtëse ndaj zjarrit, vërshimeve, e tërmeteve dhe fatkeqësive të tjera natyrore;

Çdo shtetas ka të drejtë të mbrohet dhe të përfitojë mbrojtje nga organet shtetërore nga efektet e dëmshme të zhurmës mjedisore. Mbrojtja zbatohet për zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen, në zona të banuara, në mjediset e institucioneve publike, në parqe publike dhe hapësira të tjera, të qeta, çlodhëse, në zona të qeta në natyrë, në institucionet për fëmijë, institucione shëndetësore, arsimore, kulturore, fetare dhe në mjedise të tjera të ngjashme me to.

Me masa të mbrojtjes nga zhurma do të kuptojmë ndërhyrjet dhe veprimet që ndërmerren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin ku ai ka ndikim negativ, duke e sjellë atë në një nivel të lejueshëm.

Masat kryesore të mbrojtjes nga zhurma janë:

- Përzgjedhja e makinerive apo pajisjeve që nuk bëjnë shumë zhurmë;
- Përzgjedhja e vendit ku do të vendosen dhe do të punojnë pajisjet që lëshojnë zhurmë që të garantojë një nivel të lejueshëm zhurme në mjediset rreth tyre.

Çdo ndërtim dhe rikonstruksion ndërtesash, për veprimtari të ndryshme ekonomike e shoqërore, projektohet dhe realizohet në mënyrë që zhurma në brendësi apo në afërsi të saj, të jetë Brenda nivelit të lejueshëm. Rëndësi e veçantë duhet të ju kushtohet materialeve të cilat përdoren në ndërtesa.

Dritaret duhet të kenë aftësi maksimale në aspektin e izolimit akustik, e njëjta vlen edhe tek hapjet e tjera në ndërtesa.
Tek ndërtesat të cilat janë burim i zhurmës me kapacitete më të mëdha si p.sh objektet industriale, duhet ti kushtohet rëndësi mënjanimit të zhurmës si ndotës.

Fatkeqësitë - të cilat paraqesin një ngjarje apo pjesë të ngjarjes të shkaktuar nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave, shkaktojnë dëme në trashëgiminë kulturore dhe mjedis, në përmasat e atilla që kërkojnë ndërmarrjen e masave dhe dislokimin e forcave dhe resurseve të veçanta.
Fatkeqësitë mund të jenë:

- Fatkeqësi natyrore – të cilat janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortek, erë e fuqishme, breshër, bore me shi, acar, thatësi, zjarr fushor, shpërthim i sëmundjeve infektive që ndikojnë në njerëz, kafshë ose bimë dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore;
- Fatkeqësi tjera – të cilat janë: aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidentet nukleare dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, lufta dhe gjendja emergjente, përdorimi I armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste me mjete klasike dhe forma tjera të dhunës në masë; si dhe

- Kriza - që paraqet gjendjen e sigurisë në hapësirën regjionale e më gjerë e cila nuk mund të kontrollohet me resurse dhe masa të zakonshme në të cilën janë të kërcënuara vlerat themelore të Republikës së Kosovës për shkaqe ekonomike, sociale, ushtarake dhe shkaqe tjera të cilat mund të kalojnë përtej kufijve dhe paraqesin kërcënim të pashmangshëm tek vendet tjera përkatëse.

Aksidenti ekologjik - një aksident mjedisor, sipas përcaktimit në dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit, të shkaktuar nga një ngjarje e papritur apo e pakontrolluar për shkak të ndërhyrjes në mjedis, e cila për pasojë mund të kërcënojë jetën dhe shëndetin e njerëzve apo cilësinë e mjedisit;

Aksidenti industrial - një ngjarje e cila ka dalë jashtë kontrollit gjatë kryerjes së aktiviteteve apo veprimit me makineri dhe materie të rrezikshme ose të dëmshme, ku një ngjarje e tillë rezulton në kërcënimin e jetës apo shëndetin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit;

Rreziku nga Materiet e rrezikshme - që paraqesin çdo materie në gjendje të ngurtë, të gaztë apo të lëngët, e cila me rrjedhje të pakontrolluar në mjedis paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën apo shëndetin e njerëzve dhe kafshëve apo shkakton çrregullim apo dëmtim të pronave dhe ndikon dëmshëm në mjedis;

Në mesin e sfidave (derisa sfida duhet kuptuar si një gjendje, zhvillim ose aktivitet i caktuar që ju vë në provë) hyn edhe dëmet tjera që janë rezultat i veprimeve të njeriut, që nga cenimi, dëmtimi deri te shkatërrimi i resurseve natyrore(rrethina natyrore, ajri, toka, uji, flora, fauna dhe pasuritë tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore), cenimi, dëmtimi deri te shkatërrimi i resurseve kulturore- historike(zonat arkitektonike, arkeologjike, historike), ndotja(Llojet e ndotjes): Ndotja e tokës, Ndotja e ajrit, Ndotja e ujit,

Ngrohja globale nga ndotësit fizikë, biologjikë, nga agjentët kimikë, cenimi, dëmtimi deri te shkatërrimi I zonave të mbrojtura dhe zonave të veçanta të mbrojtura etj. dhe në të gjitha këto sfida duhet adresuar masa mbrojtëse si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme për sigurimin e një mbrojtje, shfrytëzim dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Masat mbrojtëse qoftë ndaj rreziqeve, qoftë potencialeve që duhet mbrojtur, apo edhe potencialeve që duhet ruajtur ashtu që më vonë të zhvillohen, janë pjesë e detyrueshme që rrjedhin nga Kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore, konventat ndërkombëtare dhe një gamë e gjerë e obligimeve dhe përgjegjësive që ushtrohen qoftë në nivelin qeveritarë qoftë në atë lokal dhe e një numri institucioneve, për t'u kujdesur për një cilësi të jetës, për florë dhe faunë të pasur dhe për qëndrueshmëri sociale, ekonomike dhe mjedisore, e të cilat për emërues të përbashkët kanë gjitha zonat - në këtë rast territorin e komunës.

5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT

5.1. Kategorizimi i rrugëve sipas nivelit të shërbimit dhe kufizimit të shpejtësisë:

Të gjitha rrugët në zonë janë Industriale dhe Servisore të cilat funksion primar kanë lidhjen e zonës me rrugët kryesore furnizuese të zonës.

Profilet e rrugëve në zonë janë nga 10.00m deri në 18m.

Të gjitha rrugët në përmbajtjen e tyre kanë pjesën e qarkullimit motorik dhe jo motorik-trotuaret.

Projektimi i rrugëve bërë sipas standardeve të projektimit të rrugëve dhe të gjitha objektet dhe elementet e rrugës, si: galeritë, muret mbrojtëse, shiritat për këmbësorë, objektet e largimit të ujërave atmosferike, parkingjet dhe vendndalimet e përkohshme për automjete, ndriçimi dhe sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugës duhet të aprovohen nga autoriteti kompetent.

Gjatë projektimit, projektuesi duhet të ketë konsideratë për kryqëzimet me largpërçuesit, rrjetin e telefonisë, rrjetin e ujësjellësit si dhe instalimet tjera që janë trupin e rrugës, brezin e rrugës dhe brezin mbrojtës të Rrugës dhe kyçjet e objekteve rreth rrugës. Për të gjitha instalimet nëntokësore dhe mbitokësore, projektuesi duhet të ofroj zgjidhje teknike për dislokimin eventual si dhe paramasat me parallogaritë.

Gjatë sinjalizimit të rrugëve, duhet të përcaktohet edhe tipi i automjeteve të cilat kanë të drejtë të lëvizin nëpër rrugët e planifikuara, si dhe të përcaktohet me shenjëzimi pesha e automjeteve të lejuara për qarkullim në rrugë.

5.1.1. Materialet e konstruksionit të poshtëm dhe të epërm të rrugës

Konstruksioni i poshtëm i rrugës duhet të dimensionohet dhe ndërtohet prej materialeve të forta gurore, rezistuese ndaj thyerjes dhe ngricave sipas standardeve EN, i cili duhet të kalojë thellësinë e ndikimit të ngricave dhe ngarkesave të automjeteve me konstruksion të rrugës me trashësi prej 1,0m.

Ngjeshja e materialeve jo të lidhura të kryhet në shtresa çdo 20cm dhe të arrihet ngjeshja e duhur sipas standardeve.

Konstruksioni i epërm i rrugës duhet dimensionohet dhe ndërtohet prej asfaltit me kualitet të lartë me përbërje te agregatit të rezistueshëm ndaj thyerjes dhe gërryerjes si dhe të bitumenit rezistues ndaj klimës si dhe në harmoni me standardet dhe rregulloret tjera teknike EN.

Kualiteti i të gjitha materialeve të cilat përdoren për ndërtim, si dhe dimensionet e shtresave të konstruksionit të rrugës, duhet të jenë në përputhje me standardet dhe normat bashkëkohore për ndërtimin e rrugëve. Projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD, EN), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

5.1.2. Profilet e rrugëve




Figura 8 Profilet e rrugëve– PRrH zona e Veçantë “Parku i Biznesit” – Prizren

5.1.3. Trotuaret, shiritat për këmbësor dhe për biçikleta

Trotuaret dhe shiritat për këmbësorë variojnë varësisht prej rolit të shtigjeve brenda zonës por edhe të prurjeve nga pjesët e caktuara të qytetit në raport me qasjen në brendi të zonës.

Trotuari për këmbësorë duhet të jetë me gjerësi minimale 1.20 m, ndërsa në pjesët e rrugës me frekuentim më të madh të këmbësorëve (në të cilat janë të mundura lëvizjet grupore) preferohet gjerësia e shtegut për këmbësorë nga 2.5 – 3.0 m.

Sipas standardeve të projektimit dhe normave të planifikimit (Udhëzimit administrativ të MMPH) për përmirësimin e sipërfaqeve për lëvizje të biçikletave në rrugët ekzistuese dhe për rrugët e reja të planifikuara, duhet që :

Shtigjet për biçikleta jashtë vendbanimeve duhet të planifikohen si të ndara, me një brez të gjelbër të gjerësisë adekuate dhe pa pengese mbrojtëse, nga profili i tërthor i rrugës. Përjashtimisht, për shkak të mungesës së hapësirës për planifikim të një brezi të gjelbër, shtegu për biçikleta duhet të sigurohet me një pengese mbrojtëse nga çeliku.

Gjerësia optimale/minimale dhe lartësia e shtegut për biçikleta jashtë vendbanimit: shteg njëdrejtimësh, në të dyja anët e rrugës:

- me gjerësi: 1.50 / 1.00 m,
- me lartësi: 2.50 m.

5.1.4. Objektet për largimin e ujit nga rruga;

Duke marrë për baze projektet e rrugëve në këtë plan, objektet për largimin e ujit nga rruga duhet të projektohen konform standardeve të ndërtimit dhe ligjeve të aplikueshme. Këto detaje do të përcaktohen në planet kryesore të rrugëve dhe të cilat do të duhet të aprovohen pranë drejtorisë përkatëse.

5.1.5. Brezat rrugor nga të dy anët e rrugës;

Duke marrë për bazë projektet e rrugëve në këtë plan, brezat rrugor duhet të projektohen konform standardeve të ndërtimit dhe ligjeve të aplikueshme. Këto detaje do të përcaktohen në planet kryesore të rrugëve dhe të cilët do të duhet të aprovohen pranë drejtorisë përkatëse.

Brezat rrugor në të dy anët e rrugës duhet të jenë në purputhje me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor (Udhëzimit administrativ të MMPH).

5.1.6. Sinjalizimi vertikal, horizontal, si dhe semaforët;

Në bazë të shënimeve nga projekti ndërtimor (situacioni- planimetria), projektuesi duhet të hartoj projektin e sinjalizimit dhe pajisjeve të rrugës, në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi mbi projektimin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal (Udhëzim administriv (MI) Nr. XX/2017 për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugor).

5.1.7. Pajisjet e rrugëve (pajisjet mbrojtëse mjedisore dhe të zhurmës, ndriçimi publik, etj.).

Niveli i ndriçimit të rrugëve duhet të jetë në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit, Ligjin për rrugët dhe aktet nënligjore për ndriçimin e rrugëve. Projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EN - The European Norm for Road Lighting), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim, duke mundësuar:

- Dukshmëri të mirë dhe ngasje të sigurt në kushtet e natës,
- Vërejtjen me kohë të rrezikut potencial, orientim të mirë dhe siguri të përgjithshme për këmbësorë,
- Të gjithë pjesëmarrësve në trafik, vërejtje të sipërfaqeve të nevojshme dhe detale të rëndësishme të mjedisit gjatë lëvizjes.

5.2. Detajet e komunikacionit, siç janë:

5.2.1. Qarkullimi i trafikut;

Parametrat teknik të rrugëve në përgjithësi duhet t`i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor të ofrojnë kushte të mira për qarkullim të mjeteve motorike. Në zonën e Veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren, viteve te fundit janë realizuar punime të rehabilitimit dhe rikonstruimit me qëllim të përmirësimit të kushteve të qarkullimit dhe ofrimit të qasjes më të lehtë për pjesëmarrësit ne trafik. Këto rruge kryesisht janë me nga dy korsi.

6. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

6.1. Ujësjellës

6.1.1. Koncepti i furnizimit me ujë dhe sasitë e nevojshme

Pasi që parku është paraparë si zonë e veçantë "Parku i Biznesit" dhe për banim e rekreacion projektuesi ka paraparë që në këtë Park të Biznesit të ketë dy rrjete të ndara të furnizimit me ujë. Njëra rrjet është paraparë për furnizim me ujë të pijes të banorëve dhe të punonjëse dhe tjera rrjet për furnizimit e objekteve industriale me ujë teknologjik.

Dimensionimi i rrjetit për furnizim me ujë të pijes është bërë në bazë të numrit të banorëve, gjegjësisht sipërfaqes së destinuar për banim, rekreim dhe të numrit të banorëve të caktuar në bazë të sipërfaqeve të parapara për këtë qëllim. Kurse dimensionimi i rrjetit të ujit teknologjik është bërë në bazë të njësive industriale. Pasi që nuk ka qenë lloji i industrisë që do të ndërtohet në këtë Park caktimin i sasisë së nevojshme të ujit teknologjik është duke përvetësuar një harxhim mesatar për industrisë.

Duke u bazuar në destinimin e sipërfaqeve sipas planit të propozuar dhe numrit të banorëve është llogaritur edhe sasia e nevojshme e ujit për tërësitë urbane.

Norma e harxhimit të nevojshme për ujë të pijes është marrë:

- Për amvisëri dhe hotelieri qb=180l/b/d
- Për jo amvisëri qi= 250l/i/sh

Në bazë të këtyre të dhënave dhe destinimit të blloqeve është caktuar sasie\a e nevojshme për blloqet në veçanti dhe për tërë Parkun në përgjithësi. Kështu sasia e tërësishme për Park të Biznesit është:

- Për ujë të pijes Q = 15l/s
- Për ujë industrial Q = 35l/s
- Për shuarjen e zjarrit sipas normave Q =10l/s

Pra sasia e nevojshëm për furnizim me ujë të parkut është 60l/s.

6.1.2. Rrjeti i furnizimit me ujë të pijes

Nga kjo rrjet përpos ujit për pije do të jetë edhe uji që shërben për shuarjen e zjarrit. Pra, sasia e tërësishme e ujit do të jetë q=25l/s

Furnizimi i kësaj rrjete do të bëhet nga rruga kryesore Prizren-Prishtinë në dy pika. Gypat furnizues nga këto pika do të jetë Ø140.

Sistemi furnizimit do të jetë sistem unazor. Me unazë kryesore që do të përshkon perimetrin e Parkun dhe unazat sekondare që do të jenë në brendësi të Parku. Gypat e unazës primare do të jenë me dimensione Ø125mm, kurse unaza sekondare Ø110. Unazat sekondare do të jetë të lidhura me veti me gypa me diametër Ø90mm.

Rrjetet do të përcjellin rrugët kryesore dhe do të vendosen në anën e majtë të rrugës në trotuar. Në të njëjtin kanal do të vendoset që të dy rrjetet e ujësjellësit.

Mesatarisht në çdo 60m-8m do të vendosen hidrantët mbitokësor për shuarjen e zjarrit, kurse pusetat e nyjeve do të vendosen në trotuaret ashtu që mos të pengoj qarkullimin.

6.1.3. Rrjeti i furnizimit me ujë teknologjik

Siç u cek më lartë sasia e nevojshme për furnizim me ujë teknologjik do te jetë: Q = 35l/s

Furnizimi i kësaj rrjete do të bëhet nga rruga kryesore Prizren-Prishtinë në dy pika. Gypat furnizues nga këto pika do të jetë Ø180.

Sistemi furnizimit do të jetë sistem unazor. Me unazë kryesore që do të përshkon perimetrin e Parkun dhe unazat sekondare që do të jenë në brendësi të Parku. Gypat e unazës primare do të jenë me dimensione Ø140mm, kurse unaza sekondare Ø125. Unazat sekondare do të jetë të lidhura me veti me gypa me diametër Ø110mm.

Mesatarisht në çdo 60m-8m do të vendosen hidrantët mbitokësor për shuarjen e zjarrit, kurse pusetat e nyjeve do të vendosen në trotuaret ashtu që mos të pengoj qarkullimin.

Rrjetit do të përcjellin rrugët kryesore dhe do të vendosen në anën e majtë të rrugës në trotuar. Në të njëjtin kanal do të vendoset që të dy rrjetet e ujësjellësit.

Në çdo parcelë të njësisë industriale duhen të parashihen nga dy puseta. Një për furnizim me ujë të pijes dhe një për furnizim me ujë industrial.

6.2. Kanalizim

6.2.1. Sistemi i kanalizimit fekal

Pasi që në afërsi të lokacioni nuk ka rrjet të kanalizimit fekal është paraparë ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza (fekale). Ky impiant është paraparë të jetë në hyrje të lokacionit të parkut, gjegjësisht në vendin e parapri për gjelbërim. Prandaj, kahjen e rrjetit e ka përcaktuar vendi i Impiantit për pastrimin ujërave të zeza dhe konfiguracioni i terrenit.

Që diametrat e gypave të jen më të vegjël janë caktuar që të jenë katër kolektor kryesor që do të ndajnë sipërfaqen e Parkut, gjegjësisht shfrytëzuesit në katër pjesë të barabarta.

Dimensionimi i gypave është bërë në bazë të numrit të shfrytëzueseve.

Kështu diametrat e gypave janë Ø200mm, Ø250 dhe në fund është kolektori kryesor që bënë barten e ujërave të zeza deri në impiant është me diametër Ø315mm.

Kolektorët do të vendosen në mesi e rrugës.

Mesatarisht në çdo 30m duhen të vendoset puseta kontrolluese të kanalizimit.

Pusetat duhet të ndërtohen nga rrathët e betoni Ø1000/1000mm që përfundojnë më konus. Kapakët e pusetave duhen të jenë nga metali me peshë 166kg.

Rënia e niveletës mundësisht duhet të përcjellë rënien e terrenit.

Gypat do të jenë nga PESN/8, pasi që është material më i lirë dhe ka përdorim të gjerë në vendin tonë.

Puseta e dy rrjeteve duhen të vendosen zigzag ashtu që mos të pengohen punëtorët gjatë mirëmbajtjes së rrjeteve.

Vërejtje:

Pasi që në Park të Biznesit do të ketë ujëra të ndotura që dalin nga përpunime të ndryshme industriale secila njësi duhet të ketë impiantin e vet për përpunim të ujerave që dalin nga objektet. Secili impiant duhet të jetë me karakteristika që do t'i përshtaten ujërave që dalin nga objekti. Pra, në rrjetin e kanalizimit fekale nuk guxon të shkarkohen ujërat industriale të papërpunuara.

6.3. Sistemet e drenazhimit të ujërave atmosferik

6.3.1. Analiza e ujërave atmosferike

Për caktimi i sasisë së ujërave atmosferike janë marrë në konsideratë:

- Sipërfaqja e blloqeve
- Shuma e reshjeve mesatare vjetore për Prizren (747mm)

Në bazë të kësaj të dhëne është caktuar intensiteti reshjeve dhe por reshjeve 15min në çdo 2 vjet është caktuar se intensiteti i reshjeve është q=120l/s/ha.

- Lloji i mbulesës së sipërfaqet dhe
- koeficienti i vonimit

Sipas të dhënave të lartpërmendura janë caktuar sasisë e ujërave për secilin bllok dhe për Parkun në tërësi.

Pika shkarkueset ujërave atmosferike do të jetë në rrjetin e kanalizimit atmosferik në rrugën Prizren-Prishtinë dhe nga aty në prrockën më të afërt. Prandaj kahjen e rrjetit e ka përcaktuar vend shkarkimi dhe konfiguracioni i terrenit.

Që diametrat e gypave të jen më të vegjël janë caktuar që të jenë katër kolektor kryesor që do të ndajnë sipërfaqen e Parkut, gjegjësisht shfrytëzuesit në katër pjesë të barabarta.

Diametrat e gypave janë nga Ø250mm deri në Ø1000mm.

Kolektorët do të vendosen në mesi e rrugës.

Mesatarisht në çdo 30m duhen të vendoset puseta kontrolluese të kanalizimit.

Pusetat duhet të ndërtohen nga rrathët e betoni Ø1000/1000mm që përfundojnë më konus. Kapakët e pusetave duhen të jenë nga metali me peshë 166kg.

Rënia e niveletës mundësisht duhet të përcjellë rënien e terrenit.

Gypat do të jenë nga PESN/8, pasi që është material më i lirë dhe ka përdorim të gjerë në vendin tonë.

6.4. Energji elektrike

Hapësira e Planit Rregullues të Hollësishëm zona e veçantë "Parku i Biznesit" në Prizren furnizohet me energji elektrike nga rrjeti distributiv i Prizrenit gjegjësisht nga TS PZ-4 35/10 kV (2x8 MVA dhe 1x4 MVA) si dhe rrjeti ekzistues brenda ne hapësirën e planit rregullativ. Meqenëse me Planin Rregullativ hapësira e cila do të urbanizohet parashihet të jetë plotësisht e ndryshme nga ajo që është tani, nga rrjeti elektrik ekzistues do të shfrytëzohet vetëm TS 35/10 kV kurse pjesa tjetër e rrjetit elektrik duhet të parashikohet të jetë e re. Gjithashtu edhe rrjeti ekzistues i ndriçimit publik fare nuk inkorporohet me Planin rregullativ, prandaj duhet të parashihet rrjeti i ri i ndriçimit publik.

6.4.1. Nevojat për ndërtimin e kapaciteteve energjetike

Rrjeti distributiv ekzistues nuk mund të përmbushë nevojat e një plani të zgjeruar siç është parapare në këtë plan rregullues të Hollësishëm "Parku i Biznesit". Duke u nisur nga gjendja ekzistuese dhe propozimeve të dhëna, SEE distributiv dhe Sistemi Telekomunikues duhet të bëhet tërësisht i ri dhe në përputhje me dy rekomandime të dhëna në vazhdim:

1. Rekomandimet e master planit për zhvillimin e sistemit distributiv të Kosovës deri më vitin 2015, që përfshinë:
    - Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV
    - Kalimin nga rrjeti distributiv 10kV ne rrjetin distributiv 20kV
    - Zëvendësimin e TS 10/0.4kV me atë 20/0.4kV
    - Zëvendësimin i Linjave Ajrore 230/400V me kabllo bistek apo edhe kabllo nëntokësorë.
2. Rregulloret e IEC, IEEE dhe ANSI që për projekte të reja ne vende urbane, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe ato të rrjetit telekomunikues të ndjekin të njëjtën trase dhe të realizohen në të njëjtën kohë.

Rekomandimet dhe rregulloret e lartë shënuara obligojnë që SEE dhe SK të realizohen ashtu që:

Në njërën anë të trotuarit, të rezervuar për këtë qëllim në thellësi mbi 80cm ndërtohet i ashtuquajturi "kanalizimi kabllovik". Në të vendosen gypa PVC me diametër prej 250mm, që përforcohem me beton të klasës MB20. Në këta gypa vendosen:

- Linja e tensionit 10(20)kV me kabllo XHP 49A 240mm2.Me këtë bëhet furnizimi I trafo-stacioneve të blinduara me herës 10(20)/0.4kV dhe fuqi 400, 630 apo 1000kVA.
- Linja e tensionit 400/231V me kabllo PP00 4x95mm2;

- Linja e tensionit 400/231V me kabllo PP00 4x25mm2 të ndriçimit publik;
- Linja e kabllove të komunikimit (kabllo me fije optike);
- Linja e kabllove UTP 4x0.75mm2.

6.4.2. Kushtet teknike për shtrirjen e rrjetit elektrik

Këto kushte teknike janë pjesë të projektit dhesi të tilla e obligojnë investuesin dhe kryesin e punëve gjatë ndërtimit ti respektojnë këto rregulla.

Instalimet duhet të punohen sipas kërkesave teknike për kryerjen e instalimeve elektrike, shtojcës së kushteve teknike, paramasës së vizatimeve etj.

Tërë materiali i përdorur për kryerjen e instalimeve duhet të jetë i atestuar dhe i punuar sipas standardeve IEC, DIN etj.

Të gjitha punët duhet ti besohen punëkryesit profesional ndërsa ato punë duhet ti mbikëqyrë organi profesional mbikëqyrës.

Punët duhet të kryhen sipas projektit. Në rast se gjatë punës nevojitet ndonjë ndryshim i arsyeshëm kryerësi i punëve është i obliguar ta njoftoj organin mbikëqyrës dhe të marr pëlqimin me shkrim. Sipas nevojës organi mbikëqyrës do ta njoftoj projektantin nga i cili do të marr pëlqimin për ato ndryshime.

Gjatë kryerjes së punëve kryerësi duhet ta verifikoj (konsultoj) projektin në vendin e ekzekutimit.

Kryerësi i punëve mban llogari dhe përgjegjësi mbi shpenzimet në rast se gjatë montimit të pajisjes elektrike i dëmton punët tjera në objekt.

Kryesi i punëve duhet të jap garancion për rregullsinë e punëve të kryera për kohën e marrëveshjes.

Lëshimi në punë i instalimit duhet të bëhet pas përfundimit të kontrollës teknike dhe marrjes së pëlqimit.

Në princip kabllot duhet të shtrihen lirshëm në gypa në tokë me rastin e futjes së kabllos në trafostacion si dhe në të gjitha ato raste ku mendohet se kabllot duhet të mbrohen nga dëmtimet mekanike ose të izolohet në hapësirën nëpër të cilën kalon i tërë kabulli duhet të shtrihet kalojnë nëpër kanale kabllovike.

Dimensionet e kanaleve nëpër të cilët shtrihet kablloja në tokë (trotuare dhe hapësira të gjelbëruara) janë:

Thellësia 0,7 m -gjerësia – varësisht nga numri kabllove që shtrihen.

Shtrirja e kabllove nuk guxon të bëhet pa praninë e organit mbikëqyrës dhe personelit të njësisë distributive.

Gypat nuk guxojnë të shtrihen dhe të mbulohen përderisa organi mbikëqyrës dhe personeli i njësisë distributive nuk e incizojnë pozitën respektivisht trasenë e tij.

Përgjatë gjithë trasesë kablloja guxon të shtrihet me lakesa të buta (në formë gjarpërore) nga shkaku i kompensimit për arsye të ç vendosjes së trasesë së ngjashëm.

Traseja e kabllove zgjidhet ashtu që ti plotësoj kushtet optimale teknike dhe ekonomike. Ajo duhet të jetë e harmonizuar me trasat e instalimeve tjera nëntokësore si ujësjellësit, kanalizimit, telefonisë, ujit të ngrohët qendrore, gazsjellësit, etj.

Për shkak të hapësirës së kufizuar në vendbanimet e urbanizuara, pë shtrirjen e instalimeve të veçanta nëntokësore preferohet ndarja e hapësirës që disponojmë në zona, (si në shtojcën grafike).

Gjerësia e zonave të veçanta varet nga hapësira me të cilën disponojmë. Nëse kjo hapësirë është e vogël atëherë instalimet magjistrale të ujësjellësit dhe ujit të ngrohët qendrore, e sipas nevojës edhe instalimet tjera mund të shtrihen nën pjesën e rrugës. Gjerësia e zakonshme për kabllot energjetike është 0.7m, kurse gjerësitë e zonave për instalimet tjera varen nga kapaciteti i atyre instalimeve dhe hapësirës në disponim.

Preferohet që shpërndarjen e instalimeve të veçanta të caktohen zonat në të dy anët e rrugës.

Kablloja energjetike shtrihet me dorë ose duke përdorë pajisje mekanike siç janë litari për tërheqje, pasi paraprakisht të jetë shtrirë gypi. Tërheqja e kabllos bëhet me ndihmën e “çorapes” tërheqëse ose shtrëngueses tërheqëse, të lidhura për përçues ose për armaturën prej telave të çelikut. Nuk lejohet tërheqja e kabllove me automjet , tërheqja e tyre nëpër tokë, si dhe përdredhja e kabullit.

Temperatura më e madhe e ulët e lejuar e rrethinës gjatë shtrirjes së kabllove energjetike është:

+5oC për kabllot me mbështjellës letre (NPO 13-AS, etj.) dhe kabllo me izolim me PVC ose me mbështjellës PVC (PP00-ASJ, XHP 48, etj.);

-10oC për kabllot me izolim UPE dhe mbështjellës PE (XH 49-A, etj.)

Lejohet rënia e temperaturave edhe nën vlerat e dhëna në kohëzgjatje jo më tepër se 3 h (acaret e natës) gjatë 24 h para shtrirjes së kabullit.

Nëse nuk mund që t’i iket shtrirjes së kabllove kur temperaturat e rrethinës bien nën vlerat e cekura më lartë, atëherë kabulli para shtrirjes duhet të nxehet duke e mbajtur në kthina të ngrohta ose duke e nxehur me trupa ngrohës përkatës, respektivisht duke e lëshuar rrymën nëpër përçues. Kablloja e nxehur duhet sa më parë të transportohet dhe të shtrihet.

Gjatë nxemjes kabulli në kalem duke e lëshuar rrymën elektrike, duhet që të kontrollohet temperatura e mbështjellësit të rendit të jashtëm e cila nuk guxon të jetë mbi 20^{o}C nëse temperatura e ajrit është nën -10^{o}C; respektivisht mbi 30^{o}C nëse temperatura e ajrit është mbi -10^{o}C.

Pas shtrirjes së kabullit, tek shtrirja direkte në tokë para mbulimit të tërë të kabullit, duhet të bëhet testimi i tensionit të kabullit dhe të bëhet inçizimi i trasesë së kabullit.

Fundet e kabullit të shtrirë shënohen me pllaka në të cilat gjenden shënimet elementare për kabullin dhe shenja e kyçjes. Nuk lejohet të vendoset kjo pllakë në përçuesit e kabullit.

Është e obliguar që të mbahet evidenca kadastrale e përçueseve kabllovik në planet grafike, me shënimet e posaçme për vendet e kryqëzimit me kabllot tjera dhe instalimet tjera nëntokësore, për vendet lidhëse, gjatësitë e sakta të kabllove dhe traseve, me shënimet elementare për kanalizimin kabllovik (vendi, gjatësia, numri i gypave, numri i gypave rezervë, etj.).

6.4.3. Kanalizimi Kabllovik

Kanalizimi kabllovik përdoret në kalimet në trotuare, nën rrugë, për futjen e kabllove në trafostacion (nëpër oborret e ndërtesave, kur nuk mund të arrihen distancat e lejuara të kabllove në raport me instalimet tjera nëntokësore, etj.)

Kanalizimi kabllovik ndërtohet prej gypave të plastikës, por lejohet edhe përdorimi i elementeve të planifikuara të betonit (kablloreve). Mbi gypa vendosen shiritat vërejtës.

Seksioni i brendshëm minimal i gypit duhet të jetë më së paku 1.5 herë më i madhë se seksioni i jashtëm i kabullit (tre fijesh, respektivisht tufës së tri kabllove një fijesh). Muri i brendshëm i gypit duhet të jetë i lëmuar. Nëse gypat vazhdohen, atëherë fundi i zgjeruar (‘femërori”) i gypit duhet të jetë i dukshëm, kurse kabulli tërhiqet prej atij skaji.

Kur përdoren gypat e plastikës të gjatësive më të mëdha (mbi 10m), duhet të merret në konsideratë faktori i korrigjimit rrymorë (krr) për shkak të kushteve të vështirësuara të largimit të nxehtësisë, i cili për llogaritje praktike e ka vlerën:


krr = 0.8 nëse në gypa gjendet kabulli shumëfijësh i tipit XP00-ASJ, NPO 13-AS,etj.;

krr = 0.85 nëse në gyp gjendet tufa e tri kabllove një fijesh XHE 49-A, NPHA 03-A, etj.

Rekomandohet që shtrirja e kabllove të bëhet në dy nivele përveç në dalje të trafostacionit i cili projektohet enkas.

Nëse në kanalizimin kabllovik shtrihen kabllot e niveleve të ndryshme të tensionit, atëherë kabllot e tensioneve më të ulëta vendosen në nivelet më të larta të kanalizimit. Kabllot të cilat shtrihen më herët i nxënë hapjet më të ulëta në kanalizim.

Hapjet të cilat nuk shfrytëzohen duhet të mbyllen me kapakë të plastikës ose ngjashëm.




6.4.4. Puseta Kabllovike

Puseta kabllovike përdoret në vendet e ndërrimit të drejtimit ose nivelit të kanalizimit kabllovik, si dhe në trasenë e drejtë të kanalizimit kabllovik e cila është më e gjatë se 40m.

Puseta kabllovike ndërtohet në trotuar, e me përjashtime edhe në rrugë.

Puseta kabllovike, së bashku me kapak, duhet statikisht t'i durojë të gjitha ngarkesat të cilat paraqiten në vendin ku ndërtohet.

Madhësia e pusetës kabllovike varet nga numri i kabllove, kushteve të punës në pusetë, këndit të lejuar të lakimit të kabllove, etj. Hapja minimale e hyrjes, e cila është e mbuluar me kapak të metalit duhet të jetë 0.6m X 0.6m. Në fund të pusetës duhet të jetë hapja drenazhuese. Muret anësore mund të jenë nga betoni ose tullat.



6.5. Telekomunikacioni përfshirë lidhjet e internetit

Zona e Veçantë "Parku i Biznesit" është planifikuar të mbulohet me anë të centraleve telefonike automatike (CTA), ku lidhja e tyre do të bëhet në një drejtim me fije optike (12 fije)për hirë të funksionalitetit dhe sigurisë së lidhjeve telefonike. Duke u bazuar në mundësitë e reja teknologjike të centraleve telefonike automatike digjitale(dimensionet e vogla të tyre, mundësojnë vendosjen në hapësirat të vogla)si dhe forma e qytezës pejton është e tillë qe të

imponohet vendosja e dy centraleve automatike me kapacitet 2*3500=7000 numra telefonik, të cilat janë të ndërlidhura në mes veti me fije optike(12 fije).

Këto dy centrale të reja kanë pozitat më optimale për përhapjen radiale të kabllove telefonike dhe kabllovike .

Parametrat e përvetësuar për dimensionimin e rrjetit të PTT

- 1 postë në **5.000** banorë
- 1 sportel në **2.000** banorë
- Çdo apartament **1** kyçje të telefonit
- Biznesi dhe administrata: në **250 m²**, **1** kyçje të telefonit
- Ndërtimi i rrjetit për transmetim të dhënave (**25** terminale) **1** terminal/**1000** banorë
- Ndërtimi i telefonisë mobile
- Ndërtimi i rrjetit të radios dhe TV.

Duke u bazuar në këta parametra të përvetësuar, rezulton se:

- Numri i njësive postare është 4;
- Numri i tërësishëm i sporteleve është 10;
- Numri total i kyçjeve telefonike është 6.782;
- Numri i CTA është 2x3500parapagues

Realizimi i ndërtimit të komunikimit të PTT do të zhvillohet në përputhje me aftësinë ekonomike të qytetit dhe kushteve të ndërtimit. Lokacioni i njësive postare do të caktohet për secilën veç e veç, në marrëveshje me shërbimet e specializuara të PTK.

Lidhja e rrjetit të telekomunikacionit me qendrat tjera parashihet të bëhet me sistemet radioreleike apo me kabllo optik.

Kanalizimi tokësor kabllor i PTT duhet të vendoset në të gjitha rrugët, duke vendosur tubat dhe kabllot, në mënyrë që rrugët të mos gropohen nga disa herë.

6.5.1. Kushtet tekniko-urbanistike

1. Njësitë postare të ndërtohen sipas kërkesave të shfrytëzueseve. Secili lokacion duhet të planifikohet në bashkëpunim me urbanistin dhe me shërbimet e specializuara të qytetit.
2. Planifikimi i kapacitetit të rrjetit T.T. të parashihet të bëhet përgjatë trotuareve, hapësirave te gjelbëruara, shiritave për këmbësorë dhe nën rrugë të asfaltuara, në thellësi minimale të ndërtimit 0,8m.
3. Rrjetin shpërndarës të T.T. duhet ndërtuar në atë mënyrë që shfrytëzuesit potencialë të mund të lidhen në CTA.
4. Kapacitetin e rrjetit duhet ndërtuar ashtu që për çdo apartament të ketë një kyçje telefonike, kurse për administratë dhe biznes, në çdo 250m² të parashihet një kyçje telefonike.
5. Gjate ndërtimit të rrjetin nëntokësor apo mbitokësor, duhet t`i respektojnë të gjitha distancat me instalimet tjera sipas rregulloreve dhe normativave në fuqi.

KONKLUZION

Harxhimi total ne këtë zone do të jete rreth 13.45MW. Duke u bazuar ne gjendjen e re në qendrën industriale vijmë në përfundim trafostacioni 35/10kV me fuqi prej 2x8MVA duhet të kaloj në kapacitet prej 31.5MVA qe ti përmbush kërkesat e zonës.

-Kjo është pasoje e ngritjes se objekteve industriale dhe banesore etj;

-Vendosja e sakte neper zona te trafostacioneve do te behet ne baze te pëlqimeve Elektroenergjetik nga KEDS.

6.6. Mbrojtje nga zjarri

Në kuadër të zgjidhjes së furnizimit me ujë janë paraparë edhe hidrantët të cilët do të jenë në gjendje funksionale për të përballuar çfarëdo lloj fatkeqësie zjarri që përfshinë strukturat e ndërtuara apo edhe çfarëdo strukture tjetër jo ndërtimore në kuadër të zonës.

7. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

7.1. Parqet publike dhe hapësirat e hapura publike

Duke marrë parasysh që zona në fjalë ka për shfrytëzim kryesor prodhimin industrial, gjersa banimi individual dhe prodhime zejtare përbën vetëm 2.30% të tërë territorit, financiarisht nuk është arsyeshme apo e leverdishme të planifikohen institucione publike në këtë zonë.

Sa i përket hapësira të hapura publike, koncepti promovon masa për parandalim e ndotjes së ajrit nga aktivitetet industriale përmes krijim të zonave të gjelbëruara në blloqet D2 dhe D3, që mbulon një sipërfaqe prej 10,382.83 m2.

Lloji i shfrytëzimit të tokës	Blloku	Sipërfaqja e tokës (m^2)
Gjelbërim	D2	8,616.72
Gjelbërim	D3	1,766.11

Tabela 12 Veçoritë hapësinore të gjelbërimit

Sa i përket hapësirave rekreative, koncepti promovon masa për parandalim e ndotjes së ajrit nga aktivitetet industriale, mirëpo edhe përmirësimin e shëndetit përmes krijimit të zonave të mëdha të gjelbërimit, sportit, rekreacionit dhe argëtimit në blloqet E, që mbulon një sipërfaqe prej 359,999.41 m^2.

Shfrytëzimi	Bloku	Sipërfaqja e tokës (m^2)
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	237,609.52
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	29,780.13
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	171.86
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	13,149.92
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	71,441.83
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	3,394.82
Gjelbërim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim	E	4,451.33

Tabela 13 Veçoritë hapësinore të gjelbërimit, sportit, rekreacionit dhe argëtimit

8. PLANI I ZBATIMI

8.1. Plani investiv

Sipas të dhënave të furizuar nga Komuna e Prizrenit ne lidhje me paramasa dhe parallogari te Parkut të Biznesit, janë parashikuar që 3.9 Mil Euro do nevojiten që te kompletohet lokacioni.

REKAPITULLIM I PËRGJITHSHËM- PARKU I BIZNESIT		
1	**AKSI- (1-1)**	**812,286.80 €**
2	**AKSI- (2-2)**	**344,881.40 €**
3	**AKSI- (2'-2')**	**263,080.30 €**
4	**AKSI- (2''-2'')**	**252,284.80 €**
5	**AKSI- (3-3)**	**591,520.25 €**
6	**AKSI- (3'-3')**	**517,686.00 €**
7	**AKSI- (4-4)**	**465,662.30 €**
8	**AKSI- (5-5)**	**211,646.10 €**
9	**AKSI- (6-6)**	**215,500.70 €**
10	**AKSI-PRAN RRUGËS; (PRIZREN-SUHAREK)**	**301,013.00 €**
	Parallogaria	**3,975,561.65 €**

Komuna e Prizrenit ka furnizuar informata qe deri me tani ne 7 faza është shpenzuar 2,412,766 Euro. Nuk jane siguruar të dhenat e hollesishme lidhur me keto shpenzime por mund the thuhet se me 50% te punëve të ryera deri më tani, ka nevoje per investime kapitale prej 1,562,796 Euro per ta kompletuar lokacionin ne tërësi.

Vlera prej 1,562,796 Euro eshte shuma e investimit kapital menduar qe do te mjaftonte per perfunidimin e lokacionit, por nje plan investiv me i zbërthyer nuk mund te ofrohet, por ka te beje me investimet në fushat e infrastrukturës rrugore, teknike, sociale dhe hapësirave të ndryshme.

8.1.1. Mënyrat e financimit

Supozohet që Komuna e Prizrenit të financojë të gjitha investimet kapitale nga burimet vetanake dhe të mos përdorë mjetet e borxhit në realizimin e projektit.

Burime vetanake: 100%
Borxh: 0%

8.1.2. Plani financiar i projektit

Investimet kapitale të projektit supozohet të kryhen gjatë viteve: nga 2022 deri në vitin 2024. Komuna do mund të gjejë fondet e nevojshme dhe t'i alokojë ato në zhvillimin e infrastrukturës për fillim të operimit të zonës nga viti 2025. Fizibiliteti financiar është për 18 vite (3 vite zhvillim të infrastrukturës dhe 15 vite operimi).

Gjatë procesit të planifikimit janë shfrytëzimet në kuadër të zonës Parkut Industrial në Prizren, të cilat janë në harmoni me Hartën Zonale Komunale te Komunës së Prizrenit.

8.1.3. Arsyeshmëria ekonomike

- Krijimi i kushteve të favorshme për zhvillim të bizneseve të reja
- Krijimi i zonës turistike dhe rregullimi i zonave ekzistuese.
- Shfrytëzimi i resurseve natyrore për zhvillim ekonomik

8.1.4. Supozimet për modelin financiar

Supozimet:	**Vlera**
Njësia e përdorur	m^2 (Metër katror)
Vitet e investimit kapital	3 vjet
Vitet e operimit për studim të fizibilitetit	15 vjet
Inflacioni	2.5%
Sipërfaqja totale për të dhënë me qera m^2	320,000 m^2
Qiraja mujore e qirasë për m^2	0.35 Euro
Paga mesatare mujore e punëtorëve	650 Euro
Pjesëmarrje në borxh	0%
Investimi capital (Euro)	3,975,562
Investimi capital nga 2022-2024 (Euro)	1,562,796
Rritja e kostove operacionale	1.2%
Kostoja vjetore e mirëmbajtjes për m^2	0.02 Euro/ m^2
Norma e interesit	4%
Norma e skontimit	8%
Numri i punësuarve direkt	6 punëtorë

Investimi kapital prej shumës 1,562,796 Euro supozohet që mbarojnë në vitin 2024, kurse operimi i zonës të fillojë në vitin 2025.

9. ADMINISTRIMI, ZBATIMI DHE MONITORIMI I ZBATIMIT

Në rastin e PRrH-së për zonën e veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren, organi kompetent për zbatimin e Planit Rregullues (PRrH) është Komuna e Prizrenit.

Komuna e Prizrenit duhet që të bëjë përfshirjen e plotë të qëllimeve, objektivave dhe veprimeve të cilat do të jenë relevante për kohën.

Raportimi i zbatimit për PRrH-në Zonën e veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren, do bëhet në hap me ciklin e zbatimit i cili është i obliguar për raportim vjetor, por mundet me qenë edhe dy herë brenda vitit, sidomos para rishikimit të buxhetit në gjashtë mujorin e parë, me qëllim që gjatë rishikimit të buxhetit të kemi mundësin e futjes së ndonjë projekti ose alokimin e fondeve shtesë për ndonjë projekt i cili ka tejkaluar parashikimet buxhetore, këto informata e bëjnë administrimin e zbatimit mjaft të informuar por edhe veprues në kohë reale.

Pjesë e administrimit të zbatimit të PRrH-në Zonën e veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren, janë të gjitha përmbajtjet e karakterit hapësinor të Planit: duke filluar nga procesi i dhënies së kushteve ndërtimore, kushteve për infrastrukturë

teknike, rrugor, publike e sociale, masave mbrojtëse, lejeve ndërtimore, përjashtimeve, bonuseve të zonimit, shqyrtimi i përputhshmërisë, etj.

Administrimi i zbatimit të PRrH-në Zonën e veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren, nënkupton edhe menaxhimin me të gjitha aktivitetet e lart përmendura, por edhe trajtimin e kërkesave për jo konformitet, përjashtim apo bonuse të zonimit pas hartimit të Planit.

Si kusht i parë për të filluar procedurat e tilla është të kemi aplikim për të njëjtat nga ndonjë aplikues, subjektet fizike ose juridike duhet të aplikojnë zyrtarisht në përputhje me dispozitat e Planit dhe procedurat e aplikimit për jo konformitet, ndryshim-plotësim, përjashtim dhe/apo bonuse të zonimit, do përshkruhen brenda kapitujve të paraparë nga ligjvënësi si pjesë e Planit. Autoriteti kompetent duhet të bëjë të gjitha përpjekjet që këto procedura të sqarohen ashtu që të jenë më të lehtë për tu kuptuar nga aplikuesit dhe për t'u administruar. Procedurat e tilla janë trajtuar edhe në nenin 31 të UA MMPH-Nr. 01/2018, Ky udhëzim administrativ specifikon edhe kërkesat për aplikime për ndryshim plotësime në PRrH, por edhe për procedurën për përjashtimet dhe bonuset e zonimit.

Administrimi sidomos në funksion të shqyrtimit të përputhshmërisë nënkupton edhe një përgjegjësi të administratës për menaxhimin me marrjen e vendimeve për miratimin ose refuzimin e kërkesave për dhënien e kushteve ndërtimore, përjashtimeve, bonuseve të zonimit të përcaktuara Plan, i cili duhet bëhet duke krahasuar vendimet me kriteret, masat dhe kushtet e përcaktuara në Plan, por edhe ligje, rregullore dhe dokumente tjera. Përputhshmëria duhet shqyrtohet bazuar në përmbajtjet e dokumentuara dhe transparente.

Nëse kemi ankesa ndaj vendimeve të marra nga ana e autoritetit kompetent ose kërkesa për interpretime të ndryshme për përmbajtjet e pjesëve të Planit, në funksion të administrimit të zbatimit, interpretimi bëhet nga Autoriteti kompetent për planifikim dhe menaxhim hapësinor në nivel komunal dhe nga MMPH në nivel qendror, varësisht kujt do të i jepet administrimi i zbatimit të këtij Plani.

Gjatë zbatimit të Planeve, disa zhvillime të caktuara bëhen çështje e gjykatave: prej atyre komunale, e deri te nivelet e më të larta gjyqësore. Vlerësohet si i domosdoshëm bashkëpunimi me gjykatat dhe krijimi i një vije komunikimi dhe bashkëpunimi cilësor me to, në funksion të marrjes së vendimeve adekuate dhe me peshë të duhur. Ky bashkëpunim, është shumë i rëndësishëm sepse, është në funksion adekuat të parandalimit dhe të amortizimit të zhvillimeve të pa planifikuara. Duke e ditur se gjykatat tona janë shumë të ngarkuara, lëndët që vijnë nga kjo fushë duhet parë dhe duhet trajtuar me prioritet sepse, pasi që të bëhet zhvillimi apo implementimi në këtë drejtim, edhe tentimi për revidim ose edhe sanksioni eventual është i pa vlerë dhe jo efikas.

Nëse nuk krijohet një urë e bashkëpunimi efikas me gjykatat, lejohen apo stimulohen edhe më shumë zhvillimet e pa planifikuara dhe jo legale. Duke njohur rolin dhe fuqinë e gjykatave, Autoriteti kompetent, në funksion të zbatimit të Planit edhe Ekipi Punues si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ofruar kushte, duhet krijuar komunikimin dhe bashkëveprimin të duhur në mënyrë që aty ku është e domosdoshme (madje edhe duke bashkëpunuar edhe me mekanizma të tjerë, siç është policia), të pengohen ndërtimet e pa planifikuara dhe ilegale në funksion të zbatimit efikas dhe cilësorë të Planit.

Bashkëpunimi me Byro Projektuese dhe me Institute adekuate si dhe me institucione që merren me projekte zhvillimore në mënyrë profesionale, është i rëndësishëm dhe në funksion të zbatimit të Planit, e të informimit adekuat. Komunikimi dhe bashkëpunimi në këtë drejtim, është shumë i rëndësishëm. Nëse vendosen ura të bashkëpunimit dhe të komunikimit dhe ngritët niveli i bashkëpunimit në shkallë adekuate, këto institucione nuk do të hartojnë projekte pa qenë të bazuara në kushtet zhvillimore dhe ndërtimore të parapara me Plan dhe pa qenë brenda shfrytëzimeve që lejohen, lejohen me kushte ose me kushte të veçanta. Në të njëjtën kohë, këtyre institucioneve duhet bërë të kuptojnë se për veprime të jashtëligjshme, mund edhe të dënohen madje, edhe t'u ndalohet veprimtaria. Paralajmërimi si dhe shqiptimi i sanksioneve, besojmë se kontribuon direkt në zbatim e mirëfilltë të Planit. Në këtë drejtim, Autoriteti kompetent por edhe Ekipi Punues si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ta luajnë rolin e vetë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëveprimit me këto institucione.

10. NDRYSHIM PLOTËSIMET DHE PËRJASHTIMET

Fillimisht duhet sqaruar pas aprovimit të PRrH-së, se cilat janë mundësitë ligjore për ndryshim dhe plotësim të Planit dhe cilat procedura duhet kalojmë.

Duke e ditur se ndryshimi dhe plotësimi – nënkupton ndryshimet në pjesët tekstuale dhe hartografike të Planit, të cilat do të bëhen vetëm në përputhje me nenin 31 të aktit nënligjor, ku është përcaktuar se pjesët tekstuale ose hartografike të Planit në këtë rast të PRrH-së Zonën e veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren, mund të ndryshohen plotësohen me vendim të autoritetit kompetent dhe ndryshim plotësimi duhet të miratohet nga Ministria. Kjo rrethanë mund të aplikohet vetëm nëse në Hartën Zonale të Komunës janë bërë ndryshim plotësime apo edhe përjashtime pasi të jetë miratuar Plani Rregullues i Hollësishëm, Autoriteti për planifikim hapësinor në këtë pjesë plotëson këto ndryshim plotësimet dhe përjashtimet.

11. VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

Sipas ligjit të Planifikimit Hapësinorë nr. 04/L-174, përkatësisht nenit 23 dhe ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë nr. 03/L-230, dokumentet e planifikimit hapësinorë obligohen të kenë edhe raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë (VSM).

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prizrenit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prizrenit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prizrenit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prizrenit me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prizrenit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Finaciare (PVF). Pas kërkesës sonë disa çështje të ngritura në PVF-të janë korrigjuar dhe dorëzuar në MF. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e pasurive, të hyrave, llogarive të arkëtushme, subvencioneve, ekzekutimin dhe klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e projekteve kapitale si dhe në procedurat e prokurimit publik të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Bazuar në të dhënat e Thesarit, shuma totale e pagesave të realizuara në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore është 810,436€ nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si rezultat i mos zbatimi të kontratës kolektive.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pagesa e plotë për furnizim me lëndë djegëse

Gjetja	Rregullorja për shpenzimet e parave publike Nr.01/2013, neni 23 përcakton se; pranimi i mallit/shërbimit bëhet nga zyrtari/ komisioni i autorizuar. Përveç kësaj, kushtet e kontratës përcaktojnë se pagesat do të bëhen në bazë të furnizimeve të cilat ofrohen nga operatori ekonomik dhe aprovohen nga organi mbikëqyrës. Më datë 23.02.2022 është lidhur kontrate me OE në shumë prej 56,550€, për projektin "Furnizimi me dru për ngrohje për rastet sociale". Më datën 06.04.2023, komisioni në bazë të faturës së pranuar, ka konstatuar se furnizimi me dru është pranuar si në sasi ashtu edhe në cilësi sipas kushteve të kontratës. Sipas dokumentacionit të ofruar vërehet se sasia prej 725m3 është paguar, ndërsa furnizimi dhe pranimi i furnizimeve ishte 720m3 apo 5m3 më pak nga sasia e paguar/kontraktuar. Pas dëshmimeve të pranuara shihet se kjo sasi me lëndë djegëse është pranuar më vonë. Kjo ka ndodhur për shkak te mos funksionimit të kontrolleve të brendshme si dhe mungesa e përgjegjësisë nga komisioni përkatës.
Ndikimi	Ekzekutimi i pagesës për faturën e pranuar pa verifikuar pranimin e plotë të furnizimit është në kundërshtim më rregullat financiare. Në rastet të tilla rrezikohet arritja e vlerës për para dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve.
Rekomandimi A1	Kryetari duhet të sigurojë mbikëqyrje dhe kontroll mbi komisionet/organet mbikëqyrëse për pranim të furnizimeve me lëndë djegëse. Po ashtu, menaxheri i kontratës duhet të jetë më përgjegjës që furnizimet e tilla të bëhen në kohen e duhur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mos përfshirja e elementeve përkatëse në kushtet e kontratës me përfituesit

Gjetja	Sipas thirrjes publike të datës 26.06.2023, me nr. protokolli 10-320, është hapur aplikimi për participim me bashkëfinancim për subvencionimin e fermerëve të komunës me mekanizma bujqësore dhe moto kultivator. Po ashtu, në bazë të kontratës në pikën 1 të saj, është paraparë edhe numri serik për mekanizmat bujqësor për secilën kontratë. Më datën 19.06.2023, është lidhur kontratë publike në mes komunës dhe operatorit ekonomik për furnizimin e moto-kultivatorëve dhe mekanizmave bujqësore për fermerët e komunës së Prizrenit. Çmimi i kontratës kornizë ishte 357,400€ duke participuar komuna me 85% dhe fermerët e komunës me 15%. Me rastin e testimi të dy pagesave (183,000€ dhe 100,000€), kemi vërejtur se komuna ka bërë pranimin teknik të moto-kultivatorëve më datën 12.09.2023 duke konstatuar se janë pranuar sipas specifikave të kërkuara. Në bazë të rishikimit të 11 kontratave të lidhura me përfituesit në kuadër të drejtave dhe obligimeve tek kontratat me fermeret nuk janë plotesuar kontratat me informata relevante siç janë vendosja e numrave serik për mekanizmat bujqësor.

	Mos përfshirja e të gjitha kushteve të kontratës, siç është numri serik ka ndodhur nga mos zbatimi i kërkesave të përcaktuara me kushtet e kontratës.
Ndikimi	Mos përfshirja në kushtet e marrëveshjes edhe elementin për numër serik të të gjitha mekanizmave bujqësore mund të këtë si rrezik tjetërsimin eventual të tyre.
Rekomandimi A2	Kryetari të sigurojë se çdo marrëveshje me përfituesit/fermerët me rastin e dhënies së subvencioneve të çfarëdo mekanizmi bujqësor do të përfshijë elementet përkatës, duke kërkuar vendosjen e numrave serik të të gjitha rasteve të tilla.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja

Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin publik, neni 70.24 pika (f) përcakton se; menaxherët e kontratës "Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Nga testimet e bëra, ka rezultuar se në nënte (9) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi), si:

- ''Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive, shtrimi i fushave me tartan''në vlerë prej 174,174€;
- Renovimi i Qendrës Sportive "Sezair Surroi" në Prizren " në shumë prej 518,035€;
- ''Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive në Prizren'' në vlerë prej 262,000€;
- ''Ndërtimi i shtëpisë së pleqve'' në shumë prej 94,250€;
- ''Asfaltimi i rrugës Trepetic-Petrovë'' në shumë prej 198,933€;
- ''Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor Ardhmëria në Fshatin Landovicë'' në vlerë prej 522,546€;
- ''Ndërtimi i rrugëve lokale në Lubizhdë të Hasit'' në shumë prej 327,118€;
- ''Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor (aneksit të vjetër) Naim Frasheri Vlashnje'' në vlerë prej 64,083€; dhe
- ''Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Randobravë'' në vlerë prej 249,954€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e anashkalimit të përdorimit të procedurës së kërkuar nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi

Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit e lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin e kontratave.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mos përfshirja e vendimeve në e-prokurim për pagesat për inflacion

Gjetja Ligji nr. 08/l-183 për mbështetjen e punëve publike neni 7.2 përcakton se brenda tre (3) dite kalendarike pas nxjerrës së vendimit për aprovim ose refuzim të kërkesës për kompensim për inflacion, Autoritetet Kontraktuese i vendosin të gjitha vendimet në platformën elektronike të prokurimit publik. Çdo kërkesë për pagesë për kompensim për inflacion pa e respektuar këtë paragraf konsiderohet si e pavlefshme. Po ashtu pika 7.3 përcakton se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) monitoron nëse të gjitha vendimet për kompensim për inflacion janë të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik.

Sipas të dhënave të Thesarit në kuadër të kodit ekonomik''34200'' kompensim për inflacion, komuna ka paguar shuma totale prej 507,959€ për 25 projekte të ndryshme kapitale. Me rastin e testimit të dy mostrave në shumë prej 110,135€, kemi vërejtur se komuna ka bërë aprovimin për pagesë si kompensim të inflacionit deri sa këto vendime nuk janë vendosur në platformën elektronike të prokurimit publike, siç është përcaktuar me rregullativën në fuqi.

Në një rast tjetër, kemi vërejtur se një operator në bazë të kërkesës është marrë vendimi për kompensim të inflacionit në vlerë 30,000€. Pavarësisht, kësaj operatori nuk ka përmbushur kontratën në tërësi, ku vlera e punëve të pakryera ishte 36,515€.

Ne nuk kemi gjetur se komuna ka pranuar nga KRPP ndonjë sqarim me shkrim për mos funksionimin e e-prokurimit, përkundër që zyra e prokurimit ka njoftuar KRPP-në. Ndërsa në rastin tjetër, sipas menaxherit të kontratës për mos realizimin e kontratës në tërësi (për vlerën e lartcekur) ka ndodhur si rezultat i mos gatishmërisë, përkatësisht refuzimit së operatorit ekonomik për përmbushjen e kontratës në tërësi.

Ndikimi Mos respektimi i rregullave ligjore për vendosjen e të gjitha vendimeve në e-prokurim ka rezultuar nga mos përgjegjshmëria e zyrtarëve kompetente. Refuzimi për realizimin e kontratës në tërësi nga pune kryesi mund të ndikoj që komunës t'i shkaktoj probleme financiare me vlerë më të lartë.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës në rastet e tilla do të marrin masa korrigjuese të menjëhershme për të zbatuar detyrimin ligjor të raportimit të vendimeve për kompensim për inflacion në platformën elektronike të prokurimit publik. Po ashtu të kërkoj veprime apo mekanizma shtesë për realizimin e projektit nga operatori ekonomik apo të ndërmerr hapa tjerë ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet jo sipas rregullave financiare

Gjetja

Rregulla Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parasë publike, neni 22 përcakton se; hapat që fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, pranohet fatura dhe në fund procedohet për pagese nga Thesari.

Gjatë testimeve, kemi identifikuar se:

- Në (19) raste, në vlerë të pagesave 1,692,329€ zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimit të faturës; dhe
- Në (31) raste, në vlerë të pagesave 2,271,085€, urdhër blerjet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës, jo siç kërkohet me rregulla financiare.

Kjo dukuri ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar rregullat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës, si dhe nga mos planifikim i duhur i rrjedhës se parasë.

Ndikimi

Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi, si dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mungesa e projektit ekzekutiv

Gjetja

Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (UOPP), neni 20, pika 10 i kërkon që ″Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten″. Ndërsa, pika 13 ″Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatorë duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit″. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Projekti për "Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt” në vlerë prej 3,470,000€, nuk kishte një projekt ekzekutiv të hartuar nga komuna. Megjithatë, ishte nisur procesi i prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë".

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos parashikimi me kohë të këtij projekt për investim.

Ndikimi

Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa projekt ekzekutiv, rrisin rrezikun e

realizimit të punëve pa kritere standarde të ndërtimit, vonesa në realizimin e tyre dhe të mos arrihet cilësia e duhur.

Rekomandimi A6 Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, faturat mund të ekzekutohen direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Në (6) gjashtë raste, faturat në vlerë totale prej 601,437€, të paraqitura në pasqyra financiare, prezantojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë nga 15 ditë deri në rreth 4 muaj.

Me testimin e nëntë (9) pagesave nga kategoria e investimeve kapitale dhe gjashtë (6) pagesave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve kemi identifikuar se janë ekzekutuar pagesa në bazë të vendimeve përmbarimore/gjykatave. Sipas vlerës së testuar të këtyre mostrave kemi vërejtur se në emër të pagave për shujta/paga jubilare janë paguar 89,448€, (nga investimet kapitale) përkatësisht 74,191€ (nga mallra dhe shërbime).

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos pagesave me kohë të detyrimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilare, ku një pjese e tyre ishin për shujta për implementimin e kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.

Ndikimi Si pasojë e vonesave të pagesave, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave e gjobave/shpenzime gjyqësore për vonesat të kërkuara nga palët e treta.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Me kontratën publike të nënshkruar mes komunës dhe kontraktuesit, përcaktohen kushtet e veçanta kontraktuale si dhe afati kohor për realizimin e projektit. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë dhe të sigurojnë se kontratat po realizohen si duhet dhe në afatin e përcaktuar.

Në tre (3) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim:

- Kontrata "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive dhe shtruarja me tartan'' në vlerë 174,174€, e nënshkruar më datë 03.02.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 180 ditë;
- Kontrata "Ndërtimi i rrugës Trepetice - Petrove'' në vlerë 198,933€, e nënshkruar më datë 23.05.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 120 ditë; dhe
- Kontrata ''Ndërtimi i rrugëve lokale Lubizhde të Hasit'' në vlerë 327,118€, e nënshkruar më datë 08.03.2021, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 360 ditë.Deri sa ishim nën auditim (prill 2024), asnjëra nga këto projekte nuk ishin të përfunduar.

Shkak i vonesave ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën si pasoj e planifikimit jo të duhur të projektit, si dhe të disa problemeve në shpronësimin e pronave.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në menaxhimin e kontratave duke zbatuar një mbikëqyrje të rregullt dhe efektive. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme

Gjetja Ligjit nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 36, paragrafi 1 përcakton se "Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ për Menaxhimin Financiar në Kosovë në përputhje me rregullat".

Në 13 raste komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale duke mos pasur mjete mjaftueshme të zotuara. Rastet kanë të bëjë me projektet:

- Projekti ''Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt" me vlerë të kontratës prej 3,470,000€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 50,000€;
- Projekti ''Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Zhur'' me vlerë të kontratës prej 2,497,919€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 50,000€;
- Projekti ''Rregullimi i ndriçimit publik në fshatin Lubizhdë të Hasit të Prizrenit'' me vlerë të kontratës prej 444,887€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 14,307€;
- Projekti ''Shtresimi i rrugëve me asfalt në fshatin Hoqë'' me vlerë të kontratës prej 248,980€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 17,801€;
- Projekti ''Shtresimi i rrugëve me asfalt në fshatin Hoqë të Qytetit'' me vlerë të kontratës prej 76,671€, deri sa zotimi i mjeteve nuk ishte

bashkangjitur deklaratës së nevojave të disponueshmërisë;

- Projekti ‘’Rehabilitimi dhe rivitalizimi i hapësirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, restaurimi shesheve dhe objekteve’’ me vlerë të kontratës sipas çmimit për njësi 3,360 (vlera e parashikuar 3,000,000) deri sa zotimi i mjeteve ishte 5,914€.
- LOT 2 ‘Furnizim me pelet për ngrohje për shkollat e Komunës së Prizrenit 2023/2024 me vlerë totale indikative të kontratës prej 354,042€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 5,000€;
- ‘Furnizim me zhavor për rrugët e paasfaltuara në Komunën e Prizrenit” me vlerë të kontratës prej 1,399,255€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 24,312€;
- ‘Furnizim me lëndë djegëse dru ahu për ngrohje për familjet e dëshmorëve, familjet e invalidëve të luftës dhe familjet skamnore – rastet sociale të Komunës së Prizrenit’ me vlerë totale indikative të kontratës prej 184,161€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 24,000€;
- ‘Transporti i mësimdhënësve udhëtar në Komunën e Prizrenit’ me vlerë totale indikative të kontratës prej 266,335€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 10,000€;
- Revista teatrore’’ me vlerë të parashikuar të kontratës prej 60,000€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 19,425€;
- ‘Hartimi i projekteve sipas nevojave të drejtorisë për Turizëm dhe zhvillim ekonomik’ me vlerë të kontratës totale indikative prej 59,950€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 1,000€; dhe
- ‘Furnizim me material higjienik për nevojat e KPSH (projekt 2 vjeqar)’ me vlerë totale indikative të kontratës prej 139,935€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 15,000€.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur zotim të mjeteve.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike: (mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale).

Çështja B4 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Rregulla Financiare rr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike", neni 18, pika 3 specifikon se; shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 241,824€ në kategori jo adekuate :

- Nga kategoria investimet kapitale janë paguar për paga dhe mëditje/shujta në shume prej 89,448€; dhe
- Nga kategoria për mallra dhe shërbime janë paguar 74,191€, për furnizim me mjete ndihmëse për OJQ-të dhe klubet sportive si dhe 78,185€ janë paguar për furnizim me material për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale në Prizren, që për nga natyra shpenzimi i takon subvencione dhe transfere.

Pagesat për paga jubilare dhe shujta kanë ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe keq klasifikimi ka ndodhur si rezultat i mos zbatimit të kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ri-destinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PVF-të e vitit 2023 është 502,556,542€, pasurive jokapitale është 3,314,325€, si dhe stoqet 439,693€.

Çështja A7 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim

Gjetja

Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi.

Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€, kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara në regjistrat kontabël investime në vijim në vlerë prej 57,444,588€. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2013-2023, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar ose që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

Ndikimi

Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduara, apo atyre që janë në proces dhe të pezulluara, ndikon në paqartësinë e statusit dhe raportimit të tyre. Kjo sjell mangësi dhe vështirësi në vlerësimin e saktë të pasurive të komunës, duke e bërë të vështirë menaxhimin efektiv të tyre.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mos regjistrimi dhe mos harmonizimi në kohën e duhur të regjistrit të pasurive jo financiare

Gjetja

Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 6, paragrafi 3 përcakton që; “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.” Më tutje neni 19, pika 4.7, përcakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PVF-ve.

Gjatë auditimit kemi konstatuar se:

- Në shtatë (7) raste/pagesa të realizuara në vitin 2023, në vlerë totale prej 513,637€ nuk ishin regjistruar në SIMFK dhe PVF, por këto pasuri janë regjistruar në kohën procesit të auditimit (prill 2024);

- Në vitin 2023, komuna ka regjistruar pasuritë jo kapitale në sistemin e-pasuria, por këtij regjistri i mungon informata lidhur me kodin e nënkategorisë për të identifikuar regjistrimet e vitit të audituar; dhe
- Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte formuar me kohë, mirëpo nuk kishte arritur të përfundoj raportin para përgatitjes së PVF-ve, por më datën 23.02.2024.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos përgjegjësisë së zyrtarëve për realizimin e detyrave të përcaktuara me kohë dhe sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi

Mos regjistrimi i plotë i pasurive kapitale dhe jo kapitale me informatat të duhura, si dhe mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurisë brenda afatit të paraparë ligjor rrit rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë që posedon komuna. Gjithashtu shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive, si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të siguroj regjistrimin e plotë të pasurive kapitale në SIMFK në kohen e duhur dhe pasurit jo kapitale të regjistrohen në e-pasuri me informatat e duhura sipas nën kodeve ekonomike të kërkuara. Po ashtu, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PVF, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arketueshme të prezantuara në PVF e vitit 2023 në total janë 22,978,746€. Saldo e të arketueshmeve kryesisht përbehet nga tatimi në pronë, taksat për menaxhimin e mbeturinave, taksat për biznese, qiraja nga shfrytezimi i pronave komunale, etj.

Çështja B5 - Rritje e saldos së llogarive të arkëtueshme

Gjetja	Sipas nenit 26.1 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove. Po ashtu, neni 27.1 1. specifikon se; nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Në pasqyrat financiare janë shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë 22,978,746€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë (53%), taksës nga mbeturinat (22%), taksës për bizneset (11%), qirasë për shfrytëzimin e pronës publike (4%) dhe taksës për leje ndërtimi (10%). Në 57 raste të hyrat nuk ishin inkasuar me kohë, kjo ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin paraprak për 4,042,130€. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme ligjore në arkëtimin e të hyrave.
Ndikimi	Mos arkëtimi në kohë i të hyrave ndikon në nivelin më të ulët të buxhetit për shkak të fondeve të pa mbledhura dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale. Kjo po ashtu ndikon në vjetërsimin e këtyre llogarive duke pamundësuar arkëtimin.
Rekomandimi B5	Kryetari të siguroje përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[5]	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**60,491,944**	**69,387,339**	**62,409,458**	**46,266,941**	**50,185,605**
Grante Qeveritare - Buxheti	49,088,386	52,703,176	50,062,613	36,663,440	41,768,695
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	359,900	311,911
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	3,000,000	3,000,000	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	4,632,318	4,366,480	3,934,810	2,405,653
Të hyrat vetanake	8,403,558	8,403,558	7,885,742	5,118,768	5,382,984
Donacionet vendore	0	543,880	72,273	41,530	315,934
Donacionet e jashtme	0	104,407	22,349	148,492	428

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 8,895,395€, kjo rritje është rezultat i kursimeve nga Granti qeveritar në bazë të vendimit të qeverisë për 3,614,790€, bartjes së të hyrave nga viti paraprak 4,632,318€, dhe përfitimi i fondeve nga donatorët e brendshme 543,880€ dhe të jashtëm për 104,407€.

Në vitin 2023 Komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final ose 62,409,458€, me realizim me të mirë se vitin e kaluar (2022 – 84%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**60,491,944**	**69,387,339**	**62,409,458**	**46,266,941**	**50,185,605**
Pagat dhe mëditjet	22,108,383	25,767,591	25,709,009	21,098,714	24,546,533
Mallrat dhe shërbimet	12,000,408	12,282,490	11,829,897	10,135,739	8,170,451
Komunalitë	1,220,785	1,644,219	1,570,749	818,129	741,445
Subvencionet dhe transferet	3,500,000	3,618,201	3,537,966	2,562,388	2,562,240
Investimet Kapitale	21,432,368	25,844,839	19,761,836	11,651,971	14,164,936
Rezervat	230,000	230,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

• Buxheti final me buxhetin fillestar të kategoria paga dhe mëditje ishte rritur për 3,659,208€, nga granti shtesë nga Qeveria si rezultat i aplikimi të Ligjit të ri të pagave dhe pagesave nga vendimet gjyqësore;
• Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 282,082€, apo 96% e buxhetit ishte shpenzuar ndërsa komunalit janë rritur 423,434 krahasuar me buxhetin fillestar;
• Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur 118,201€, përderisa realizimi ishte në shkallën prej 98% e buxhetit final;
• Buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,412,471€, apo 76% e buxhetit ishte shpenzuar. Po ashtu, edhe dinamika e realizimit për 19 nga 214 projekte të parapara në vlere prej 3,660,000 nuk kanë pasur shpenzime fare për vitin vijues. Është me rendësi të theksohet se dinamikes për investimeve kapitale i ka kontribuar dhe pagesat prej 2,087,859€ në emër të vendimeve gjyqësore; dhe

Si rezultat i situatës pandemie me COVID-19, Komuna e Prizrenit kishte shpenzuar 31,088€, prej të cilave janë paguar për paga dhe mëditje ne sektorin e shëndetësisë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e planifikuara për vitin 2023 ishin 8,403,558€, ndërsa janë realizuar 9,579,478€, duke tejkaluar planin për 14%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2023 Komuna e Prizrenit ka përfituar të hyra nga gjobat në trafik dhe gjykatave në vlerë 1,113,117€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikon dhe i realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	**8,403,558**	**8,403,558**	**9,579,478**	**7,538,665**	**7,952,471**
Të hyrat tatimore	3,497,307	3,497,307	3,580,180	2,572,438	3,168,586
Të hyrat jo tatimore	4,906,251	4,906,251	5,999,299	4,944,441	4,774,606
Të hyrat tjera	0	0		21,785	9,279

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2022 për Komunën e Prizrenit ka rezultuar me 14 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2022 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në Kuvendin Komunal të Prizrenit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende deri sa një në proces të zbatimit dhe një nuk është i aplikueshëm, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e vlerësimit shqyrtojnë aplikacionet në përputhje me kriteret e përcaktuara me thirrjen publike, dhe se përdorin formularët zyrtar të procesit të subvencionimit të OJQ-ve siç përcaktohet me rregullore. Po ashtu, monitorues të realizimit të projekteve të subvencionuara të mos jenë anëtarët e komisionit të vlerësimit të kërkesave. Gjithashtu të sigurohet se, monitoruesit e projekteve të mbikëqyrin realizimin e projekteve të subvencionuara dhe se përfituesit dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar pas përfundimit të projekteve.	Janë ndërmarre veprime të nevojshme.	I zbatuar

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që të punësuarit me kontratë për kohë të caktuar angazhohen vetëm për afatin e caktuar me kontratë. Në rastet kur vlerësohet nevoja për punonjës të rregulltë, të zhvillohet procedura e rekrutimit përmes konkursit publik.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuara të aplikohen penalet e parapara me kontratë. Siguria e ekzekutimit të kontratës dhe garancioni i punimeve të bëhen në vlerën dhe afatin e përcaktuar me kushtet e veçanta të kontratës. Në rastet kur projektet tejkalojnë planin dinamik të realizimit, sigurimi i ekzekutimit të kontratës duhet të vazhdohet dhe të mbulojë periudhën kohore deri në realizim.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë së është arritur së paku 20% e verifikimit të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës.	Janë ndërmarrem veprime të nevojshme.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Specifikimet teknike të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore, duke mos përdorur emrin e markës tregtare apo modelit që favorizon apo diskriminon ndonjë OE. Gjithashtu, të sigurohet se sigurimi i ekzekutimit të kontratës bëhet në vlerën dhe afatin e përcaktuar me njoftimin për kontratë.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se para nënshkrimit të kontratave publike mjetet financiare zotohen në SIMFK. Në rastet kur procedurat e prokurimit për arsye objektive nuk finalizohen në vitin fiskal kur është filluar procesi i kontraktimit, atëherë ri-zotimi i mjeteve në SIMFK të bëhet në vitin vazhdues.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos pagesë me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore / përmbarimore ndaj komunës. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.	Nuk është i aplikueshëm.	Nuk është i aplikueshëm më

8.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri-destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se te kontratat publike të kontraktuara përmes procedurës me çmim të peshuar, raporti i peshimit apo përqindjes së përcaktuar për kategoritë të jetë i njëjtë edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	I zbatuar
10.	Pasuritë	Kryetari të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për aplikimin e sistemit të e-pasuria për regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Janë ndërmarrë veprime të pjesërishme.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se drejtoritë përkatëse mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyra financiare të jetë i saktë dhe i drejtë.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	I zbatuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes se veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar në paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë një koordinim të duhur të informacionit dhe përmirësim të komunikimit në mes departamenteve, në mënyrë që të sigurohen evidenca të sakta dhe të plota të detyrimeve kontingjente për prezantim në pasqyrat vjetore financiare.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme 

Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm 

Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit 

Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit 

Luljeta Morina, Anëtare e ekipit 

Edon Kabashi, Anëtar i ekipit 

Shtojca I: Letër konfirmimi

Leterkonfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Komunës së Prizrenit**, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit

Data: 10.06.24, Prizren.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[6] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[7], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) është i ndërtuar nga MAPL në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar. MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK.

Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

1. Funksionalizimin e sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të performancës dhe mbajtjen e trajnimeve për të gjithë zyrtarët e komunave;
2. Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
3. Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
4. Mbrenda afatit për raportim është bërë verifikimin paraprak i të dhënave;
5. Adresimi i ndryshimeve eventuale në sistem, pas verifikimit paraprak;
6. Verifikimin e të dhënave me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në teren;
7. Verifikimin e rregullt sipas mostres prej 27 treguesve
8. Nxjerrjen dhe komunikimin preliminar të rezultateve të performancës në komuna;
9. Përmbylljen e periudhës së ankesave;
10. Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së nga komunat, pas udhëzimeve/trajnimeve të organizuara nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave.

Verifikimi i të dhënave – sigurimi i cilësisë së të dhënave dhe verifikimi i tyre është bërë përmes disa metodave:

- Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;
- Shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të bashkëlidhura me formularët e plotësuar në sistemin elektronik;
- Sqarimeve të ofruara nga koordinatorët në Sistemin Elektronik të Performancës;
- Krahasimit të të dhënave me dokumente të tjera zyrtare të institucioneve publike;
- Krahasimit me raportet e tjera zyrtare të MAPL-së;
- Për të dhëna të caktuara janë kontaktuar direkt zyrtarët përgjegjës në komuna

Kapitulli I

I. Performanca e komunave 2023 – Pjesa e Përgjithshme

1. Vështrim i përgjithshëm i matjes së performancës komunale

Matja e performancës së komunave është proces i rregullt i cili implementohet në Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse në komunë, duke përfshirë zyrtarët raportues, koordinatorët e performancës dhe kryetarët e komuanve, si autorizues të fundit të të dhënave të raportuara nga komunat.
Matja shtrihet brenda kornizës së kompetencave të komunave sipas legjislacionit bazë dhe atij sektorial. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale ka përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e komunave në fusha të shumta të qeverisjes lokale, përfshirë: shërbimet publike, infrastrukturën lokale, mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, ndriçimin publik, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe ndërtimin, furnizimin me ujë të pijshëm, rrjetin e kanalizimit, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e arsimit parauniversitar, shëndetësinë primare, shërbime të mirëqenies sociale, aktivitetet kulturore, si dhe shumë çështje të tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) mundëson që rezultatet e fituara të shërbejnë si mjet identifikimi për aspektet e forta dhe të dobëta të qeverisjes lokale, në mënyrë që nga informacionet e fituara, të ndërtohen strategji për përmirësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Matja e vitit 2023 është realizuar në 16 fusha të kompetencave komunale, me gjithsej 93 tregues. Elementet e matjes së performancës shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore[2]. Indikatorët e përdorur japin informacione të konsiderueshme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara japin indikacione të rëndësishme për menaxhmetin e komunës për të shtrirë prioritetet në sektorët më pak të zhvilluar.

Edhe në vitin 2023 procesi i matjes së performancs komunale është bërë me anë të Sistemit Elektronik i menaxhimit të Performancës, në të cilin kanë qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave dhe ministrisë. Digjitalizimi i këtij procesi ka mundësuar një formë interaktive të komunikimit, për të qartësuar të gjitha të dhënat diskutabile dhe për të rritur shkallën e dokumentimit. Njëherësh sistemi mundëson gjurmimin e të gjithë hapave të vlerësimit dhe ruan të gjitha dokumentet relevante mbi të cilat bazohet raportimi.

2. Trendet e performancës së komunave ndër vite

Në vitin 2023, kërkesës për raportim të performancës janë përgjigjur 34 komuna, nëdërsa 4 komuna tjera nuk i kanë raportuar të dhënat në SMPK. Komuna e Novobërdes ka raportuar vetëm 31% të të dhënave. Rezultatet e tregojnë se niveli i të arriturave të komunave ndër vite varion prej 57.06% deri në 59.38%, në vitin 2022, kurse në vitin 2023 është 58.24%.

Duhet cekur se elementet e matjes së performancës kanë ndryshuar ndër vite, për shkak të përfshirjes së risive brenda SMPK-së, përkatësisht shtimit dhe zvoglimit të treguesve dhe të dhënave të reja. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale. Kjo rritje po ashtu është bërë për faktin se komunat kanë forcuar kapacitetet e tyre për përdorimin e sistemit të performancës, duke rritur kualitetin e të dhënave të raportuara. Analizat e përgjithshme tregojnë se disa tregues tanimë kanë arritur një standard të mirë të funksionimit, që dëshmojnë për nivel të të rregullsisë brenda rezultateve të synuara. Në anën tjetër ekzistojnë parametra të caktuar për të cilët komunat akoma qëndrojnë në nivel të ulët të zhvillimit, për të cilët treguesit e matjes duhet të jenë prezent në një periudhë afatgjatë.

Më poshtë janë paraqitur përqindjet mesatare nga viti 2020 deri në vitin 2023, si në vijim:




Fig.1. Performanca e komunave sipas viteve 2020-2023

[2] Udhëzim Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale

Rezultatet e vitit 2023

Sa i përket të dhënave për vitin 2023, performanca e përgjithshme e komunave në 16 fusha me 85, nga gjithsej 93 tregues të matjes është 58.24%, që do të thot se komunat kanë ofruar shërbime më të ulëta se në vitin 2022, për 1.14%, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ndonëse ka një ngritje të lehtë të performancës në vitin 2023 prej 1.18%.

Mesatarja e përgjithshme tregon se komunat duhet të rrisin përpjekjet tyre për të përmirësuar shërbimet dhe qeverisjen. Referuar % sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehet në këto fusha: përfaqësim të barabartë gjinor (39.66%), infrastruktur rrugore (42.45), transport publik (46.93%), arsim parauniversitar (48.78%) barazia në punësim(49.71%) hapsia publike (51.59%), mbrojtja e mjedisit (52.56%), zhvillim ekonomik lokal (56.75%), dhe shërbime publike (58.05%), i cili shërbim është shumë afër me mesatarën e vendit.

Mbi nivelin mesatar të vendit janë shërbimet si në vijim: Shërbime publike Administrative janë në nivelin më të lartë prej 80.00% në nivel vendi, e pasuar nga fusha transparenca komunale 73.02%, menaxhimi i fatëkeqësive me (69.30%) fusha kujdesi primar shëndetësore me 68.61% pasuar nga planifikimi hapsinor me 67.90%, fusha përgjegjëshmëria komunale ka vlerën 63.79% dhe Kultura Rina dhe Sporti janë shërbime të cilat janë shumë afër meastares së vendit ku janë ofruar në nivel të kënaqëshmëm që shprehur në përqindje janë 62.70%. në grafikun Nr.2 shihet se 7 fusha të shërbimeve janë ofruar mbi mesatarën e vendit, ndërsa 9 fusha tjera janë ofruar nënë mesatarëne e vendit që shprehur në % 43.75% të fushave janë mbi mesatare dhe 56.25% tæ fushave janë nënë mesatare.

Më poshtë është paraqitur figura me % e arritur të 16 fushave të matjes:




Fig.2. Performanca sipas fushave

Ndarja e fushave sipas kategorive dhe niveleve të performancës, në kater nivele i kemi ndarë 16 fushat e qeverisjes nga komunat. Sipas grafikut më lartë, në nivel të lartë të përformancës janë pesë (2) fusha të radhitura sipas përqindjes, shërbimet Transaparenca komunale dhe 73.02.%, përktësisht 80.00% sherbimet publike administrative.




Fig. 3 Kategorizimi i fushave sipas nivelit të performancës

Ndërsa niveli i dytë përcatkotohe sipas përqindjes e që fillon 62.70% deri në 69.30%, sikurse niveli i tretë sipas kategorisë përbën përqindjen 51.59% deri në 58.05% dhe niveli i katër ose i fundit sipas përqidnjes fillon në 49.71 deri në 39.66%, sa ka edhe fuisha përfaqësimi gjinor. Nga kjorenditje shihet që nuk ka ndryshime të thkesuara nga viti 2022, edhe pse në vitin 2023 është rishikuar SMPK, edhe në vitin 2022 kanë qenë të renditura njësoj sipas performancës komunale, vetëm se vërhet nje ndryshim i vogel specifik sipas përqinjdjes.

Elementet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale sigurojnë informata edhe për procedura dhe aspekte ligjore të një shërbimi publik, për këtë arsye kategorizimi i fushave për nga niveli arritjeve është bërë duke duke marrë parasysh qëllimin e treguesve, ngjashmëritë në mes të tyre, përmbajtjes dhe llojit të fushës së kompetencës. Së këndejmi, grupimi i fushave në vijim merr parasysh këto segmente:

1) Standardet e qeverisjes së mirë
2) Ofrimin e shërbimeve publike

Nga figura 4 vërejmë që në kuadër të treguesve të qeverisjes të dhënat tregojnë se komunat kanë rritur efikasitetin në ofrimin e ***Përfaqësimi gjinor,*** prej 39.66.% që mund të quhet një arritje mjaft e konsiderueshme e komunave për vitin 2023. Në kuadër të fushës barazia në punësim, shërbime sociale dhe familjare niveli i përgjithshëm i arritjes shprehet me 49.71%[3].

1) Standardet e qeverisjes së mirë

Në kuadër të ***Shërbimeve publike administrative***, niveli i përgjithshëm i të arriturave shprehet me 80.00%, Fusha Zhvillimi Ekonomik Lokal ka një nivel mjat të lartë që shprehet me 56.75% ku edhe kjo fushë krahasuar me vitin 2022 ka një ngritje të kënaqëshme prej 23.62%. Fusha ***Transparenca komunale*** për vitin 2023, shprehet me 73.02% në vitin 2023. Në fushën përfaqësimi gjinor për vitin 2023, mund shihet në figurën Nr 4, dhe ka vlerën 39.66%

[3] Per me teper: https://mapl.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2021/05/Dokumenti-Kryesor-i-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Performances-Komunale-_designed-18.02.2021.pdf, fq. 62




Fig. 4 % e arritur në fushat e qeverisjes

Transparenca komunale lidhet ngushtë me fushën e përgjegjshmërisë komunale, e cila vlerësohet me numrin më të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Për dallim nga treguesit e transparencës të cilët kryesisht janë të orientuar në ofrimin e publicitetit për aktivitetet dhe të dhënave zyrtare, përgjegjshmëria komunale inkorporon të dhëna që tregojnë për nivelin e llogaridhënies së organeve komunale, si dhe aktivitet e tyre për përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Në vitin 2023 këto dy fusha kanë shënuar rënje, ndoshta për faktin se në vitin 2023 është bërtë rishikimin i Sistemit per Menaxhimin e Perfoamncës Komunale dhe si rrjedhoj jane hequr disa tregues të këtyre fushave. Kjo mund të themi që është një indikacion i rënjës së ofrimit të sherbimeve tek këto dy fusha.

Në kuadër të veprimeve që ***ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal*** komunat kanë performancë me nivel të përgjithshëm të të arriturave në shkallën 56.75%, edhe kjo fushe ka nivel të njëjet të aritjes së performancës krahasuar me vitin 2022.

Shërbime Publike- Në kuadër të kësaj fushe përfshihen tregeues dhe të dhëna për ujë të pijshëm, menaxhim të mbeturianve dhe kanlizimet. Rezultatet e kæsaj fushe shprehur në përqidje janë të kënaqëshme dhe kanë vlerën prej 58.05%

Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare **-** Në kuadër të kësaj fushe janë matur veprimet e komunave për ofrimin e banimit social, si dhe kujdesin institucional ndaj grupeve të cenueshme. Po ashtu janë mbledhur të dhëna për punësimin e personave me aftësi të veçanta dhe punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë bazuar në të drejtat ligjore të tyre. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 49.71%, krahasuar me 60.30% në vitin paraprak.

2) Fushat me tregues për ofrimin e shërbimeve publike.

Në kuadër të këtyre fushave bëjnë pjesë tregues për lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave, si në: Shërbime publike, mbrojtje të mjedisit, planifikim urban, aktivitete kulturore, arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mirëmbajtje të hapësirave publike, mirëmbajtje të rrugëve, shtigje të biçikletave, parkingje publike, shenjëzim të rrugëve etj.




Fig.5. Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2023

*Fusha**, Kulturë, rini dhe sport,*** për vitin **2023** ka shkallën më të lartë të ofrimit të këtij shërbimi në nivel të gjitha komunave, e shprehur në përqindje në vlerën prej 62.70%, e pasuar nga sikurse edhe fusha **e Arsimit parauniversitar** si kompetencë vetanake komunale ka një renditje të mirë sa i përket ofrimit të rezultateve në ofrim të shërbimeve komunale me 48.78%. **Planifikimi Hapsinor,** renditet e katërta sa i perket listës së ofrimit të shërbimeve kualitative e cila është shprehur %, kap vlerën 67.90%, dallim të vogël vërejmë edhe në fushën **Infrastruktura rrugore,** e cila në përqindje ka vlerën prej 42.45%, me pas renditet fusha **Menaxhimi i fatkeqësive,** e cila është shprehur në pëqinjde në vlerën prej 69.30%. **Mbrojtja e mjedisit** ka nivel mesatar të ofrimit për të gjtiha komunat dhe kap vlerën prej 52.26%, e pasuar nga fusha e **Kujdesit parësor shëndetësor**, e cila në përqindje ka vlerën prej 68.61%.

Në nivel pak më të ulët është fusha si në vijim, duke filluar nga fusha **Hapsirat Publike,** 51.59%, fusha e Transportit Publik ka vlerën prej 46.93%.

Kapitulli II

II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2023

1. Rezultatet e komunave sipas fushave dhe treguesve

Matja e performancës në vitin 2023 ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 34 komuna, megjithëse shkalla e pavlefshmërisë së të dhënave ishte mjaft e shprehur në disa komuna

Shkalla e ofrimit të shërbimeve dhe respektimit të standardeve të qeverisjes ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, varësisht nga fusha e kompetencave që matet. Në nivelin e performancës mund të ndikojnë faktorë të shumtë, si: prioritetet e vëna nga komuna brenda fushave për të cilat ushtrohet matja, mënyra dhe cilësia e planifikimit të punëve, realizimi në raport me planifikimin, realizimi në raport me mundësitë dhe pengesat e caktuara, kapacitetet dhe resurset, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e raportimit të të dhënave në SMPK, si dhe faktorë të tjerë relevant.

Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur detaje të të arriturave të komunave sipas fushave dhe treguesve përkatës.

Sqarim: Në vijim të raportit, llogaritja e rezultatit përfundimtar të fushave të matjes, merr për bazë edhe vlerën 0 për të dhënat e të cilave janë shpallur të pavlefshme. Kjo është bërë për arsye se edhe keqraportimi konsiderohet performancë e dobët, gjë që duhet të ndikoj në rezultatin përfundimtar të komunave që nuk kanë ofruar të dhëna. Kjo reflekton edhe në krahasimet në mes të komunave si dhe vlerësimet e bëra për qëllime të Grantit për Performancë.

Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative

Kjo fushë përbëhet nga katër tregues, ku përfshihen shërbimet publike administrative (SHPA) dhe efikasiteti i organeve komunale në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik, për çështjet që lidhen me kompetencat e tyre të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar shërbime administrative në formën online apo përmes e-kioskut.

Krahasuar me 16 fushat e tjera, në vitin 2023 kjo fushë radhitet e para për nga performanca, me nivel të përgjithshëm prej 80.00%. Komuna e Deçanit ka nivlelin maksimal më të lartë të ralizimit të këtij shërbimi prej 100%.




Fig. 6 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e shërbimeve administrative

Të dhënat tregojnë se komunat në masë të madhe i kanë shqyrtuar kërkesat administrative të cilat u janë parashtruar. Përmes tre treguesve në SMPK. Tereguesi: kërkesa adiministrative të shqyrtura gjatë vitit shprehur në % janë 87.62% sikurse kerkesa adaministratgive të shqyrtura brenda afateve ligjore janë 84.79%, kurse shërbime administrative të ofruara online janë po ashtu 67.58%




Fig. 7 Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve administrative

Fusha 2 – Transparenca Komunale

Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 26 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kritereve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj.

Performanca e përgjithshme e arritur në këtë fush është 73.02%, për dallim nga viti paraprak ku ishte 85.78%. Sa u përket performancës sipas tregueseve, përqindja më e lartë është në publikimin e dokumenteve të prokurimit publik shprehur me 67.60%.




Figure 8 Treguesit e performancës në fushën e transparencës

Nga figura e mësipërme shihet se treguesi për transmetimin online të mbledhjeve të kuvendit del në nivel 72.15%, krahasuar me vitin paraprak prej 85.74%, ose 13.59% me pak në vitin 2023. Tetë kriteret e matura për ueb-faqe komunale del të jenë përmbushur në masën 80.59%, ndërsa aktet e kuvendit të komunës janë publikuar në shkallë prej 86.11%. Të dhënat tregojnë për trend pozitiv në publikimin e akteve me karakter të përgjithshëm të aprovuara nga kryetarët e komunave, shprehur në përqindje prej 81.64% ose 3.78% më shumë se në vitin 2022.

Po ashtu, komunat kryesisht kanë qenë efikase në publikimin e buxhetit të komunës si dhe raporteve të shpenzimeve, ne nivelin prej 65.29%. Sa i përket publikimit të planit vjetor të




Fig. 9 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e transparencës komunale

prokurimit publik.

Figura e mësipërme tregon për 16 komuna të cilat kanë treguar performancë në mes 90-100% në fushën e transparencës, prej të cilave: Gjakovë (100%), Gllogoc (100.00%),Kaqanik (100%) Lipjan (100%) Rahovec (100%) Skenderaj (100%) Suharekë (100%). Nën nesataren e vendit sa i përketë ofrimit të këtij shërbimi nga komunat vlen të theksohe se 22 komuna janë mbi mesatare, ndërsa 12 komuna nën mesatare, gjë që trasnaparenca e organeve komunale është në fokus të komunave.

Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale

Përgjegjshmëria komunale ka gjithsej 10 tregues, të aplikuar në vitin 2023. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 63.79%. Në kuadër të kësaj fushe, vërejmë performancë të lartë të komunave në ndërmarrjen e veprimeve ligjore. Komunat kanë treguar performancë pozitive edhe në diskutimin e projektbuxheteve dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve, që shprehur në përqindje është 84.21%, në këtë tregues komunat janë treguar të suksesshme.




Figure 10 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike edhe në vitin 2023, mbetet e ulët edhe përkundër standardit të SMPK-së të 3% të popullsisë së komunës, i cili është përmbushur në shkallën 26.08% krahasuar me vitin paraprak që ishte 32.47%, apo 6.39 më e ulët se në vitin paraprak. Te ky tregues vërehet një rënje e lehtë në vitin 2023.




Figure 11 Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunale

Sa i përket nivelit të zbatimit të planit të prokurimit, bazuar në shumën e shpenzuar kundrejt shumës së planifikuar, performanca rezulton në masën 89.50%. Treguesi i për nivelin e adresimit te rekomandimeve të ZKA-së ka përqindjen prej 46.05%, ky tregues ka nivel mesatar të ofrimit edhe në vitin 2022 ka pas ofrim të përafërt. Treguesi niveli i pagesave brenda afateve ligjore prej 30 ditës në përqindje i shprehur 73.94%, sikurse, Treguesi për nivelin e zbatimit të plnait të prokurimit ka vlerën prej 89.50%.

Performancë të mirë komunat kanë edhe sa i përket treguesit, pezullimi i zyrtarëve në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre që ka vlerën prej 93.94%, ka dëshmon se komunat nuk kanë pas suspendime sa i përket aktakuzave eventuale në shërbimin civil komunal. K omunat ende qendrojne jo mirë në hartimin e planeve për integritet dhe miratimin nga kuvendi, vlera e tereguesit është 52.94%, kjo vlerë mbetet e ulët.




Figure 12 *Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunal*




Figure 13 *Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmëria komunal*




Figure 14 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e përgjegjshmërisë

Performancën më te lartë në indikatorët e kësaj fushe e ka arritur komuna e Rahovecit (94.85%) Gllogoc (93.28%) Lipjanit (92.72%), Suharekës (90.42%) Skenderaj (88.56%) dhe Hani Elezit (87.85%) Ndryshe nga to, më ulët qëndrojnë komunat: Mitrovica e Veriut, Partesh, Mamushë, Graçanicë, Prishtinë dhe Ranillug, Shtërpcë. Në nivelin të performancë në këtë fushë, ka ndikuar edhe mos raportimi i të gjitha të dhënave për tregues nga komunat në fjalë.

Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësim komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë prej 49.71%.




Figure 15 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare




Figure 16 Treguesit e performancës në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Sipas të dhënave niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta mbetet i ulët, referuar kriterit të përcaktuar në Ligjin Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi, tregusei ka vlerën prej 26.88%. Më poshtë, janë pasqyruar të arriturat për të gjitha komunat në kuadër të kësaj fushe: Përqindje me e lartë eshte shënuar në dy tregues, Familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, ne masën 43.32% dhe fëmijë në nevoje që iu eshte siguruar strehimi familjarë, në përqindjen prej 73.71%. Treguesi sa i përket zyrëtarëve publik të punësuar nga komuniteti jo shumicë në institucionet komunale ka vlerën 44.31%.

Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive.

Fusha matë performancën duke e krahasuar me numrin e banorëve për arsye që të jetë më e balancuar ndaj komunave me shumë banorë dhe atyre me më pak banorë. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 62.70%. Vlenë të theksohet se 11 komuna kanë vlerë maksimale të ofrimit të këtij shërbimi prej 100%, ndërsa 6 komuna mbetën në vlerën 0 për këtë shërbim.




Figure 17 Treguesit e performancës në fushën kulturë, rini dhe sport

Treguesit, aktivitete të kulturës rinisë dhe sportit të mbështetura me buxhet komunal sipas përqindjes është 57.82%, kurse hapësira për aktivitete sportive krahasuar me numrin e banoreve në komuna është 67.58%.




Figure 18 Treguesit e performancës në fushën e kulturë, rini dhe sport

Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive

Kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 69.30%. Rezultate maksimale prej 100% në vitin 2023 kanë arritur 14 komuna në menaxhim efikas të faktëkeqësive, ndërsa në nivel minimal mbeten 4 komuna, kurse mbi mesatare të vendit janë 18 komuna.




Fig. 19 *Krahasimi i performancës së komunave në fushën menaxhimi i fatkeqësive*

Niveli i realizimit të treguesve për këtë fushe është si vijon: Intervenimet e për mbrojtje nga fatkeqësitë ka përqindjen 78.91% ndërsa në nivel mesatar të realizimit mbetet treguesi për realizimin e planit komunal për menaxhimin fatkeqësive prej 59.68%, krahasuar me vitin praparak është më e lartë prej 36.93%.Kjo tregon që komunat në vitin 2023 i kanë kushtuar rëndësi realizimit të planit për reagim emergjent.




Fig. 20 *Treguesit e performancës në fushën e menaxhimi fatkeqësive*

Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor

Kjo fushë matë zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor, por edhe nivelin e planifikimit të ndërtimeve komunale. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 67.90%.




Figure 21 Treguesit e performancës në fushën e planifikimit hapësinor

Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme është në shkallë prej 50.72%. ose 24.3% më e lartë se në vitin praprak 2022. Sa i përket lejeve ndërtimore nga komunat u shqyrtuan me kohë 92.68%. Sipas të dhënave, ndërtesat e reja për të cilat u lëshuan leje ndërtimi inspektuar në shkallë prej 77.49%.




Figure 22 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e planifikimit hapësinor

Nivel maksimal prej 100% për këtë shërbim kanë ofrur 6 komuna, ndërsa 15 komuna janë mbi mesataren e vendit, kurse vetëm Komuna e Mitrovicës së Veriut mbetet në nivelin minimal e vlerësua me 0.

Fusha 8 – Hapësirat Publike

Kjo fushë matë hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve. Performanca e përgjithshme sipas të dhënave të ofruara nga komunat është 51.59%. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ndër të tjera janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike.




Figure 23 Treguesit e performancës në fushën e hapësirave publike

Përpos nivelit të hapësirave të gjelbra për kokë banori, kjo fushë matë edhe sipërfaqen e hapësirave publike të cilat mirëmbahen rregullisht nga komunat, si dhe numrin e hapësirave publike të përcjella me ndriçim publik. Për nivelin e përmbushjes së treguesve referojuni figurës së mësipërme.

Sipas të dhënave rreth 62.78% të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, ndërsa 65.84% të hapësirave publike janë të përcjella me ndriçim publik. Siperfaqe të gjelbra për kokë banori në m2 janë 26.15% në nivel vendi.




Figure 24 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e hapësirave publike

Sipas të dhënave të raportuara nga Komunat në nivel maksimal prej 100% janë 4 komuna të cilat e kanë ofruar këtë shërbim për qytetarët e vet, ndërsa për 6 komuna ende mbetet sfidë ofrimi i këtij shërbimi dhe si rrjedhoj janë vlerësuar me 0.

Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore

Kjo fushë matë rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Fusha është plotësuar me tregues të ri për të nxitur përmirësimin e infrastrukturës
rrugore me trotuare, ndriçim, shenjëzim si dhe shteg të biçikletave. Performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 42.25%.




Figure 25 Treguesit e performancës në fushën e infrastruktura rrugore




Figure 26 Treguesit e performancës në fushën e infrastruktura rrugore

Ajo çfarë e bënë performancën e përgjithshme të mos jetë aq e lartë, është përfshirja treguesit i ri për rrugët në zonat urbane me shtigje të biçikletave, si dhe raporti në mes të rrugëve lokale me trotuare dhe ndriçim publik. Nivelin e përmbushje së treguesve të kësaj fushe e keni ne tabelën më lart. Vlen të përmendet treguesi me nivelin me të ulet, rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave 9.24% ose 1.86% më e lartë se në vitin 2022, dhe treguesi me përmbushjen më të lartë prej 61.38% rrugët lokale të riasfaltuara.

Performanca e komunave në nivel të fushës është paraqitur si më poshtë:




Figure 27 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e infrastrukturës rrugore

Komuna e Suharekës ka një nivel maksimal të ofrimit të këtij shërbimi për qytetarë, e pasuar nga komuna e Junikut dhe Obiliqit, ndërsa në nivel të ulët mbeten komunat, Mitrovica e Veriurt,Shtërpcë, partesh, Kllokot dhe Deçan

Fusha 10 – Transporti Publik

Kjo fushë matë ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 46.93 %.




Figure 28 Treguesit e performancës në fushën e transportit publik

Në kuadër të kësaj fushe performanca për tre tregues është pasqyruar në grafikun më lart. Sipas të dhënave vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik 65.23%, kurse vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik qëndrojnë në nivelin 63.01% ose 2.29% më e lartë se në vitin 2022.Në nivel të ulet është përmbushur plani për transport publik i cili në përqindje është 12.54%, ky tregues edhe përkundër peërpjekjeve të përbashkëta me komunat, mbetet i ulët po thuaj se në nivel të njëjët.
Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figure 29 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e transportit publik

Fusha 11 – Shërbime Publike

Kjo fushë është fuzionur me rastin e rishikimit të SMPK-së, dhe në vete përfshinë pesë 5 tregues, të ofrimit të shërbimeve publike si , Mbeturina, Kanalzim, dhe Ujësjellës, që shprehur në tregues janë si në vijim: Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave, realizimin e planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit, Realizimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, Realizimin e planit komunal per ndërtimine dhe mirëmbajtjen e kanlaizimit dhe Realizimin e planit komunal për mbledhjen e mbeturinave. Performanca në nivel të fushës është 58.05%.




Figure 30 Treguesit e performancës në fushën e parkingjeve

Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave 75.87%, Realizimin e planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit 35.29%, Realizimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 49.12%, Realizimin e planit komunal per ndërtimine dhe mirëmbajtjen e kanlaizimit 41.92% dhe Realizimin e planit komunal për mbledhjen e mbeturinave 88.04%.

Në vijim është paraqitur arritjet e komunave në këtë fushë në përqindje.




Figure 31 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e parkingjeve publike

Komuna Suharekës ka arritur nivel maksimal të ofrimit të shërbimeve publike prej 100%, pasuar nga komuna e Rahovecit me 99.67%, e treta renditet komuna e Lipjanit me 99.45%. Ndërsa në nivel të ulët mbeten komunat si: Mitrovicë e Veriut, Shtërpcë, Partesh, Malishevë, kjo mund të shihet në grafikun nr 31.

Fusha 12 – Mbrojtja e Mjedisit

Kjo fushë matë veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 52.56%.




Figure 32 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

Realizimi i planit të veprimit të mjedis del të jetë arritur në masën prej 48.69%[4].ose 37.64% më e lartë se në vitin 2022. Kjo tregon për një seriozitet të komunave për trajtimin e planeve të veprimit në mjedis. Lejet mjedisore të lëshuar ishin në shkallën 45.47% ndërsa ndërtesat e reja që kanë zbatuar lejet mjedisore komunale del në shkallë mjaftë të ulët prej 63.52%.




Figure 33 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

[4] Shumica e komunave nuk kanë dëshmuar ta kenë të hartuar Planin Lokal për mbrojtje të Mjedisit

Komunat, Dragash, Istog, Rahovec, Suharekë kanë vlerën maksimale prej 100%. Në grafikun më lartë mund të shihen edhe komunat të cilat kane rezultate të knaqëshme të ofrimit të këtij shërbimi, ndërsa mesatarja e vendit është 52.56, ku mbi mesatare renditen 21 komuna dhe 13 komuna renditen nënë mesataren e vendit për këtë shërbim.

Fusha 13 – Përfaqësimi Gjinor

Përfaqësimi gjinor matet më gjerësisht në këtë fushë duke përfshirë qasjen e të dy gjinive në programet për zhvillim social, ekonomik, si dhe në aktiviteteve komunale. Po ashtu, treguesit matin shkallën e përfaqësimit të të dy gjinive në institucionet lokale, trupat e kuvendeve komunale etj. Me gjithë progresin e komunave ndër vite në sigurimin e përfaqësimit të barabartë në trupat e kuvendeve dhe në komisionet komunale, të dhënat për treguesit e caktuar minimizojnë përqindjen në këtë fushë duke e bërë atë mjaft të ulët, 39.66%. Në vijim, është paraqitur figura e përfaqësimit gjinor sipas treguesve:




Figure 34 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor




Figure 35 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor



Figure 36 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor

Sipas të dhënave të raportuara nga 34 komuna, niveli i të punësuarve gra në institucione komunale është 78.20% në raport me kriterin 50x50. Po ashtu, Gratë të emëruara në pozita politike, është arritur 39.13% e kriterit ligjor. Sipas të dhënave të përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive, 47.21% të përmbushjes së kriterit ligjor.

Përfaqësimi gjinor tek emrat e rrugëve komunale është tejet i ulët, shprehur ne 9.97% po ashtu edhe regjistrimi i pronave në emër të një grua apo dy gjinive (bashkëshortë apo vëllezër dhe motra), është i ulet, 23.47%, ose 15.68% më e lartë se në vitin 2022. Te ky tregues vërehet një ngritje gjë që tregon edhe seriozitetin e Komunave në trajtimin e pronave.

Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor ka vlerën 69.12%. Me që ky tregues ka ende vlere të ulët të përkrahjes nga komunat, megjithatë, ka nevojë mjaft të madhe për trajnim në këtë drejtim si dhe për vullnet të komunave që të kuptojnë rëndësinë e kësaj çështje. Barazia gjinore në programet për punësim, subvencione dhe ndërmarrësi është në shkallë prej 28.76%.




Figure 37 Krahasimet sipas komunave në fushën e barazisë gjinor

Nga grafiku shihet nevoja që Komunat duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të investuar në programet për barazi gjinore dhe për ti pëmbushur obligimet ligjore në aspektin e përfaqesimit institucional dhe politik. Kjo mund të shihet në grafikun më lartë

Fusha 14 - Arsimi Parauniversitar

Kjo fushë synon rezultate në hapësira për çerdhe dhe shkolla të pajisura me kabinete për internet, masa të efiçencës së energjisë, rekrutimin e personelit arsimor, licencimin e mësimdhënësve, mjetet e konkretizimit, pajisjet e shkollave me mjete mësimore, kabinete të TIK-ut, si dhe kushtet e sigurisë në shkollë. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme në nivel prej 48.78%. Në përgjithësi, në treguesit e arsimit të dhënat e raportuara nga komunat nuk kanë qenë të plota, kështu që përqindjet e fituara mund të paraqesin një vlera relative të saktësisë.




Figure 38 % e treguesve në fushën e arsimit parauniversitar në nivel vendi




Figure 39 % e treguesve në fushën e arsimit parauniversitar në nivel vendi

Fusha e arsimit ka me shume tregues por në grafikun me lart do ti paraqesim disa nga treguesit sipas përqindjes. Treguesi, braktisja e shkollës nga nxënësit, ku paraqitet shkalla inverse ka shënuar vlerën në 75.72%, Ndersa shkalla e realizimit te orëve te planifikuara sipas kalendarit vjetor te arsimit është përmbushur 79.09%. Kalueshmëria ne testin e maturës kombëtare ka vlerën 61.72. Fëmij që vijojnë kopshtet ne zona rurale dhe urbane 14.22, kjo mbetet e ulet edhe përkundër përpjekjeve nga komunat. Shkolla me masa te efiqences së energjisë 64.38% edhe ky tregues vit pas viti po pëmbushet nga komunat. Sikurse treguesi siguria në institucionet e arsimit parauniversitar 49.21%, ky tregues ende ka nevojë të përmbushet nga ana e komunave.




Figure 40 Krahasimet sipas komunave në fushën e arsimit parauniversitar

Në grafikun Nr.40 mund të shihni rezultatet përmbushjen e treguesve e shprehur në përqindje për secilën komune. Komuna e Fushë Kosovës ka nivel maksimal të përmbushjes së treguesve. Mbi mesataren e vendit janë renditur 22 komuna, ndërsa nënë mesataren e vendit janë 12 komuna.

Fusha 15 – Kujdesi Primar Shëndetësor

Kjo fushë matë infrastrukturën dhe hapësirat e destinuara për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunave, kjo fushë ka nivel të ulët të performancës në përgjithësi, apo 68.61%. Në vijim është paraqitur figura me % e performancës sipas treguesve në këtë fushë:




Figure 41 % e treguesve në fushën e shëndetësisë primare

Treguesit nga kjo fushe janë shumë numër, por ne do ti prezantojmë ne paraqitje grafike disa nga këta tregues, sepse janë mjaft specifik dhe me shume interes për komunat. Treguesi, fëmijë të përfshirë në programin e imunizimit është përmbushur 74.62%, kjo është një përqindje e kënaqeshme, por duhet te shkoj në tendencë të rritjes në vitet e ardhshme. Sikurse ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra e fëmijë është përmbushur 58.82%. Ndërsa tregues që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit te kushteve infrastrukturore janë si vijon: Objekte te KPS që janë te pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike janë përmbushur 65.17%. Kurse niveli i pajtueshmërisë me raportin një mjek familjar edhe dy infermier për 2000 banore, në nivel te komunave është arritur 73.69%, krahasuar me vitin 2022 është më e lartë për 17.12 %.

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figure 42 Krahasimet sipas komunave në fushën e shëndetësisë primare

Fusha 16– Zhvillimi Ekonomik Lokal

Kjo fushë mate aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësim i rregullt i regjistrit të tatimpaguesve si dhe shkallë e lartë e inkasimit e tatimit në prone. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme prej 56.75% në vitin 2023.




Figure 43 e treguesve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

Fusha e Zhvillimit Ekonomik Lokal është prezantuar nga 4 tregues ne grafikun me lartë. Plani pe zhvillim ekonomik lokal është përmbushur nga komunat 25.47%. Kurse niveli i mbledhjes se faturës se tatimit ne prone pa borxhe interes dhe ndëshkime është përmbushur në 47.23%. Përgatitja dhe publikimi i listës se pronave komunale ne shfrytëzim është përmbushur ne 82.35%. Kurse niveli i azhurnimit te regjistrit te tatimit ne prone është përmbushur ne 71.97%.




Figure 44 Krahasimet sipas komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

Në paraqitjen grafike në grafikun Nr. 44 janë prezantuar rezultatet e arritura nga komunat për fushën e zhvillimit ekonomik, vlen të thkesohet se mbi mesataren e vendit për vitin 2023 janë 21 komuna, kurse nënë mesatare janë 13 komuna. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur rezultatin maksimal prej 100% të treguesve për këtë fushë, renditet e dyta komuna e Vushtrrisë me 89.99%. Kurse e fundit ne realizimin e treguesve mbetet komuna e Mitrovicës së Veriut.

Konkluzione dhe rekomandime

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2023, nxjerr të gjetura të shumta për 16 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

1. Vlerësimi i performancës së komunave për vitin 2023 është bërë për 34 komuna[5]. Disa nga të dhënat e raportuara nga komunat me shumicë serbe, në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat nuk korresponduan me ofrimin e shërbimeve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës, janë shpallur nule dhe u aplikua vlera 0% e performancës. Matja dhe vlerësimi i performancës është obligim ligjor i të gjitha komunave, të cilat duhet t'i përgjigjen kërkesave për informata konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Sistemin e Menaxhimit të Performancës komunale dhe grantit pær performancë. Komunat, Novobërdë, Zubin Potok, Leposaviç, dhe Zveqan nuk kanë raportuar për vitin 2023.
2. Komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje të gjitha të dhënave të prezantuara për raportim, në mënyrë që vlerat e fituara të paraqesin vlerësimin sa më objektiv të performancës për çdo tregues. Dokumentimi i të dhënave është kusht i domosdoshëm. Gjatë përgatitjes së të dhënave dhe informatave, komunat duhet të përgatisin dosjen për secilën fushë.Vlerësimi i komunave për vitin 2023 është bërë dhe është bazuar në dokumentin e rishikuar të SMPK-së.
3. Procesi i sigurimit të cilësisë ka evidentuar një numër të të dhënave të pasakta, të cilat në shumë raste janë shpallë të pavlefshme, përveç atëherë kur është bërë dokumentimi i tyre. Cilësia e raportimit duhet të rritet në të ardhmen, ashtu që raportimi të jetë i drejtë, i saktë, objektiv dhe të paraqes gjendjen sa më reale të performancës së komunave.
4. Performanca është kategorizuar në dy grupe me tregues të cilës pasqyrojnë veprimet e komunave në funksion të qeverisjes së mirë dhe ofrimit të shërbimeve. Në kuadër të grupit të indikatorëve të qeverisjes, Shërbimet Administrative renditet e para, megjithëse treguesi për pasqyrimin e rezultateve të konsultimeve publike duhet të trajtohet seriozisht nga autoritetet lokale. 26.08% e komunave kanë filluar me hartimin e këtyre raporteve, por edne mbetet i ulët ky tregues të ralizohet. Raportet e proceseve të konsultimeve publike duhet të përpilohen dhe të publikohen në platformën qeveritare të konsultimeve publike, me qëllim për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në politikë bërje dhe marrjen e opinionit të tyre për çështje publike.
5. Prezenca e qytetarëve në konsultimet publikë ka vazhduar të jetë e ulët. Komunat duhet të shfrytëzojnë teknika dhe mjete efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrësit, me fjalë tjera komuant duhet të marrin më shumë parasysh kërkesat e qytetarëve dhe që kjo të shërbej si rritje e besimit të qytetarëve në raport me komunat.
6. Performancë e ulët është treguar në fushën e përfaqësimit gjinor edhe në vitin 2023. Komunat duhet të ndërmarrin veprime për ta rritur numrin e grave në pozita vendimmarrëse, politike dhe në këshillat lokale. Po ashtu, duhet të përmirësohen dokumentet planifikuese dhe financiare duke marrë për bazë elementin gjinor.
7. Një pjesë e komunave kane filluar aplikimin online të shërbimeve administrative, përformanca në këtë segment duhet të përmirësohet, për të ngritur efikasitetin në shërbime dhe me kosto sa më të ulët. Këto shërbime duhet të aplikohen në të gjitha komunat dhe për numër më të madh të shërbimeve, përfshirë aplikimin online për leje ndërtimore, leje mjedisore, pagesat e tatimit në pronë, apo faturat për shërbime komunale etj.

5 Komunat: Novobërdë,Zubin Potok. Leposaviq, Zveçan..

8. Të dhënat për barazinë në punësim dhe shërbimet sociale tregojnë se drejtoritë komunale duhet të bëjnë përpjekje për përfshirje të të gjitha kategorive në nevojë në politikat e punësimit. Gjithashtu efikasiteti duhet të rritet në vlerësimin e familjeve në banim social, në mënyrë që të objektet e banimit social të shfrytëzohen nga familjet në nevojë dhe të ketë shqyrtim të plotë të kërkesave të parashtruara;
9. Planifikimi hapësinor kërkon trajtim më të gjerë për të rregulluar të gjithë sipërfaqet e nevojshme me plane rregulluese të hollësishme ose me harta zonale. Të dhënat flasin për një shkallë mjaft të ulët të këtyre planeve të cilat janë tejet të rëndësishme për rregullimin e komunës;
10. Infrastruktura rrugore duhet të kompletohet, si në aspektin e asfaltimit të rrugëve, ashtu edhe me infrastrukturë përcjellëse përfshirë trotuare dhe ndriçim publik. Komunat duhet të rrisin cilësinë e të dhënave për nivelin e asfaltimit të rrugëve, trotuaret, ndriçimin e tyre, e sidomos tek të dhënat për shtigjet e biçiklistëve. Po ashtu, nevojitet planifikim më i mirë në mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, në mënyrë që shtrirja me këtë shërbim të jetë e plotë.
11. 7.38% e të dhënave për shtigje të biçikletave në zonat urbane, është vlerë që tregon se komunat duhet të punojnë në avancimin e infrastrukturës rrugore përmes krijimit të shtigjeve të biçikletave.
12. Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunat duhet të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kritereve ligjore. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy gjinitë. Kërkohet promovim më i madh i politikave gjinore në këshillat e lokale. Komunat duhet të të hartojnë planet për barazi gjinore. Po ashtu kriteri i barazisë gjinore duhet të forcohet edhe në kuadër të pozitave të emëruara politike, si dhe të promovohet e drejta për regjistrimin e pronësisë në të dy gjinitë e cila qëndron në vlerë mjaft të ulët.
13. Komunat duhet të fillojnë të investojnë në çerdhe/kopshte në zona rurale ku ka nevojë, për shkak të rëndësisë së këtyre institucioneve në zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
14. Drejtoritë komunale të arsimit duhet të planifikojnë që shkollat të plotësojnë kushtet e infrastrukturës përcjellëse, masat e energjisë efiçiente, si dhe të jenë të pajisura me kabinete me internet në masë më të madhe. Krijimi i hapësirave shkollore sidomos në zonat urbane kërkojnë trajtim të veçantë për të eliminuar mësimin në më shumë turne dhe aplikimin e mësimit gjithë-ditor. Edhe në fushën e arsimit, është e domosdoshme të rritet cilësia e raportimit dhe saktësisë së të dhënave.
15. Planifikimi formal për zhvillim ekonomik lokal duhet të zgjerohet në komuna. Komunat duhet të hartojnë Planet për Zhvillim Ekonomik Lokal. Raportimi për realizimin e planeve të tilla duhet të jetë temë e diskutimit në kuvendet komunale, në mënyrë që të aktivitetet në këtë fushë të gjejnë zbatim më të lehtë dhe të renditen sipas kërkesave të shumicës.
16. Duhet të inkurajohen komunat që të resepektohen rregullat ligjore, për ta ngritur cilësinë e raportimint dhe ngritjen e cilësisë së referencimit sa i përket dokumenteve adekuate për çeshtje të caktura.
17. Duhet tu bëhet me dije të gjitha komunave të Republikës së Kosovës se, përfromanca si instrument përveç që është mundësi për marrje të fondeve, është edhe obligim ligjor që të aplikohet raportimi i plotë për të gjithë treguesit.
18. Komunat duhet të kenë parasysh hartimin e raporteve dhe dokumenteve ashtu qysh kërkohet me ligjet në fuqi dhe specifikisht për nevoja të raportimit në SMPK.

Shtojcë: % e treguesve sipas fushave

SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	87.62
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	84.79
	1.1.3	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	67.58
TRANSPARENCA KOMUNALE	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	72.15
	2.1.2	Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët	77.44
	2.1.3	Përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës	80.59
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës	86.11
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës	81.64
	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	65.29
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	67.60
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	55.88
	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	26.08
	3.1.4	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	40.69
	3.1.5	Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxhetimi me pjesëmarrje	84.21
	3.1.6	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	28.91
	3.1.7	Funksionimi i këshillave lokal	19.36
	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	75.29
	3.2.2	Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	72.79
	3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunale	60.29
	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	69.20
	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	89.50
	3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	73.94

	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	46.05
	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	52.94
	3.4.2	Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	93.87
BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	26.88
	4.1.2	Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale	44.31
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social	43.32
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	73.71
KULTURË, RINI DHE SPORT	5.1.1	Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve	67.58
	5.2.1	Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	57.82
MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent	59.68
	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	78.91
PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunave të mbuluar sipas planeve zhvillimore të komunës.	50.72
	7.2.1	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	92.68
	7.2.2	Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit	77.49
HAPËSIRAT PUBLIKE	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në m2 publike për kokë banori	26.15
	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	62.78
	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	65.84
INFRASTRUKTURA RRUGORE	9.1.1	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	47.38
	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	41.45
	9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	28.43
	9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	48.69
	9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	54.73
	9.3.1	Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	9.24

	9.3.2	Rrugë lokale të riasfaltuara	61.38
TRANSPORTI PUBLIK	10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit)	12.54
	10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	65.23
	10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	63.01
SHËRBIMET PUBLIKE	11.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	35.29
	11.1.2	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	49.12
	11.1.3	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	41.92
	11.1.4	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	88.04
	11.1.5	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	75.87
MBROJTJA E MJEDISIT	12.1.1	Realizimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis	48.69
	12.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	45.47
	12.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	63.52
PËRFAQËSIMI GJINOR	13.1.1	Gratë e punësuara në institucione/administratën komunale	78.20
	13.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	47.23
	13.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	39.13
	13.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	91.18
	13.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	6.00
	13.2.1	Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor	69.12
	13.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	28.76
	13.2.3	Pjesëmarrja e grave në konsultime publike	54.73
	13.2.4	Plani komunal për barazi gjinore	47.06
	13.3.1	Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve	9.97
	13.3.2	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	23.47

ARSIMI PARAUNIVERSITAR	14.1.1	Shkolla me masa të efiçencë së energjisë	34.88
	14.1.2	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	49.21
	14.1.3	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	64.38
	14.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës	41.01
	14.3.1	Fëmijë që vijojnë kopshtin - përgjithësi dhe rural	14.22
	14.3.2	Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta	48.42
	14.3.3	Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë)	61.72
	14.3.4	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	75.72
	14.3.5	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	79.09
KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR	15.1.1	Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	65.17
	15.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	73.96
	15.2.2	Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit	74.62
	15.3.1	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	58.82
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL	16.1.1	Strategjia për zhvillim ekonomik lokal	25.47
	16.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim	82.35
	16.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	71.97
	16.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	47.23

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Njësia e Auditimit të Brendshëm

RAPORT PERIODIK I NJAB

AUDITIMET E PËRFUNDUARA DHE AKTIVITETET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

JANAR
GUSHT
2024

PRIZREN, 2024

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE 4

Funksionimi i NjAB-së 4

Rezultatet kryesore/të arriturat gjatë periudhës Janar – Gusht 2024 4

PJESA E PARË (Pjesa e përgjithshme) 6

PJESA E DYTË
DETYRAT AUDITUESE TË REALIZUARA PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2024 9

AUDITIMI 1 9

AUDITIMI 2 11

AUDITIMI 3 12

AUDITIMI 4 13

AUDITIMI 5 15

Shkurtesat

NjAB – Njësia e Auditimit të Brendshëm

AB – Auditimi i Brendshëm

USSP – Udhëheqësi i Subjektit të Sektorit Publik

DB – Drejtoria e Bujqësisë

DBF – Drejtoria për Buxhet dhe Financa

ZKA – Zyra Kombëtare e Auditimit

MFPT-Ministria e Financave*, Punës dhe Transfereve*

NJQHAB – Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm

RVF – Raporti Vjetor Financiar

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

ZKF – Zyrtari Kryesor Financiar

PËRMBLEDHJE

Funksionimi i NjAB-së

Në pajtueshmëri me parimet e funksionimit të AB, duke iu referuar nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-021, për kontrollin e brendshëm të financave publike, NjAB ushtron funksionin në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik (Kryetarit të Komunës) dhe njofton Komitetin e Auditimit dhe Njësisë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm(NjQH/AB) në *Ministrin e Financave*, Punës dhe Transfereve (MFPT) përmes raportimeve periodike. Në raport me strukturat tjera organizative në subjektin e sektorit publik (në rastin tonë Komuna), NjAB ka pavarësinë funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim.

Auditimi i Brendshëm në sektorin publik ushtrohet bazuar në standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës dhe metodologjinë e auditimit, miratuar nga ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.

Në harmoni me pikën e rendit të ditës të seancës së Kuvendit të Komunës dhe në koordinim me kryetarin e Komunës, NjAB ka përgatitur raportin përmbledhës të detyrave dhe aktiviteteve për periudhën janar-gusht 2024, të cilat po i prezantoj para juve (anëtarëve të Kuvendit të Komunës). Ky raport është përgatitur sipas formatit standard të përgatitur nga Njësia Qendrore e Auditimit të Brendshëm, në të cilin janë paraqitur objektivat dhe fushëveprimi i auditimit, gjetjet kryesore dhe rekomandimet.

Rezultatet kryesore/të arriturat gjatë periudhës Janar – Gusht 2024

Nga shtatë (7) auditimet e planifikuara për vitin 2024, deri më 31 gusht 2024, janë realizuar pesë(5) detyra audituese (raporte të përfunduara), si dhe aktivitetet e monitorimit periodik lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna në këto raporte. Janë realizuar këto detyra audituese:

1. Zbatimi i procedurave lidhur me identifikimin, evidentimin, klasifikimin, barazimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së komunës në librat e pasurisë (në DBF), janë dhënë tri (3) rekomandime;
2. Auditimi i të hyrave vetanake në Drejtorinë e Shëndetësisë, është dhënë një (1) rekomandim;
3. Rregullsitë lidhur me kalkulimin e detyrimeve dhe grumbullimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe tokë, janë dhënë dy (2) rekomandime;
4. Menaxhimi i shpenzimeve për mallra e shërbime dhe komunali në administratën komunale (pa arsimin dhe shëndetësinë), janë dhënë katër(4) rekomandime;
5. Auditimi i Subvencioneve dhe Transfereve në Drejtorinë e Bujqësisë, janë dhënë dy (2) rekomandime.

Gjithashtu në kuadër të objektivave të përcaktuara, NjAB ka realizuar edhe këto aktivitete audituese:

a) **Raportet periodike për rishikimin e ecurisë së rekomandimeve** të dhëna nga NjAB (periudhat e monitorimit dhe raportimit: janar dhe korrik 2024);

b) Bashkërendimi i auditimit me ekipin e ZKA (Zyra Kombëtare e Auditimit) për periudhat që kanë audituar në Komunën tonë (shkurt –mars 2024), si dhe koordinimi i aktivitete lidhur me draft-raportin dhe planin e veprimit për raportin final të ZKA;

b) Raportet vjetore për kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe NjQHAB/MFPT: Periudha e raportimit: Raporti vjetor për vitin 2023(koha e raportimit, janar 2024) raport i gjashtëmujorit të parë, për vitin 2024 (koha e raportimit, korrik 2024)**;**

c) Mbajtja e takimeve të rregullta me komitetin e auditimit: Për periudhën në fjalë janë mbajtur dy (2) takime;

d) Mbajtja e takimeve dhe punëtorive në projektin USAID TEAM (Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse), DEMOS dhe NjQHAB dhe aktivitete këshilluese për drejtorët dhe zyrtarët komunal.

PJESA E PARË (Pjesa e përgjithshme)

1. Të dhënat e përgjithshme për shfrytëzuesin e buxhetit (subjektin e sektorit publik)	
Subjekti i sektorit publik (SSP):	Komuna e Prizrenit
Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:	Shaqir Totaj
Emri dhe mbiemri i Drejtorit/Auditorit të NjAB:	Agron Hoxha
Telefoni:038 200 44 714	E-mail:agron.hoxha@rks-gov.net

Qëllimi i raportit gjashtëmujor/vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm:

Raportimi tek Ministria e Financave – Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm lidhur me auditimet e kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm si dhe të dhënave të nevojshme për përpilimin e raportit unik (përmbledhës) gjashtëmujor/vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik.

2. Të dhënat për Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe auditorët e brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm është themeluar sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike	**PO** JO

Njësia e auditimi i brendshëm është themeluar sipas njërës nga mënyrat si në vijim:

a) **Njësi e pavarur të auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejt të Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik;**
b) Njësi e përbashkët e auditimit të brendshëm sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Financave;
c) Nëpërmjet një marrëveshjeje për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm nga një subjekt i sektorit publik tek një tjetër, me miratimin paraprak të Ministrit të Financave; apo
d) Nëpërmjet kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, pas aprovimit të Ministrisë së Financave.

Njësia e auditimit të brendshëm në mënyrë organizative i përgjigjet drejtpërsëdrejti dhe ekskluzivisht Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik	**PO** JO

A është plotësuar Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas kërkesave ligjore:

Kërkesat minimale ligjore për numrin e auditorëve	**Numri aktual i auditorëve**	**Burimet e nevojshme për auditim**
3	**2**	1

Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm a janë të certifikuar sipas kushteve të parapara me ligj	**PO** JO

3. Zbatimi standardeve dhe metodologjisë së punës së Auditimit të Brendshëm

Zbatimi i Doracakut të auditimit të brendshëm

Auditorët e brendshëm kanë një ekzemplar të Doracakut të auditimit të brendshëm:	**PO** JO

Auditorët e brendshëm, përpos Doracakut të auditimit të brendshëm kanë edhe shtesën e vet të doracakut për auditim të brendshëm	PO **JO**
Auditorët e brendshëm në kryerjen e auditimeve të veçanta/me kërkesë u përmbahen në tërësi fazave të proceseve të auditimit të përcaktuara me Doracakun e auditimit të brendshëm	**PO** JO
Statuti i auditimit të brendshëm	
Njësia e auditimit të brendshëm ka statutin e auditimit të brendshëm	**PO** JO
Statuti i auditimit të brendshëm është i nënshkruar nga Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Drejtori i Njësisë së AB:	**PO** JO
Nëse përgjigjja është Po – shkruaj datën e aprovimit të statutit **04.07.2022 (i rishikuar)**	
Zbatimi i kodit të etikës profesionale të AB	
Auditorët e brendshëm i përmbahen parimeve dhe rregullave të përcaktuara me Kodin e etikës profesionale.	**PO** **JO**
Kryerja e auditimit të brendshëm	
Plani strategjik i auditimit të brendshëm është përpiluar në bazë të vlerësimit të rrezikut:	**PO** JO
Planin strategjik të auditimit të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit	**PO** JO
Plani vjetor i AB është hartuar në bazë të Planit strategjik të AB	**PO** JO
Planin vjetor të AB të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit:	**PO** JO
Subjekti i sektorit publik ka themeluar Komitetin e Auditimit	**PO** JO
Përgatitja dhe zbatimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm	
Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave raportuese dhe realizimi i tij (për të cilat janë përpiluar raportet finale)	

Periudha raportuese	Numri i auditimeve të planifikuara	Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit	Numri i auditimeve të kryera	Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të angazhuar për auditim
Gjashtëmujori i parë	4	90	4	**92**	**2**
Gjashtëmujori i dytë	3	80	**1**	**26**	**2**
Totali vjetor	**7**	**170**	**5**	**118**	**2**

Sqarim: Në kolona koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit**, janë të llogaritura edhe ditët e monitorimit të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve..**	
Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet finale të auditimit menjëherë pas kryerjes së AB	**PO** JO
Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik përpilon dhe vendos për planin e veprimit i cili përfshinë rekomandimet e pranuara dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren në pajtim me ligjin për KBFP-**Drejtorët e drejtorive të audituara së bashku me stafin e tyre përgatisin planet e veprimit.**	PO JO
Për rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit njësia për auditimit të brendshëm ka bazën e organizuar të dhënave për zbatimin e rekomandimeve:	**PO** JO
Rekomandimet e dhëna përcjellën sipas planit të veprimit, ashtu sikur është përcaktuar me doracak të auditimit të brendshëm	**PO** JO
Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:	
Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:	**12**
Numri i rekomandimeve të zbatuara:	**5**
Numri i rekomandimeve në proces:	**7**
Numri i rekomandimeve të pazbatuara:	**/**
Nëse ekzistojnë rekomandime të pazbatuara thekso arsyet e moszbatimit: Për periudhën raportuese 7 rekomandime konsiderohen në proces se për këto rekomandime afatet e dhëna për zbatimin e tyre nga menaxhmenti i programeve buxhetore të audituara janë të dhëna deri në fund të vitit 2024, pasi që lidhen kryesisht me proceset të cilat ndodhin deri në fund të vitit, ne do ta bëjmë një rishikim përmbledhës për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në janar 2025, ku do të pasqyrohet niveli i zbatimit të rekomandimeve.	

PJESA E DYTË

DETYRAT AUDITUESE TË REALIZUARA PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2024

AUDITIMI 1

Emri i Auditimit	**ZBATIMI I PROCEDURAVE LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN, EVIDENTIMIN, KLASIFIKIMIN, BARAZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E PASURISË SË KOMUNËS NË REGJISTRAT E PASURISË**
DATA E DORËZIMIT TË RAPORTIT FINAL	01.03.2024
Përmbajtja e shkurt e drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit)	
OBJEKTIVAT KRYESORE TË AUDITIMIT	Se ekzistojnë procedura dhe rregulla të brendshme të shkruara të cilat ndihmojnë të gjithë zyrtarët të cilët janë të kyçur në pranimin, regjistrimin, vlerësimin, inventarizimin dhe menaxhimin e pasurive jokapitale; Se regjistrimi i pasurive është bërë në përputhje me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, dhe se këto regjistrime në bazë të kategorive janë bërë njëjtë në të dy regjistrat (regjistrin e pasurisë dhe SIMFK), si dhe është bërë harmonizimi i regjistrit të pasurisë me regjistrin e blerjeve në SIMFK; Se komisioni për regjistrim dhe inventarizim të pasurive ka vepruar me kohë dhe në përshtatshmëri me rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore lidhur me menaxhimin e aseteve dhe a janë harmonizuar të dhënat ne regjistrin e pasurive sipas raportit të Komisionit për Inventarizim para raportimit të pasqyrave financiare; Të sigurohet se Komuna ka proces adekuat, efiçient dhe transparent për zhvendosjen dhe tjetërsimin e pasurive.
FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT	Periudha:01.01.2022-31.12.2023, Lokacioni: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, Zyra për menaxhimin e pasurisë jofinanciare
TË GJETURAT E AUDITIMIT	**E GJETURA 1:** Vlera e pasurisë neto për pasuritë mbi 1,000.00€ deri me 31.12.2023 ishte në vlerë prej 502,556,542.92 €, tutje gjatë analizës së pagesave, në një (1) rast kemi konstatuar nënvlerësim të pasurisë për 688,300.00 €, pasi që këto nuk ishin regjistruar si pasuri jo financiare në regjistrat e pasurisë. Në regjistrin e pasurive komunale në Free Balance (SIMFK) për vitin 2023 shuma e përgjithshme e pasurive jo financiare kapitale ishte 17,168,402.97 €, ndërsa bazuar në shpenzimet për investime kapitale për vitin 2023 sipas raportit nga SIMFK këto shpenzime kapin vlerën 19,761,835.62 € me një diferencë prej 2,593,432.65 € të cilat sipas zyrtarit të pasurisë nuk kanë të bëjnë me pasurinë jo financiare kapitale dhe si të tilla nuk i ka regjistruar në regjistrat e pasurisë.

	E GJETURA 2: Në tri (3) raste: Kontrata me numër 622-22-10254-521 "Rehabilitimi dhe riparimi i rrugëve fushore" vlera e pagesës **9,969.0 €** edhe pse sipas raportit të organit mbikëqyrës kjo është pagesa e fundit e këtij projekti zyrtari i pasurisë në regjistrat e pasurisë dhe regjistrat kontabël ka regjistruar investim në vijim duke mos e mbyllur atë investim në mënyrë që më pas ti nënshtrohet zhvlerësimit dhe pasuria jo financiare të konsiderohet pasuri në përdorim. Po ashtu edhe aneks-kontrata me numër 622-23-6153-525 "Aneks I kontratës për ndërtimin e infrastrukturës në fshatin Kobaj" vlera e pagesës **10,419.59 €,** edhe kjo pagesë sipas organit mbikëqyrës është pagesë përfundimtare dhe si e tillë është dashur që të mbyllet pasuria nga kategoria e investimeve në vijim në kategorinë e pasurisë në përdorim, gjë e cila nuk figuron në regjistrat kontabël të pasurisë. Pagesa me vlerë prej 11,566.22 € tek kontrata me numër 622-22-9815-5-2-1 "Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Gjonaj" e cila sipas organit mbikëqyrës dhe komisionit për pranim teknik është pagesë përfundimtare, në regjistrin e pasurisë (SIMFK) akoma vazhdon të jetë në kategorinë investime në vijim, pra nuk është mbyllur. **E GJETURA 3:** Kryetari komunës me datë 22.11.2023 ka marr vendim për formimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare, ky komision nuk kishte përgatitur raportin mbi gjendjen fizike të pasurive jo-financiare para dorëzimit të pasqyrave vjetore financiare ashtu siç është paraparë sipas rregullores 02/2013 (paragrafi 4.7 i nenit 18 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare thekson 'Hartimi i raportit të përgjithshëm bëhet në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurisë në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore').
REKOMANDIMET	**Rekomandimi nr.1:** Zyrtari i pasurisë duhet që të harmonizoj regjistrin e pasurisë jo financiare duke regjistruar në regjistrat e pasurisë të gjitha pasuritë të cilat i plotësojnë kriteret e pasurisë jo financiare në mënyrë që të evitohet mbi/nën vlerësimi i pasurive komunale e cila me pas reflektohet edhe ne RVF; **Rekomandimi nr.2:** Zyrtari i pasurisë duhet që të shtojë kontrollin dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale të cilat i plotësojnë kushtet që pasuria të jetë në përdorim, duhet që ta mbyllë llogarinë e investimeve në vijim në regjistrat kontabël dhe më pas të fillojë edhe procedura e zhvlerësimit e këtyre pasurive; **Rekomandimi nr. 3:** Komisioni i emëruar i inventarizimit pa marrë parasysh vështirësitë teknike që dalin gjatë procesit, duhet që me efikasitet me të shtuar të përfundojnë inventarizimin brenda afateve kohore (para dorëzimit te RVF) që të ketë kohë të mjaftueshme për harmonizimin e regjistrave të pasurisë me regjistrin e inventarizimit.

AUDITIMI 2

Emri i auditimit	**AUDITIMI I TË HYRAVE VETANAKE NË DREJTORINË E SHËNDETËSISË**
DATA E DORËZIMIT TË RAPORTIT FINAL	17.04.2024
Përmbajtja e shkurt e drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit)	
OBJEKTIVAT KRYESORE TË AUDITIMIT	Për të gjitha llojet e të hyrave janë zbatuar tarifat e caktuara me Rregulloren nr.02/2022 për taksa, tarifa dhe ngarkesa nga shërbimet komunale; Në evidencat e të hyrave, janë regjistruar të gjitha llojet e të hyrave të realizuar, në mënyrë kronologjike dhe sipas kodeve të caktuara (gjithë përfshirja).
FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT	**Periudha:** 05.01.2023- 29.02.2024, **Lokacioni:** Drejtoria e Shëndetësisë – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
TË GJETURAT E AUDITIMIT	**E GJETURA 1:** Nga testimet tona në tri (3) raste për shërbimet e ofruara nga laboratori (për analizat e hormoneve) janë aplikuar tarifa prej 5€ të cilat nuk kanë qenë të inkorporuar në Rregulloren 02/2022 për Taksa Komunale. Aplikimi i vlerës së bashkë pagesës prej 5 € është bërë në bazë të një vendimi të datës 02.06.2020 nga Këshilli Drejtues i QKMF-së, ku janë përcaktuar disa tarifa ndër to edhe analizat për TSH, T3, T4, HbCA1, RF në vlerën e lartcekur. Sipas Udhëzimi Administrativ 08/2017 organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH), shtojcës nr.2 të këtij udhëzimi, Komuna duhet të ofrojë shërbimet e lartcekura por nuk është caktuar çmimi për një shërbim të tillë. Gjatë caktimit të kësaj takse për shërbimet e analizave të përcaktuara, Këshilli Mbikëqyrës i QKMF-së është bazuar në udhëzimin 08/2017 dhe Statutin e QKMF-së, nenin 15, paragrafi 8 në të cilën thuhet që Këshilli Drejtues "Aprovon çmimet e shërbimeve shëndetësore të cilat i ofron QKMF'' e të cilat nuk janë të përcaktuara nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
REKOMANDIMET	**Rekomandimi nr.1:** Drejtoria e Shëndetësisë duhet që vendimet që kanë të bëjnë me përcaktimin e taksave (të cilat konsiderohen të hyra vetanake) ti inkorporojnë në Rregulloren për Taksa Komunale.

AUDITIMI 3

Emri i auditimit	**RREGULLSITË LIDHUR ME KALKULIMIN E DETYRIMEVE DHE GRUMBULLIMIN E TË HYRAVE NGA TATIMI NË PRONË DHE TOKË**
DATA E DORËZIMIT TË RAPORTIT FINAL	24.05.2024
Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):	
OBJEKTIVAT KRYESORE TË AUDITIMIT	Politikat e planifikimit dhe realizimit, a janë të mjaftueshme për grumbullimin e të hyrave të tatimit në pronën e paluajtshme; Për të siguruar se sektori i tatimit mbi pronën ka bërë identifikimin, regjistrimin dhe inspektimin e pronave të tatueshme; Për të siguruar se është bërë kalkulimi dhe shpërndarja me kohë e të gjitha faturave të tatimit në pronë; Për tu siguruar se menaxhmenti i sektorit të tatimit në pronë ka intensifikuar veprimet në zvogëlimin e detyrimeve të pa përmbushura dhe kanë grumbulluar të hyra sipas planit dhe totalit të faturimeve; Shqyrtimi i ankesave të obligueseve të Tatimit në Pronë është bërë me kohë dhe në bazë ligjore.
FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT	**Periudha:** 01.08.2023-31.03.2024, **Lokacioni:** Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë
TË GJETURAT E AUDITIMIT	**E GJETURA 1:** Nga testimi dhe analizimi i mostrave për të vërtetuar se ngarkesat, detyrimet dhe informatat janë sipas gjendjes faktike të pronave, kemi vërejtur se në 21 raste janë ngarkuar pronat të cilat sipas ligjit 06/L-005, nenit 10, paragrafi 1, do të duhej të mos ngarkoheshin pasi që konsiderohen prona komunale. Vlera e këtyre ngarkesave për vitin 2024 arrin shumën prej 24,993.36 €. **E GJETURA 2:** Ne gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme kemi vërejtur që nuk janë marrë masa të mjaftueshme për inkasimin e borxheve. Nga pesëmbëdhjetë mostrat e testuar për llogaritë e arkëtueshme, trembëdhjetë (13) 3 raste në vlerë 97,906.76 € deri më 30.04.2024 nuk ishin ndërmarrë veprime të përcaktuara sipas ligjit të tatimit në pronë. Sipas udhëheqësit të sektorit të tatimit në pronë arsyeja për mos ndërmarrjen e masave për grumbullim të detyrueshëm të hyrave nga tatimi në pronë, qëndron në faktin se kanë njoftim nga departamenti i tatimit në pronë që të mos fillojnë me këtë aktivitet pasi që janë në përgatitje e sipër të disa formularëve që do ti ndihmonin komunat të mblidhnin detyrimet e papaguara duke ia përshtatur me procedurat e reja për inkasimin e të hyrave, pra procedurat sipas mbledhjes së borxheve nga administrata tatimore.

REKOMANDIMET	**Rekomandimi nr.1:** Menaxhmenti i tatimit në pronë edhe pse nuk ka vendimmarrje të drejtpërdrejtë në rastin e ngarkesave me tatim në pronë, duhet që të identifikojë të gjitha pronat të cilat sipas ligjit 06/L-005 lirohen nga tatimi në pronë dhe të njoftoj departamentin e tatimit në pronë në MFPT që të mos i faturojë në të ardhmen këto prona. **Rekomandimi nr. 2:** Menaxhmenti i tatimit në pronë duhet që sa më parë të filloj dhe ti identifikojë procedurat e qarta në mbledhjen e borxheve, duke përgatitur një plan veprimi duke përcaktuar veprimet dhe ti përcaktoj afatet për realizim. Të shqyrtojë të gjitha opsionet e mundshme për inkasimin e borxheve në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

AUDITIMI 4

Emri i auditimit	**MENAXHIMI I SHPENZIMEVE PËR MALLRA&SHËRBIME DHE KOMUNALI NË ADMINISTRATËN KOMUNALE**
DATA E DORËZIMIT TË RAPORTIT FINAL	27.06.2024
Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):	
OBJEKTIVAT KRYESORE TË AUDITIMIT	Të sigurohemi se autorizimi i shpenzimeve është lejuar nga zyrtarët e autorizuar në përputhje me delegimin e detyrave për zyrtarët autorizues në çdo nën program buxhetor për çdo nën program buxhetor (obligim i cili është deleguar të zyrtari autorizues; Se procedurat e shpenzimeve kanë qenë në përputhje me LMFPP, rregulloret e thesarit dhe modulin e blerjeve; Se janë respektuar afatet ligjore për obligimet e papaguara; Se klasifikimi i shpenzimeve është bërë në përputhje planin kontabël dhe kodet ekonomike përkatëse; Se regjistrimi i pasurisë se blerë, dhuruar (donacione), janë regjistruar në regjistrat e pasurisë së komunës në përshtatshmëri me rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.
FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT	**Periudha:**03.01.2024 deri më 20.05.2024 **Lokacioni:** Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera
TË GJETURAT KRYESORE TË AUDITIMIT	

	E GJETURA 1: Në 22 raste nga 40 mostrat e testuar në mallra e shërbime dhe komunali, zotimi i fondeve ishte bërë pas pranimit të faturës (pas datës së protokollimit), duke i anashkaluar procedurat e rregullës financiare për shpenzimin e parasë publike, e cila kërkon që para çdo inicimi të procedurës së prokurimit së pari duhet zotuar fondet e më pas të bëhet pranimi i mallrave/shërbimeve, po ashtu në pesëmbëdhjetë raste (15) urdhër blerjet ishin bërë pas pranimit të faturave apo mallrave duke i 'u shmangur kështu hapave të përcaktuar në rregulloren e lartcekur; **E GJETURA 2:** Në dhjetë (10) pagesa nga katër dhjete (40) mostra të cilat janë pjesë e audtimit të shpenzimeve në kategorinë Mallra Shërbime dhe Komunali, pagesat ishin ekzekutuar pas afatit ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturave. Ditët të cilat kanë kaluar afatin për pagesë për mostrat e lartcekura variojnë nga 2 deri në 90 ditë vonesë. **E GJETURA 3:** Në dy (2) raste nga katër dhjetë (40) mostrat e auditimit, shpenzimet ishin keq klasifikuar duke mos respektuar kodet e planit kontabël. Edhe pse projekti në buxhetin e vitit 2022 ishte planifikuar në investimet kapitale, pagesa e këtyre dy faturave ishte bërë nga kategoria Mallra & Shërbime në vlerë prej 134,000 €.
REKOMANDIMET	**Rekomandimi nr.1:** Udhëheqësit e njësive kërkuese, zyrtari/ja për zotimin e fondeve, ZKF dhe zyrtarët e prokurimit duhet që të sigurohen që inicimi dhe procesi i pagesave të bëhet sipas hapave të përcaktuar në nenin 22 të rregullës financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike; **Rekomandimi nr.2:** Menaxhmenti i drejtorive të cilat kanë obligime financiare të papaguara dhe ZKF duhet që të mos lejojnë tejkalimin e afatit të paraparë ligjor në mënyrë që të shmangin shpenzimet shtesë për procedurat përmbarimore; **Rekomandimi nr.3:** Menaxhmenti i drejtorive përkatëse duhet që gjatë planifikimit të buxhetit për një projekt të caktuar i cili mund të zgjasë disa vite, fondet e planifikuara për financimin e projekteve ti vlerësojnë në mënyrë sa më të saktë dhe sipas kritereve të përcaktuara në planin kontabël, apo në raste kur planifikimet nuk janë në kategorinë përkatëse të bëhet ridestinimi i mjeteve në kodet e caktuara ekonomike.

AUDITIMI 5

Emri i auditimit	**AUDITIMI I SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE NË DREJTORINË E BUJQËSISË**
DATA E DORËZIMIT TË RAPORTIT FINAL	30.08.2024
Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):	
OBJEKTIVAT KRYESORE TË AUDITIMIT	A janë zbatuar të gjitha procedurat për aplikimin e reklamimit dhe transparencës së proceseve për subvencionim (thirrja publike, publikimi i listës së përfitueseve, afatet kohore për aplikim, afati i ankesave); A janë krijuar komisionet e vlerësimit për secilën thirrje dhe a është formuar komisioni i ankesave; Vlerësimi i aplikacioneve nga aspekti procedural dhe përmbajtjesor a është në përputhshmëri me rregulloren komunale për subvencionim; Të gjitha marrëveshjet/kontratat e nënshkruara në mes palëve a janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe për të parë se a janë caktuar persona përgjegjës për monitorim të marrëveshjeve.
FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT	**Periudha:**03.01.2024 deri më 30.06.2024 **Lokacioni:** Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
TË GJETURAT KRYESORE TË AUDITIMIT	**E GJETURA 1:** Në 4 (katër) thirrje publike për subvencionim nga Drejtoria e Bujqësisë, afati kohorë për aplikim për të përfituar nuk ishte respektuar sipas nenit 7 të rregullores komunale për subvencionim, e cila kërkon që thirrja publike të jetë e hapur së paku 15 ditë pune për aplikim. Në të 4 (katër) thirrjet të cilat ishin mostër e auditimit afati për aplikim ishte më pak se 15 ditë pune. Afati për ankesë në 4(katër) prej listave të përfitueseve nuk është respektuar sipas rregullores komunale për subvencionim, përkatësisht nenit 11, paragrafi 1, ku parashihet që ankesa parashtrohet në afat prej 5 (pesë) ditë pune pas publikimit të vendimit(listës) preliminare të përfitueseve. Në këto raste afati për ankesë ishte caktuar vetëm 3 (tre) ditë. **E GJETURA 2:** Në 20 (njëzet) mostrat në dosjet së përfitueseve ishin përgatitur dhe nënshkruar marrëveshje mes përfitueseve dhe Komunës vetëm për vlerat me participim të përfitueseve, duke mos i cekur të drejtat dhe detyrimet e secilës palë nënshkruese të marrëveshjes. Po ashtu, në asnjërën nga këto marrëveshje nuk është emëruar personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes/kontratës.
REKOMANDIMET	**Rekomandimi nr.1:** Zyrtarët përgjegjës në Drejtorinë e Bujqësisë duhet të aplikojnë në tërësi nenet e rregullores komunale për subvencionim, në mënyrë që ti shmangë çdo anashkalim të

	kritereve obligative të cilat rregullojnë procedurën e subvencionimit përmes fondeve publike. **Rekomandimi nr.2:** Drejtoria e Bujqësisë me rastin e përgatitjes së marrëveshjes/kontratës me përfituesit duhet të përcaktojnë qartë se çka duhet të përmbajë një marrëveshje apo kontratë, duke u bazuar në kërkesat të cilat janë përcaktuar në rregulloren komunale për subvencione, në mënyrë që të shmangë çdo situatë jo të favorshme e cila potencialisht mund të ndodhë.

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Jedinica Unutrašnje Revizije

PERIODIČNI IZVEŠTAJ JUR

IZVRŠENE REVIZIJE I AKTIVNOSTI UNUTRAŠNJE REVIZIJE

JANUAR
AVGUST
2024

PRIZREN, 2024

Sadržaj

REZIME .....Error! Bookmark not defined.

Rad JUR-a 4

Glavni rezultati/dostignuća u periodu Januar - Avgust 2024. 4

PRVI DEO (Opšti deo) **6**

DRUGI DEO
OBAVLJENI ZADACI REVIZIJE ZA PERIOD JANUAR- AVGUST 2024. ..... **9**

REVIZIJA 1 9

REVIZIJA 2 11

REVIZIJA 3 12

REVIZIJA 4 13

REVIZIJA 5 15

SKRAĆENICE

JUR – Jedinica za Unutrašnju Reviziju

UR – Unutrašnja Revizija

RSJS – Rukovodilac Subjekta Javnog Sektora

DP – Direktorijat za Poljoprivredu

DBF – Direktorijat za Budžet i Finansije

NKR – Nacionalna Kancelarija Revizije

MFRT - Ministarstvo Finansija *, Rada i Transfera*

CJHUR – Centralna Jedinica za Harmonizaciju Unutrašnje Revizije

GFI – Godišnji Finansijski Izveštaj

ISUFK – Informacioni Sistem za Upravljanje Finansijama Kosova

GFS – Glavni Finansijski Službenik

REZIME

Rad JUR-a

U skladu sa principima rada UR, pozivajući se na član 21. Zakona br. 06/L-021 o unutrašnjoj kontroli javnih finansija, JUR obavlja svoju funkciju nezavisno i direktno izveštava samo Rukovodiocu Subjekta Javnog Sektora (Predsedniku Opštine) i obaveštava Odbora za reviziju i Centralnu Jedinicu za Harmonizaciju Unutrašnje Revizije (CJHUR/UB) u *Ministarstvu finansija* , rada i Transfera (MFRT) putem periodičnij izveštaja. U odnosu na druge organizacione strukture u subjektu javnog sektora (u našem slučaju opština), JUR ima funkcionalnu nezavisnost u planiranju revizorskog rada, u vršenju revizije i izveštavanju.

Unutrašnja revizija u javnom sektoru obavlja se na osnovu standarda unutrašnje revizije, etičkog kodeksa i metodologije revizije, koju odobrava Ministar Finansija, Rada i Transfera.

U skladu sa tačkom dnevnog reda sednice Skupštine Opštine iu koordinaciji sa predsednikom Opštine, JUR je pripremila zbirni izveštaj zadataka i aktivnosti za period Januar-Avgust 2024. godine, koji predstavljam pred vama (odbornicima Skupštine Opštine). Ovaj izveštaj je pripremljen prema standardnom formatu koji je pripremila Centralna Jedinica za Unutrašnju Reviziju, u kojem su predstavljeni ciljevi i delokrug revizije, glavni nalazi i preporuke .

Glavni rezultati/dostignuća u periodu Januar - Avgust 2024.

Od sedam (7) revizija planiranih za 2024. godinu, do 31. avgusta 2024. godine, završeno je pet (5) revizorskih zadataka (završeni izveštaji), kao i periodična aktivnost praćenja sprovođenja preporuka datih u ovim izveštajima. Obavljeni su sledeći zadaci revizije:

1. Date su tri (3) preporuke za sprovođenje procedura koje se odnose na uočenje, evidentiranje, klasifikaciju, izednačavanje i održavanje imovine opštine u knjigama imovine (u DBF);
2. Revizija sopstvenih prihoda u Direktorijatu za zdravstvo, data je jedna (1) preporuka;
3. Na propise koji se odnose na obračun obaveza i naplatu prihoda od poreza na imovinu i zemljište date su dve (2) preporuke;
4. Upravljanje rashodima za robe i usluge i komunalije u opštinskoj upravi (bez obrazovanja i zdravstva), date četiri (4) preporuke;
5. Revizija subvencija i transfera u Direkotirijat za poljoprivredu, date su dve (2) preporuke.

Takođe u okviru definisanih ciljeva, JUR je takođe sprovela sledeće aktivnosti revizije:

a) **Periodični izveštaji za razmatranje napretka preporuka koje** je dala JUR (periodi praćenja i izveštavanja: januar i jul 2024);

b) **Koordinacija revizije sa ekipom NKR-a (** Nacionalna Kancelarija Revizije) za periode koje su vršili reviziju u našoj opštini (februar - mart 2024. godine), kao i koordinacija aktivnosti u vezi sa nacrtom izveštaja i akcionim planom za konačni izveštaj NKR;

b) **Godišnji izveštaji za Predsednika Opštine, Odbora za reviziju i CJHUR/MFRT:** Izveštajni period: Godišnji izveštaj za 2023. (period izveštavanja, januar 2024.) šestomesečni izveštaj za 2024. godinu (period izvešavanja, jul 2024.) **;**

c) **Održavanje redovnih sastanaka sa odborom za reviziju:** Za predmetni period održana su dva (2) sastanka;

d) **Održavanje sastanaka i radionica u USAID TEAM projektu (Transparentna, Efikasna i Odgovorna Opština), DEMOS-u i CJHUR** i savetodavne aktivnosti za direktore i opštinske službenike

PRVI DEO (Opšti deo)

1. Opšti podaci za korisnika budžeta (Subjekt javnog sektora)	
Subjekt javnog sektora (SJS):	Opština Prizren
Rukovodilac subjekta javnog sektora:	Shaqir Totaj
Ime i prezime direktora/revizora JUR-a:	Agron Hoxha
Telefon: 038 200 44 714	E-mail: agron.hoxha@rks-gov.net

Svrha šestomesečnog/godišnjeg izvještaja koji se odnosi na obavljene unutrašnje revizije i aktivnosti unutrašnje revizije:

Izveštavanje Ministarstva Finansija - Centralne Jedinice za Harmonizaciju Unutrašnje Revizije u vezi sa obavljenim revizijama i aktivnostima unutrašnje revizije kao i podacima potrebnim za sastavljanje jedinstvenog (zbirnog) šestomesečnog/godišnjeg izveštaja za javnost sistema unutrašnjih finansijskih kontrola u javni sektor.

2. Podaci za Jedinicu unutrašnje revizije i unutrašnje revizore	
Jedinica za Unutrašnju Reviziju osnovana je u skladu sa Zakonom o Unutrašnjoj Kontroli Javnih Finansija	**DA** NE

Jedinica za unutrašnju reviziju se osniva na jedan od sledećih načina:

a) **Nezavisna jedinica unutrašnje revizije direktno pod rukovodstvom Rukovodioca Subjekta Javnog Sektora;**
b) Zajednička jedinica za unutrašnju reviziju prema kriterijumima koje utvrđuje Ministarstvo Finansija;
c) Ugovorom o pružanju usluga unutrašnje revizije iz jednog subjekta javnog sektora u drugi, uz prethodno odobrenje ministra finansija; ili
d) Kroz ugovaranje stručne kompanije za obavljanje unutrašnje revizije, po odobrenju Ministarstva Finansija.

Jedinica za unutrašnju reviziju organizaciono odgovara direktno i isključivo rukovodiocu subjekta javnog sektora	**DA** NE

Da li je jedinica unutrašnje revizije kompletirana u skladu sa zakonskim zahtevima:

Minimalni zakonski zahtevi za broj revizora	**Trenutni broj revizora**	**Resursi potrebni za reviziju**
3	**2**	1

Direktor jedinice za unutrašnju reviziju i unutrašnji revizori se sertificiraju prema uslovima predviđenim zakonom	**DA** **NE**

3. Sprovođenje standarda i metodologije rada unutrašnje revizije	
Sprovođenje Priručnika unutrašnje revizije	
Unutrašnji revizori imaju primerak Priručnika za unutrašnju reviziju:	**DA** NE
Unutrašnji revizori, pored priručnika unutrašnje revizije, imaju i svoj dodatni deo priručniku unutrašnje revizije.	DA **NE**

Unutrašnji revizori u sprovođenju posebnih revizija/revizija na zahtev u potpunosti se pridržavaju faza procesa revizije definisanih u Priručniku za unutrašnju reviziju	**DA** NE
Statut unutrašnje revizije	
Jedinica unutrašnje revizije ima statut unutrašnje revizije	**DA** NE
Statut unutrašnje revizije potpisuju Rukovodilac subjekta javnog sektora i Direktor Jedinice UR:	**DA** NE
Ako je odgovor Da - napišite datum kada je statut odobren **04.07.2022 (razmotreno)**	
Sprovođenje kodeksa profesionalne etike UR	
Unutrašnji revizori se pridržavaju principa i pravila definisanih Kodeksom profesionalne etike.	**DA** **NE**
Sprovođenje unutrašnje revizije	
Strateški plan unutrašnje revizije sastavlja se na osnovu procene rizika:	**DA** NE
O strateškom planu unutrašnje revizije dali su saglasnost Rukovodioc subjekta javnog sektora i Odbor za reviziju	**DA** NE
Godišnji plan UR se izrađuje na osnovu strateškog plana UR	**DA** NE
O Godišnjem planu unutrašnje revizije su dali saglasnost Rukovodioc subjekta javnog sektora i Odbor za reviziju:	**DA** NE
Subjekt javnog sektora je formirao Odbora za reviziju	**DA** NE
Priprema i sprovođenje godišnjeg plana unutrašnje revizije	
Ukupan broj planiranih revizija godišnjim planom po izveštajnim periodima i njegova realizacija (za koje su sastavljeni konačni izveštaji)	

Izveštajni period	Broj planiranih revizija	Planirani dani za obavljanje revizije	Broj izvršenih revizija	Vreme utrošeno u obavljanju revizije	Broj revizora angažovanih za reviziju
Prvih šest meseci	4	90	4	**92**	**2**
Drugih šest meseci	3	80	**1**	**26**	**2**

Godišnji ukupno	**7**	**170**	**5**	**118**	**2**

Pojašnjenje: U kolonama vremena utrošenog na sprovođenje revizije **uračunavaju se i dani praćenja napretka sprovođenje preporuka.**	
Rukovodiocu subjekta javnog sektora se dostavljaju konačni revizorski izveštaji odmah po završetku UR	**DA** NE
Rukovodilac subjekta javnog sektora sastavlja i odlučuje o akcionom planu koji uključuje primljene preporuke i postupke koje se moraju preduzeti u skladu sa zakonom o UKJF-u - **Direktori revidiranih Direktorijata zajedno sa svojim osobljem pripremaju akcione planove.**	DA NE
Za preporuke date u revizorskim izveštajima, jedinica unutrašnje revizije ima organizovanu bazu podataka za sprovođenje preporuka:	**DA** NE
